



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Inxhinieri
Softuerike”
Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjise”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof.Dr. Thoma KORINI

Dr. Alketa GREPCKA

Korrik / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bsc në "Inxhinieri Softuerike"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjise"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierise Softuerike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Inxhinieri Softuerike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.781 date 10.11.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdher i MAS nr.422 date 09.12.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdher i MAS nr.140 date 25.03.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	20 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 88 studentë; 2020-2021 72 studentë; 2021-2022 82 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (IKT) është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.781 dt.10.11.2011. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (IKT) i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 116, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 14.12.2022. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka 2 njësi kryesore: Fakultetin e Inxhinierisë dhe Fakultetin e Ekonomisë.


Fakulteti i Inxhinierisë përbëhet nga tre njësi bazë:

1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike;
2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale;
3. Njësia e kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri (Qershor 2016);

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" "Inxhinieri Softuerike" është hapur me VKM nr.781 date 10.11.2011. Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në "Inxhinieri Softuerike" është akredituar për herë të parë me Urdhër nr.140 date 25.03.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit mbi bazën e Vendimit Nr.88, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, për një periudhë 6 vjeçare.

CIT ka aplikuar në ASCAL për riakreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" më datë 26.10.2021. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin periodik të këtij programi studimi.

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" zhvillohet në Departamentin e Inxhinierisë Softuerike në Fakultetin e Inxhinierisë. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" ka për qëllim punësimin e studentëve në përdundim të studimeve të tyre në: Njohës të mirë të informacionit, specialist i shitjes së softuerëve, arkitekt softuerësh, testues i softuerit, menaxher i projektit softuerik, teknik informacioni, mirembajtës i sistemit të të dhënave, mirembajtës i faqes në internet, zhvillues i sistemeve mbështetese, menaxher i bazës së të dhënave. Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemin European të transferimit të krediteve në 180 kredite ECTS. Programi në shqyrtim ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL" dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Programi i studimit rezulton i regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me numer identifikimi: T4816201043 përmes vërtetimit date 09.12.2020 me nr. 2621/9 prot. lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe përmes urdhërit nr. 422 datë 09.12.2020 nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë "Inxhinieri Softuerike".



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË


Akreditimi i programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" i realizuar për herë të parë me Urdhër Nr. 140 date 25.03.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit mbi bazën e Vendimit Nr.88, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, për një periudhë 6 vjeçare nuk është shoqëruar me rekomandime.

Megjithatë, në RVB janë evidentuar një numër sugjerimesh pasqyruar në RVJ të vitit 2015 që ka shërbyer si bazë për procesin e akreditimit të programit. Këto sugjerime [Ev. RVB Master Shkencave ne Inxhinieri Softuerike] konsistojnë në:

- Angazhimin e një stafi me kohë të pjesshme me eksperiencë, me grada e tituj;
- Personeli me kohë të plotë të inkuadrohet në studimet doktorale;
- Në bibliotekë duhet shtuar numri i librave mbështetës si kopje të shtypura apo elektronike;
- Stafi akademik duhet të plotësojë kërkesën për t'u pajisur me dëshmi të gjuhës angleze.

Nga një analizë e dokumentacionit në dispozicion dhe diskutimeve në lidhje me këta elementë në institucion, GVJ është i mendimit se:

- Stafi akademik me kohë të pjesshme i angazhuar në procesin mësimor në tre vitet e fundit është staf cilësor me tituj e grada. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka angazhuar 1 Dr. dhe 1 MSc për vitin 2019-2020 ndërsa për vitin 2021-2022 ka angazhuar vetëm 1 Dr.
- Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" zotëron minimalisht gradën Shkencore "MSc" duke përmbushur standartin përkatës;
- Nga vizita në institucion GVJ u informua se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është i pajisur me dëshminë e gjuhës angleze.
- Nga takimet në Zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ u informua se stafi akademik i huaj në institucion ka plotësuar dokumentacionin me lejet e qendrimit dhe punësimit Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për sigurimin e lejeve të duhura në lidhje me punësimin e stafit të huaj;
- Nga vizita në institucion GVJ u informua se në sajë të marrëveshjes me McGrawHill (e rinovuar në shtator 2021) përmbushet nevoja për literaturë në gjuhën angleze duke patur akses të gjerë nga çdo kompjuter brenda dhe jashtë kampusit në tekste on-line;

Handwritten signature and a circular stamp or mark.


PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 26.10.2021, Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" nëpërmjet shërbimit në AMS. Bazuar në Urdhrin nr. 25, datë 15.03.2022, "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, grupi i vlerësimit përbëhet nga: Prof. Dr. Thoma Korini dhe Dr. Alketa Grepcka. Gjatë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Majlinda Demireli dhe Znj. Aleksandra Xhamo. Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Janar 2022 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" po ashtu vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore, përfaqësues të Zyrës së Shërbimit ndaj Studentëve si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Handwritten signature and a circular stamp or mark.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.07.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 89/20 Prot, datë 04.07.2022. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përcjell në ASCAL më datë 07.07.2022, me anë të shkresës me Nr. 300/1 Prot, datë 07.07.2022, “Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Msc në Inxhinieri Softuerike”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” u shërben interesave kombëtare duke përgatitur specialistë të cilët me kompetencat e tyre do t’i shërbejnë zhvillimit teknologjik në një fushë me zhvillim të shpejtë e me kontribut parësor në modernizimin e vendit.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar <i>nenit 4 ne Statut</i> , përcaktohet qartë përmes vizionit të tij synimi i institucionit në drejtim të përgatitjes së studentëve me aftësi të mbështetura mbi edukimin, mendimin kritik, invocacionit dhe lidërshipt të cilat ata do t’i përdorin per t’i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë. [1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar]
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Kolegji Universitar CIT vepron me një mision dhe qëllime të qarta të shprehura në dokumenta bazë Institucionale. Neni 4 në Statut përshkruan si mision “ <i>zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimin të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë</i> ”. Realizimi i tij synohet përmes qëllimeve të përcaktuara në linjë me strategjinë e zhvillimit të tij. Përmendim këtu: a. Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;

	<p>b. Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë;</p> <p>c. Të ofrojë mundësi më të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;</p> <p>[1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar]- neni 4].</p> <p>Qëllimet bazë të shprehura në Statut janë reflektuar edhe në hartimin e strategjisë së zhvillimit të institucionit [Evidence 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017]</p> <p>Citojmë këtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi 1: Krijimi i një mjedisi të veçantë, për marrjen e njohurive adekuate; • Qëllimi 2: Krijimi i një mjedisi të veçantë për zhvillimin eficient të aftësive; • Qëllimi 3: Krijimi i një mjedisi të veçantë për përmirësimin e cilësisë së jetës; <p>[Evidencë 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017, faqja 14-15]</p>								
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit synon të përgatisë studentët për t'u bërë lider në fushën e programimit dhe adresimit të nevojave globale që kërkojnë profesionistë të vërtetë në zgjidhjen e problemeve inxhinierike dhe softuerike, shkenca kompjuterike, parimet e dizajnit, zhvillimin e softuerit apo testimin e tyre.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="560 1176 740 1256">Të Përbushet</th> <th data-bbox="740 1176 935 1256">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="935 1176 1123 1256">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1123 1176 1311 1256">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="560 1256 740 1303"></td> <td data-bbox="740 1256 935 1303"></td> <td data-bbox="935 1256 1123 1303"></td> <td data-bbox="1123 1256 1311 1303" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Të Përbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Të Përbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimet e evidencave të paraqitura nga institucioni dhe takimet e zhvilluara me drejtues të tij konstaton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” është hartuar dhe ofrohet në linjë vazhdimësie të strategjisë së vetë institucionit. Mendimi ynë bazohet në dokumentat bazë institucione si vijon më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024 e miratuar nga Senati Akademik në Maj 2017 në nenin 4 të saj jep qartë misionin dhe vizionin. Kjo strategji ka ruajtur 5 qëllimet bazë të Planit të Strategjisë dhe Biznes Plan të ndërtuar

	<p>nga institucioni në 2012 dhe objektivat përkatëse për përmbushjen e secilës prej tyre ndërsa reflekton ndryshimet në drejtimet prioritare; [2. <i>Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</i>; 3. <i>Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT, miratuar me VSA nr.5.1, 24.05.2012</i>;]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Fakultetit të Inxhinierisë e cila në nenin 3 të saj përcakton strukturën e mësimdhënies dhe kërkimit; <p>Qëllimi i Fakultetit të Inxhinierisë është në akordancë me angazhimet dhe qëllimet e shprehura në pikat 3.3 dhe 3.4 të Strategjisë së Zhvillimit të KU IKT-së [2. <i>Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</i>, pika 3.3. dhe 3.4];</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>KU IKT ka aprovuar dhe vë në zbatim dokumenta bazë institucione mbi bazën e të cilave janë në funksion programet mësimore. Statuti i aprovuar me vendim të Senatit Akademik në 2019 në nenin 4 të tij jep qartë vizionin dhe misionin e institucionit. Drejtimet prioritare janë subjekt i Strategjisë së Zhvillimit- 2024 të cilat shprehin drejtimin prioritar në planifikimin akademik, përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e numrit të studentëve; 2. Rritja e stafit akademik me grada shkencore; 3. Planifikimi administrativ dhe mirëmenaxhuar; <p>[2. <i>Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</i>]</p> <p>Në takimin e zhvilluar me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë na u theksuan drejtimet prioritare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mësimdhënia dhe cilësia e saj; 2. Kërkimi shkencor përmes synimit të hapjes së programit të ciklit të tretë “Doktorature”; 3. Rritja e bashkëpunimit me përfaqësues të industrisë; <p>Në raportin e vlerësimit të programeve të studimit theksojmë edhe disa drejtime prioritare shtesë të cilat i gjejmë me vend:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i laboratorëve me licenca e patenta softueresh; • Punësim të studentëve menjëherë pas përfundimit të studimeve në marrëveshje me kompani dhe sipërmarrje në vend; • Angazhimin e studentëve në projekte konkrete;



	[Takim me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë; 19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT].			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	GVJ shqyrtoi me vëmendje evidencat e paraqitura nga insitucioni. Përmbajtja e programit mësimor, stafi akademik i angazhuar në program, dhe struktura organizative e tij janë në akordancë me përcaktimet bazë institucionale të shprehura në Statut, Rregulloret. Programi i studimit është i organizuar bazuar edhe në kornizën ligjore në fuqi. [1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar; 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; 20. Programet e lendeve 2019 – 2020; 20. Programet e lendeve 2020 – 2021; 20. Programet e lendeve 2021 - 2022]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” ka objektiva të mirëpërcaktuara dhe të shprehura në Rregulloren e programit të studimit [10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike]. Këto objektiva i gjejmë të pasqyruara edhe në dokumentin nr. 19. “Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT”.</p> <p>Përmendim këtu më kryesoret:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aftësimin në fushën e Inxhinierisë softuerike përmes përgatitjes fillimisht në fusha të përafërta si ato që lidhen me shkencat e natyrës dhe ato humane; • Rritja e ndërgjegjësimit tek studentët në programim është një proces që nuk nis dhe mbaron në auditoret dhe laboratorët e universitetit; • Të formojë programues të aftë në kodim dhe të njohin mirë harduerin, referuar nivelit të ciklit bachelor; • Të përgatisë studentë që të punojnë në grup dhe individualisht; • Të përgatisë studentë që kuptojnë nocionet etike dhe ato ligjore lidhur me privacinë dhe mbrojtjen e informacionit; • Të përgatisë studentë që janë të aftë për punë të pavarur; • Të përgatisë studentë të aftë të punojnë me projekte dhe detyra kursi në grup ose vetëm;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

	<p>Në përfundim të studimeve në Rregulloren e programit të studimit institucioni ka dhënë qartë aftësitë e synuara që studenti ka përfituar. Përmendim aftësinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për të kuptuar të gjitha aspektet e procesit të zhvillimit softuer, nisur që nga fazat fillestare të dizenjimit deri në mirëmbajtjen dhe zhvillimin afatgjatë softuer; • për të formuar dhe vlerësuar softuer-in në kontekstin e sistemeve fizike dhe aplikimeve në botën reale; • për të aplikuar parimet e inxhinierisë në zhvillimin e softuerit duke përfshirë edhe analizën e trade-off; • për të kuptuar kriteret e sigurisë dhe cilësisë së softuerit; • për të planifikuar dhe menaxhuar projekte të mëdha softueri; • për të punuar në grup dhe individualisht; • për të kuptuar inxhinierinë ekonomike dhe sipërmarrjen në praktikën softuerike; • për të kuptuar principet e rëndësishme mbi të cilat sistemet fizike dhe aplikacionet në botën reale janë ndërtuar; • për t'u integruar dhe bashkëpunuar në procesin e dizenjimit të këtyre sistemeve dhe aplikacioneve; • për të komunikuar në mënyrë efektive në formën e shkruar dhe të folur: në inxhinierinë softuerike, gjithashtu dhe në fushat e inxhinierisë, shkencave kompjuterike, matematikës dhe fushat ndihmëse; <p><i>[9. Rregullore e departamentit të Inxhinierisë Softuerike]</i> Objektivat kryesore të këtij programi studimi janë të detajuara për çdo lëndë pjesë përbërëse të tij dhe shprehen qartë në ndërtimin e syllabuseve <i>[20. Programet e lëndëve 2021 – 2022]</i>.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni shpreh vëmendjen në lidhje me kërkesat dhe tendencat e tregut dhe zhvillimet teknologjike. Në raportin e përgatitur nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit një peshë zë edhe studimi i tregut të punës. Të dhënat demografike dhe përfaqja e rinisë me teknologjinë të marra nga INSTAT, numri i të diplomuarave sipas fushës së studimit (2018-2019), trendet vendore të përdorimit të teknologjisë (2019), të dhëna nga raporti i tregut të punës në Shqipëri hartuar nga Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisjes (IPPM), të dhëna statistikore në vendet e tjera në lidhje me Intelligencën artificiale dhe kërkesat për punësim, konkurrenca dhe programe të ngjashme të ofruara nga IAL të tjera në vend, janë disa grupe ku departamenti është fokusuar në raportin e tij vjetor <i>[19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT]</i>.</p>

	<p>GVJ nuk konkludon dot nëse këto studime bëhen në mënyrë periodike. Theksojmë që evidencat e paraqitura për studimin e tregut janë të pakta (analiza 2019-2020) dhe nuk mund të konkludojmë nëse institucioni i ndërmerr ato në mënyrë periodike [18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011; 19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT].</p> <p>GVJ konstaton gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe punësimin e tyre sipas fushës së studimit. Institucioni ka ofruar evidencë të individëve të punësuar, dhe profilin e punësimit duke konkretizuar edhe një nga synimet e shprehur në strategjinë e tij e cila është rritja e numrit të studentëve dhe garantimit të punësimit të tyre në fund të studimeve. [19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT].</p>				
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studentët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” kanë mundësi të punësohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohës të mirë të informacionit; • Specialist i shitjes së softuerëve; • Arkitekt softuerësh; • Testues i softuerit; • Menaxher i projektit softuerik; • Teknik informacioni; • Mirëmbajtës i sistemit të të dhënave; • Mirëmbajtës i faqes në internet; • Zhvillues e-commerce; • Zhvillues i sistemeve mbështetese; • Menaxher i bazës së të dhënave; <p>Nga analiza e strukturës së programit të studimit, GVJ konstatoi se ai është hartuar në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Përsa i përket përmbajtjes, në këtë program studimi janë pasqyruar elementët e nevojshëm formues të cilët garantojnë përfitim të dijeve, aftësimin praktik dhe punësimin e tyre në përfundim të studimeve. [19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT]</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="560 1827 783 1906">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="783 1827 970 1906">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="970 1827 1139 1906">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1139 1827 1318 1906">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Referuar evidencave të paraqitura nga institucioni, takimet dhe vizitat konstatohet se KU IKT zotëron burimet, kapacitete dhe përvojën për të ofruar këtë program studimi. GVJ konkludon se KU IKT zotëron për këtë program studimi:</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë i cili përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike 2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale 3. Njësia e kërkimit Shkencor CIRDI Inxhinieri (Qershor 2016) <p>Burimet Njerëzore: Bazuar në përmbajtjen e syllabuseve dhe CV e stafit akademik rezultoi se ata mbartin përvojë dhe eksperiencë në fushat përkatëse. Takimi me këtë staf tregoi motivimin dhe angazhimin e tyre në drejtim të mësimdhënies dhe punës me studentët. Të dhënat statistikore shfaqin një qëndrueshmëri dhe numër të duhur për të mundur këtë program studimit.</p> <p>Fakulteti i inxhinierisë për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 26 pedagogë, nga të cilët 24 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 12 kanë gradën Dr./PhD, dhe 6 Asistent Lektorë me Msc; dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka 10 pedagogë gjithsej nga të cilët 9 janë PAE nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 5 kanë gradën Dr./PhD, dhe 3 Asistent Lektorë me Msc; dhe 1 pedagogë me kontratë (PAK) me titullin “Profesor i Asociuar”.</p> <p>[21. CV e stafit Akademik të programit Bsc. në Inxhinieri Softuerike; 22. CV e stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë]</p> <p>Burimet Infrastrukturore: Institucioni garanton hapësira të bollshme (në total 1084m²) si auditorë, klasa për leksione dhe seminare (163 m²), laboratorë për lëndë të përbashkëta (240 m²), laboratorë për lëndët e programit (90m²) Bibliotekë (90 m²), Sekretari (63 m²), NJSBC dhe Zyra për shërbim ndaj</p>


	<p>studentëve (14 m²), Zyra për stafin (60m²), Sallat e mbledhjeve (40 m²), mjedise për personelin e shërbimit, etj. <i>[34. Raporti i Grupit të Punës për Verifikimin e Standardeve dhe Normativave të Infrastruktura nga MASR 28.07.2020]</i></p> <p>Platforma dhe sisteme të teknologjisë së informacionit: E-learning; CIT GO Digital; McGrawHill Education; Cit.edu.al; <i>[85. RVB e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike]</i></p>																			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë ka në përbërjen e tij:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike; 2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale; 3. Njësia e kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri (Qershor 2016); <p>Programet e ofruara në këtë Fakultet vijojnë si më poshtë: Tabela 1: Programet e ofruara në Fakultetin e Inxhinierisë</p> <table border="1" data-bbox="563 734 1305 1003"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Fak i Inxhinierisë</th> <th colspan="3">Numri i programeve viti akademik 2021 -2022</th> </tr> <tr> <th>DP</th> <th>Bsc</th> <th>Msc</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Dep Inxh Softuerike</td> <td></td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dep Inxh Industriale</td> <td>1</td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Duke ju referuar strukturës së Fakultetit të Inxhinierisë dhe programeve të ofruara të studimeve, konstatohet se ky fakultet garanton formimin në diploma që lidhen me shkencat inxhinieri softuerike, kompjuterike dhe IT. Në këtë mënyrë GVJ konstatoi se ka një përputhje ndërmjet fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të FSHTN. Duke ju referuar kërkesave të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” përsa i përket kodifikimit të programeve të studimit, në kushtet kur mungojnë aktet nënligjore, institucioni ka aplikuar kodifikimin e brendshëm të lëndëve të programit të studimit <i>[16. Planet mesimore te programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike]</i></p>	Fak i Inxhinierisë	Numri i programeve viti akademik 2021 -2022			DP	Bsc	Msc	Dep Inxh Softuerike		2	2	Dep Inxh Industriale	1	1		Totali	1	3	2
Fak i Inxhinierisë	Numri i programeve viti akademik 2021 -2022																			
	DP	Bsc	Msc																	
Dep Inxh Softuerike		2	2																	
Dep Inxh Industriale	1	1																		
Totali	1	3	2																	
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të</p>	<p>Programi nuk është ndërsiplinor, por është program që lidhet drejtpërdrejt me njësinë kryesore (Fakultetin e Inxhinierisë) dhe njësinë bazë (Departamentin e Inxhinierisë Softuerike).</p>																			



studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Numri i përmbushjeve	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>KU IKT ushtron aktivitetin e saj bazuar në dokumenta bazë ligjore: Statut dhe Rregullore Institucionale [6. Rregullore Institucionale e KU IKT; 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar:].</p> <p>Pjesa II në Statut përshkruan funksionet dhe përgjegjësitë e organeve dhe autoriteteve drejtuese ndërsa Pjesa III përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e personelit [1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar, Kreu II, neni 8-54; Kreu III, neni 57-64].</p> <p>Veprimtaria e organeve kolegjiale, administrative dhe personelit (akademik dhe ndihmës të tij) menaxhohet përmes zbatimit të Rregullores Institucionale ku rregullimi normativ i marrëdhënieve midis organeve, autoriteve, stafit akademik dhe studentëve, ndërveprimi institucional i tyre, të drejtat dhe përgjegjësitë jepen qartë në këtë dokument [6. Rregullore Institucionale e KU IKT, neni 12 -73].</p> <p>Në mbështetje janë edhe rregulloret e veçanta të cilat detajojnë marrëdhëniet midis njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Konkretisht për këtë program studimi janë dhënë qartë funksionet e autoriteteve drejtuese në Fakultetin e Inxhinierise dhe Departamentin i Inxhinierisë Softuerike [8. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierise; 9. Rregullore e departamentit të Inxhinierise Softuerike;].</p> <p>Departamenti i Inxhinierise Softuerike është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit. Neni 5 në rregulloren e njësisë bazë përcakton në piken “a” detyrën e shefit të departamentit në lidhje me kujdesin ndaj përmbatjes së programit mësimor dhe menaxhimit të syllabuseve të tij.</p> <p>Specifikat në lidhje me lëndët, ngarkesën mësimore dhe detyrimet e studentëve janë dhënë qartë në Rregulloren e</p>

	<p>Programit të Studimit [10. Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike].</p> <p>Për sigurimin e veprimtarisë mësimore Departamenti i Inxhinierisë Softuerike bashkëpunon me njësi administrative. Në takimet e zhvilluara GVJ konstaton se Zyra e Çështjeve Studentore, NJSBC, Sekretaria Mësimore, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Biblioteka, janë disa njësi bashkëpunuese në ushtrimin e aktivitetit të institucionit. Funksionimi dhe mbarëvajtja e veprimtarisë së tyre ndërvepruese rregullohet përmes Librit të Rregulloreve Institucionale aprovuar në vitin akademik 2019-2020 [15. Manuali i Keshillimit te Karrieres; 12. Rregullore e Sekretarise cikli i pare 2021-2022; 7. Libri i Rregulloreve Institucionale].</p> <p>Për të mundësuar formimin e studentëve me njohuritë e kërkuara për këtë program të ciklit të parë, Departamenti i Inxhinierise Softuerike bashkëpunon edhe me departamentin e Inxhinierise Industriale të Fakultetit të Inxhinierise dhe me Fakultetin e Ekonomisë e duke përcaktuar qartë si nivelin e angazhimit ashtu edhe detyrimet reciproke. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe marrëveshjet për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik dhe personeli i angazhuar në procesin e përgatitjes së temave të diplomave të cilat i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies [Takim me stafin akademik].</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Institucioni në kuadër të programit të studimit ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me kompani biznesi, institucione shtetërore me fokus kryesor: Zhvillimin e intershipeve dhe punësimin e studentëve në përfundim të studimeve të tyre [26. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022].</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar edhe me IAL të jera ku përmendim: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti “Aleksander Xhuvani”, Kolegji Universitar i Biznesit (KUB), UET etj, në kuadër të partneritetit në projekte të ndryshme, shkëmbim përvoja akademike, lehtësimin e procedurave të transferimit të studentëve, mbështetje dhe përmirësim i praktikave profesionale sidomos në ciklin e parë dhe shkëmbim i literaturës shkencore [25. Marreveshjet me universitetet 2016 – 2022].</p> <p>GVJ konstaton rritje të bashkëpunimit në kuadër të projekteve Erasmus+ në drejtim të mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve [24. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; 85. RVB Bachelor ne Inxhinieri Softuerike, tabela permbledhese nr.5]</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse</p>	<p>GVJ në takimet e zhvilluara me stafin akademik, studentët dhe drejtues të Departamentit të Inxhinierisë Softuerike dhe</p>



<p>për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë konstaton vëmendjen që institucioni ushtron në lidhje me rritjen e bashkëpunimit me kompanitë e biznesit dhe institucionet shtetërore. Ky bashkëpunim konsiderohet i rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të praktikave profesionale dhe marrjes së mendimit të tyre për përmirësimet në masën 20% të përmbajtjes së programit të studimit [takimet në institucion].</p> <p>GVJ shqyrtoi evidencat e paraqitura nga institucioni për një sërë marrëveshjesh të lidhuara në kuadër të bashkëpunimit [24. Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+ 2016-2022; 25. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022; 26. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022; 58. Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanitë, bizneset].</p> <p>GVJ u njoh vetëm me një raport institucional përgatitur për MAS për periudhën 2018-2021 të cilat trajtojnë vetëm kuadrin e marrëveshjeve për bashkëpunime por nuk japin një analizë të impaktit të tyre në këtë kuadër [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; https://cit.edu.al/annual-report-2/]</p> <p>GVJ nuk u njoh me asnjë raport analitik në lidhje me përfitimet në funksion të realizimit të këtyre bashkëpunimeve dhe përfitimet nga ana e studentëve në këtë drejtim. Ndonëse në RVB është shprehur, citojmë: “një kontribut në përpunimin e të dhënave për Fakultete japin edhe Njësitë e Kërkimit Shkencor CIRD (Inxhinieri dhe Ekonomi), të cilat në fund të çdo vitit akademik përgatisin raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me arritjet akademike brenda Fakultetit, njërive dhe programeve”, GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit “Raporti i Aktivitetit të Kërkimit 2020/2021” përgatitur nga CIRD nuk gjeti të dhëna dhe analizë në lidhje me bashkëpunimet dhe impakti i tyre në programin mësimor [dokumenta shtesë: D6. Raporti CIRD Inxhinieri 2020-2021].</p> <p>Bazuar për sa më sipër rekomandojmë: Hartimin e raporteve analitike periodike në lidhje me bashkëpunimet e realizuara përgjatë vitit akademik dhe konkluzionet e vlefshme në lidhje me progresin e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Zhvillimi i praktikës profesionale është i përfshirë në programin mësimor të programit të studimit Bachelor “Inxhinieri Softuerike” vlerësuar me 6 ECTS planifikuar të zhvillohet të semestrin e dytë të vitit të tretë. Manuali i Intershipit udhëzon studentët në lidhje me kryerjen e praktikës profesionale. Asistenca në lidhje me zgjedhjen e institucionit për kryerjen e praktikës jepet nga Departamenti i Shkencave Softuerike në bashkëpunim me Zyrën e Shërbimit të Studentëve ndaj Studentëve. Kjo e fundit bazuar edhe në skenarin A të zhvillimit të praktikës profesionale në një</p>

	<p>institucion i cili nuk ofrohet nga fakulteti mbështet studentët me informacion në lidhje me parapërgatitjen e dokumentacionit si: CV dhe mënyrën e marrjes së informacionit në këtë institucion përmes internetit etj. Për praktikën profesionale angazhohet edhe koordinatori i departamentit i cili në mesin e semestrit të dytë bën takime me studentët në lidhje me plotësimin e aplikimit për praktikë, pajisjen e tyre me letër shoqëruese. Praktika profesionale është përcaktuar të jetë 120 orë për këtë program studimi e llogaritur në një afat kohor 4 javë (6 orë në ditë kalendarike). Në fund të realizimit të saj plotësohet edhe dosja me dokumentat: raporti i studentit i cili zë 30% në vlerësim, raporti i pedagogut mbikqyrës zë 70% të vlerësimit final së bashku me raportin e mbikqyrësit në kompaninë/institucioni ku kryhet praktika [81. <i>Manuali i Internshipit Bachelor FI;</i>]</p> <p>Institucioni shfrytëzon edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar me kompanitë e biznesit për zhvillimin e praktikave profesionale. Takimet e zhvilluara në institucion dëshmuar për efektivitetin në këtë proces [takime në institucion].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni ofron një larmi trajnimesh, seminaresh dhe tryezash të rumbullakëta për studentët në programe të ndryshme studimi. Konkretisht nga evidencat për këtë program studimi gjetëm vetëm 1 student të trajnuar në “Siguria Kibernetike për Fëmijët”. Evidenca të shumta janë për trajnime në fushën e ekonometrisë, ekonomisë, kontabilitetit, dizajnit dhe shumë studentë kanë përfituar përmes pjesëmarrjes së tyre [51. <i>Çertifikata trajnimesh dhe workshopesh dhene studentëve te IKT</i>]. Një pjesë e veprimtarive pasqyrohet edhe në gazetën mujore “CIT – E – Newsletter” [https://cit.edu.al/student].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total ka 180 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 30. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën angleze. Programi i studimit në nenin 1 dhe 3 të rregullores së tij përcakton qartë strukturën e programit dhe bazën ligjore mbi të cilin është ndërtuar dhe funksionon. Ky program përmban elementët e nevojshëm (modulet, lëndët dhe kreditet përkatëse për secilin prej tyre, shpërndarjen në çdo semestër), kushtet e pranimit dhe përgjedhjes, metodat e vlerësimit të studentëve dhe progresi i tyre, kushtet për transferim dhe çdo element detyrues në përputhje me kuadrin ligjor dhe specifikisht me VKM Nr.41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe me nenin 79 në Rregulloren e Institucionit.</p> <p><i>[6. Rregullore Institucionale e KU IKT neni 79; 10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike, neni 1 dhe 3].</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Më poshtë janë specifikuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët në programin Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” do të zotërojnë sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare për të mundësuar punësimin e tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Dizenjues i sistemeve të informacionit;</i> • <i>Analist biznesi;</i> • <i>Arkitekt softuerik;</i> • <i>Testues softuerik;</i> • <i>Menaxher projektsh softuerike;</i> • <i>Specialist informacioni</i> • <i>Administrues sistemesh</i> • <i>Menaxher faqe interneti;</i> • <i>Zhvillues e-commerce</i> • <i>Zhvillues i sistemeve mbështetese të vendimarrjes</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Dizenjues database dhe menaxher</i> • <i>Krijues softueri;</i> <p>GVJ është i mendimit se programi ofron një spektër të gjerë profesionale dhe specialitete të lidhura ngushtë me inxhinierinë kompjuterike [10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike.]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” përmban lëndë dhe module të trajtuara gjerësisht në aspektin teorik dhe praktik. Lëndët janë vlerësuar të gjitha me 6 ECTS duke ofruar 2 orë/javë leksione dhe në të njëjtën masë edhe për zhvillimin e seminareve dhe ushtrimeve. Duke konsideruar që inxhinieria softuerike është një nga nën – disiplinat më të rëndësishme të inxhinierisë kompjuterike, GVJ gjen në këtë program studimi një set lëndësh dhe module të cilat formojnë një bazë të gjerë njohurish për studentin dhe marrjen e koncepteve bazë themelore në këtë fushë.</p> <p>[16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri softuerike” zhvillon kompetenca të nevojshme për studentin për një formim të përgjithshëm të tij dhe për një profilizim të tij në studimet e mëtejshme të thelluara. Në tre semestrat e parë akademike, studenti merr njohuri në lëndët bazë si matematike, fizikë dhe qarqet elektrike, njohuritë bazë në inxhinieri kompjuterike dhe aplikimet kompjuterike. Në semestrat në vijim studenti merr bazat themelore në programim dhe inxhinieri softuerike, arkitekturë softuerike dhe sistemet. Në vitin e tretë një fokus i veçantë i jepet sistemeve database dhe hyrje në web design, sistemeve operative dhe sistemeve dinamike, siguria inxhinierike dhe arkitektura kompjuterike duke krijuar një formim të mirë për studentin për të thelluar më tej studimet e tij në të njëjtën fushë ose fusha të ngjashme në programe Master Shkencor (Inxhinieri Softuerike ose Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni me profile: Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data; Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn). Programi ofron lëndë si “Metodat kërkimore”, “Hyrje në ekonomik”, “Shkrimi akademik” që e mundësojnë studentin të artikulojë, të analizojë dhe të marrë një vendimarrje në situatë kritike të cilat kërkojnë jo domosdoshmërisht zgjidhje inxhinierike. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze ofron për studentin një lehtësi në komunikim, hulumtim dhe përthithje më të shpejtë të koncepteve të reja.</p>

	<p>[16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; 20. Programet e lëndëve 2021 –2022; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020];</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura dhe takimet në institucion GJV konkludon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” dhe funksionimi i tij kryhet duke u mbështetur në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë, është hartuar duke respektuar kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” [16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike]; 2. Lëndët dhe modulet janë dhënë me kredite, bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve [16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike]; 3. Programi në total është 180 ECTS dhe organizohet në tre vite akademike. Çdo vit akademik ka në total 60 ECTS dhe çdo semester 30 kredite [16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike]; 4. Programi nuk ka ndryshuar elementët e tij që nga periudha e licencimit dhe akreditimit të parë në vitin 2016 në masën mbi 20% deri në vitin 2020. Ndryshime të vogla janë bërë në përmbajtjen e lëndëve [16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike; takim me stafin akademik]; Për vitin akademik 2021-2022 janë bërë ndryshime në programin mësimor përkatësisht 2 lëndë në emërtesë dhe 3 zëvendësime. 5. Kontrolli i dijeve dhe format e vlerësimit janë shprehur qartë në Rregulloren Institucionale, Rregulloren e Programit të Studimit dhe në përmbajtjen e çdo syllabusi [6. Rregullore Institucionale e KU IKT; 10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike.; 16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike, 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2019 - 2020]; 6. Objektivat formues, kompetencat profesionale përmendur edhe më sipër janë pasqyruar në Rregulloren e programit të studimit. Objektivat formues janë dhënë qartë edhe në syllabuset e çdo lënde pjesë përbërëse e programit të studimit [10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020];

7. Bazuar në ndarjen e veprimtarive në kategori formuese, institucioni ka parashikuar një ndarje për këtë program studimi si më poshtë:

Tabela 2:Kategoritë formuese dhe pesha për secilën prej tyre në programin e studimit

Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi
A	Lëndë Bazë	30	15%	15 – 20 %
B	Lëndë karakterizuese	96	55%	50 – 55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	30	15%	12 – 15 %
D	Lëndë plotësuese	18	10%	10 – 15 %
E	Detyrime përmbyllëse	6	5%	3 – 5 %

Kategoria	Tipi	2021-2022	2020-2021	2019-2020	Standardi
A	Lëndë Bazë	15%	15%	15%	15 – 20 %
B	Lëndë karakterizuese	55%	55%	55%	50 – 55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	15%	15%	15%	12 – 15 %
D	Lëndë plotësuese	10%	10%	10%	10 – 15 %
E	Detyrime përmbyllëse	5%	5%	5%	3 – 5 %

GVJ në lidhje me këtë element të programit të studimit jep konsideratat si vijon më poshtë:

- a. Programi i studimit nuk ka pësuar ndryshime në grupimin e lëndëve sipas kategorive në tre vitet e fundit;
- b. Ndarja e lëndëve sipas kategorive është në përputhje me standartet e kërkuara për secilën disiplinë dhe kjo është ruajtur për gjithë periudhën 2019-2022;
- c. Bazuar edhe në VKM nr.41 datë 24.01.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” përqindja totale e lëndëve të kategorisë “A” + “B” është 70% siç edhe është përcaktuar në kornizën ligjore;

	<p>d. Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime në strukturën, përmbajtjen e tij. Lëndët dhe modulet kanë ruajtur peshën dhe emërtimin e tyre;</p> <p>e. GVJ konstaton se lëndët me zgjedhje nuk kanë pësuar ndryshime. <u>Sugjerohet që të krijohet një diversitet në vite në lidhje me to, bazuar gjithmonë në kërkesat dhe tendencat e zhvillimeve teknologjike dhe në kërkesat e vetë studentëve.</u></p> <p>f. Bazuar edhe në objektivin ndërsektorial të programit të studimit citojmë: “ .. analiza e ndikimeve të jashtme sociale së bashku me çështje të ngjashme ligjore, rregullatore, etike dhe profesionale; komunikimi efektiv me përdoruesit teknike dhe klientët e biznesit”, GVJ nuk gjen në përshtatje lëndën me zgjedhje “Psikologji” <u>dhe i sugjerohet institucionit në këtë kuadër të inkorporojë lëndë me zgjedhje në drejtim të shkencave të komunikimit ose të trajtojë tematika ligjore dhe rregullatore që përshkruajnë kuadrin ligjor në Shqipëri dhe jashtë, japin informacion në kuadrin ligjor për patentat dhe mbrojtja e tyre etj;</u></p> <p>Programi i studimit rezultoi i regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me numër identifikimi: T4816201043 përmes vërtetimit datë 09.12.2020 me nr. 2621/9 prot lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe përmes urdhërit nr. 422 datë 09.12.2020 nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë “Inxhinieri Softuerike” [17.Shkresa e QSHA, Urdhër nr. 422, datë 09.12.2020 miratimi i formës së diplomës + suplementi]</p> <p>9. Institucioni ndjek një procedurë korrekte në lidhje me kuotat e pranimit. Kërkesa dërgohet në MAS në përputhje me afatet kohore të vendosura nga ky Institucion dhe të aprovuara prej tij [10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike].</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit, GVJ konstatoi se janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore. Duke i ballafaquar dhe përshtatur në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” veprimtaritë formuese të programit mund të grupohen:</p> <p>A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (30 kredite);</p> <p>B. LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore (96 kredite);</p>

	<p>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (30 kredite);</p> <p>D. LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (18 kredite);</p> <p>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (6 kredite);</p> <p>si dhe respektohet kërkesa që përqindja shuma e krediteve të lëndëve të kategorive A dhe B të mos jetë më pak se 70% e totalit.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacioni e paraqitur nga institucioni dhe verifikimit të tij në platformën elektronike të ASCAL dhe konkludon si vijon më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kolegjit Universitar “Insituti Kanadez i Teknologjise” i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 116, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 14.12.2022; • Programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” i është akorduar akreditimi në nivel programi me nr. 88 datë 02.11.2015 dhe është vlerësuar si program që i përbush plotësisht “Standartet shtetërore të cilësisë” dhe ka marrë vlerësim “pozitiv” nga Bordi i Akreditimit. Ky vendim është aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve përmes Urdhërit nr. 140 datë 25.03.2016; • Departamenti i Inxhinierisë Softuerike përbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin e stafit akademik të angazhuar për këtë program studimi; <p><i>[http://ams.ascal.al/ams/components/expertpanel/programet_shiko.php?id=1213; 1.4 Certifikata e Akreditimit leshuar nga Bordi i Akreditimit 2017; 1.5 Akreditimi i pare i programit Bsc. në Inxhinieri Softuerike, Urdhër i MAS nr. 140, 25.03.2016].</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit i cili është</p>	<p>Bazuar edhe në vendimin e Senatit Akademik nr.11 datë 15.11.2021 për programin e studimit është caktuar edhe një Koordinator programi i cili kryen funksionet e tij bazuar në rregullore [7. Libri i Rregulloreve Institucionale]. Veprimtaria e koordinitorit të programit konsiston në:</p>

<p>përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndjekjen e progresit të studentëve dhe të programit në tërësi; 2. Organizimin dhe monitorimin e praktikave profesionale; 3. Përzgjedhjen e temave të diplomave; <p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike për çdo grup ka përcaktuar edhe një këshillues akademik. Programi në total ka tre këshillues të cilët zhvillojnë takime periodike 1 herë në 2 javë [takim me stafin akademik]. Puna e tyre konsiston në forcimin e marrëdhënieve me studentët, ofrimin e asistencës dhe këshillimit tek ata dhe krijimin e lehtësirave në lidhje me punësimin e tyre [takim me stafi akademik]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se Fakulteti i Inxhinierisë si njësi kryesore e KU IKT dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike [20. Programet e lendeve 2019 – 2020; 20. Programet e lendeve 2020 – 2021; 20. Programet e lendeve 2021 – 2022; 85. RVB Bachelor ne Inxhinieri Softuerike;].</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një qendër kërkimore shkencore. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është pjesë përbërëse e Fakultetit të Inxhinierisë. Në nivel institucional, nivel të njësisë kryesore dhe njësisë bazë GVJ konstaton angazhim të një stafi akademik me grada të duhura shkencore në përputhje me kornizën ligjore dhe standartet e kërkuara për një cilësi në mësimdhënie.</p> <p>Fakulteti i inxhinierisë për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 26 pedagogë, nga të cilët 24 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 12 kanë gradën Dr./PhD, dhe 6 Asistent Lektorë me Msc; dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”.</p> <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë Softuerike që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (7 PAE / 3 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 5 / 3;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (7 PAE/ 3 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 3 / 3;</p>



	<p>Për vitin akademik 2021-2022, (10 PAE / 1 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 6 / 1;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin akademik 2020 – 2021 në nivel institucional janë angazhuar 42 PAE dhe 7 PAK. • Përqindja që zë stafi akademik i Fakultetit të Inxhinierisë kundrejt Institucionit është 57.14% • Në nivel grada shkencore dominon më shumë Fakulteti i Ekonomisë; <p>[27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS, faqja 18:]</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike angazhon një staf të kualifikuar për programin mësimor të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”. Numri i stafit akademik me kohë të plotë përmbush standartin nga MAS për njësinë bazë.</p> <p>[85. RVB Bachelor ne Inxhinieri Softuerike, tabelat përmbledhëse]</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka angazhuar një staf akademik me kohë të pjesshme i cili mbart eksperiencë.</p> <p>Siç është e evidente në Departamentin e Inxhinierisë Softuerike ka një staf ku një peshë të konsiderueshme zënë lektorët me Msc. Në takimin e bërë me përfqësues të Njesisë së Kerkimit Shkencor CIRD u theksua si synim hapja e programeve të Doktoraturës. Aktualisht Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ofron 2 programe në cikël të parë Bachelor dhe Program Master Shkencor me tre profile.</p> <p><i>Bazuar për sa më sipër, GVJ e gjen me vend të sugjerojë rritjen e stafit akademik me grada shkencore për ti shërbyer më mirë programeve ekzistuese dhe në hapjen e programeve në nivele më të larta.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Në përbërjen e njësisë bazë, Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka edhe një personel ndihmës akademik, i cili angazhohet në mbështetjen e aktiviteteve laboratorike në funksion të këtij programi studimi. [RVB – Tabela përmbledhese për stafi akademik]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi II.3



Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” zhvillohet në Departamentin e Inxhinierisë Softuerike. Ky departament në përmbushje të objektivave bazë të vendosur në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit, në akordancë me kornizën ligjore në Republikën e Shqipërisë, në vijim të detyrimit për të drejtën e informimit për studentët menaxhon një set me dokumentacione, pjesë përbërëse e programit mësimor. GVJ nga shqyrtimi i evidencave të paraqitura nga institucioni konkludon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” funksionon mbi bazën e një set Rregulloresh që burojnë nga niveli institucional deri në nivelin bazë [6. Rregullore Institucionale e KU IKT; 8. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë; 9. Rregullore e departamentit të Inxhinierisë Softuerike; 10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike]. Në ndihmë të veprimtarisë që kryhet në kuadër të programit të studimit, shumë hallka administrative kontribuojnë përmes angazhimeve të mirëpërcaktuar në rregulloret përkatëse të tyre [7. Libri i Rregulloreve Institucionale] 2. Plani mësimor është ndërtuar në përputhje me kërkesat e MAS dhe përmban të gjithë elementët bazë të cilët japin një përshkrim të qartë të objektivave, përmbajtjes, organizimit të lëndëve, ngarkesën mësimore [16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020]; 3. Syllabuset përshkruajnë objektivat, përmbajtjen, mënyrën e organizimit dhe vlerësimin të lëndës dhe literaturat [20. Programet e lëndëve 2021 – 2022; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020]. 4. Praktika profesionale mbikqyret nga koordinatori i programit dhe realizohet mbi bazën e një rregulloreje të përcaktuar qartë [7. Libri i Rregulloreve Institucionale]; 5. Përzgjedhja e temës së diplomës, përgatitja dhe mbrojtja e saj përshkruhet qartë në manualin e diplomës [7. Libri i Rregulloreve Institucionale]. 6. Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit akademik janë përshkruar qartë në rregulloret përkatëse; 7. Në kuadër të informimit të publikut, studentëve u jepet informacion edhe në website. Përmendim raportet vjetore institucionale, njoftime për studentët, informacion të programeve të studimit, botimet në revistën shkencore të institucionit, aktivitete të kryera nga studentët në kuadër të pjesëmarrjeve në projekte etj [https://cit.edu.al/].

	<p>Ky informacion i shoqëruar me kuotat dhe kriteret e përvitshme të pranimit përbëjnë informacionin bazë të programit të studimit, i cili disponohet nga Departamenti i Inxhinierise Softuerike dhe pjesërisht vihet në dispozicion të studentëve të ciklit Bachelor dhe të kandidatëve për studentë nga shkollat e mesme.</p>																																																
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” është hartuar edhe në përputhje me VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. Ky program përmban lëndë, aktivitete formuese sipas disiplinave:</p> <p>A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (30 kredite);</p> <p>B. LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore (96 kredite);</p> <p>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (30 kredite);</p> <p>D. LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (18 kredite);</p> <p>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (6 kredite);</p> <p>Për këtë program studimit GVI konstaton një shpërndarje të duhur të lëndëve sipas disiplinave në çdo semestër.</p> <p>Tabela 3: Ndarja e disiplinave sipas viteve akademike</p> <table border="1" data-bbox="491 987 1297 1301"> <thead> <tr> <th></th> <th>Disiplina “A”</th> <th>Disiplina “B”</th> <th>Disiplina “C”</th> <th>Disiplina “D”</th> <th>Disiplina “E”</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Semestri I</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestri II</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>-1</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestri I</td> <td>1</td> <td>3</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestri II</td> <td>2</td> <td>3</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestri I</td> <td></td> <td>4</td> <td>1</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestri II</td> <td></td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>5</td> <td>16</td> <td>5</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>		Disiplina “A”	Disiplina “B”	Disiplina “C”	Disiplina “D”	Disiplina “E”	Semestri I	1	1	2	1		Semestri II	1	3	-1			Semestri I	1	3		1		Semestri II	2	3				Semestri I		4	1			Semestri II		2	1	1	1	Total	5	16	5	3	1
	Disiplina “A”	Disiplina “B”	Disiplina “C”	Disiplina “D”	Disiplina “E”																																												
Semestri I	1	1	2	1																																													
Semestri II	1	3	-1																																														
Semestri I	1	3		1																																													
Semestri II	2	3																																															
Semestri I		4	1																																														
Semestri II		2	1	1	1																																												
Total	5	16	5	3	1																																												
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” është i organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 3 vite akademike me nga 2 semestra mësimdhënie secili. Në përfundim të këtij programi studimesh i korrespondon grumbullimi i 180 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite (30 kredite për semestër).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi përmban 28 lëndë, praktika profesionale dhe tema e diplomës; • 22 lëndë vlerësohen me provime; • Në çdo semester zhvillohen 5 lëndë; • Të gjithë lëndët janë vlerësuar secila me 6 ECTS. • Çdo semestër ka një kombinim të lëndëve sipas disiplinave të përcaktuar edhe në VKM Nr.41 date 24.01.2018; 																																																



	[20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022]																																																																																				
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p>Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese; - Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave; - Dhënie për secilën lëndë të ngarkesës në kredite, numrit total të orëve, numrit të orëve në auditor dhe jashtë auditorit; - Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare e laboratorë; <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe elementë që lidhen me shkallën e detyrueshme të frekuentimit, mënyrën e shlyerjes së lëndëve, përmirësimin e notave, mënyrën e diplomimit etj. GVJ nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit mësimor konstaton:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimi zhvillohet në 15 javë kalendarike me 20 orë/javë; • Ngarkesa mësimore totale është 4500 orë; • Ngarkesa në auditor është 1836 orë; • Ngarkesa jashtë auditorit është 2664 orë; <p>Tabela 4: Shpërndarja e ngarkesës sipas elementeve të programit mësimor</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Totali</th> <th>Teori</th> <th>Seminare</th> <th>Ushtrime</th> <th>Lab</th> <th>Projekt</th> <th>Intership</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>162</td> <td>80</td> <td>40</td> <td>18</td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>156</td> <td>56</td> <td>52</td> <td>36</td> <td>4</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>156</td> <td>40</td> <td>50</td> <td>54</td> <td>6</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>150</td> <td>16</td> <td>62</td> <td>72</td> <td>8</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>150</td> <td>-</td> <td>60</td> <td>90</td> <td>10</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>90</td> <td>-</td> <td>36</td> <td>54</td> <td>6</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>120</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>864</td> <td>192</td> <td>300</td> <td>324</td> <td>96</td> <td>120</td> </tr> <tr> <td>%</td> <td>47.06</td> <td>10.46</td> <td>16.33</td> <td>17.65</td> <td>1.97</td> <td>6.53</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Teori</td> <td colspan="5">Praktike</td> </tr> <tr> <td>%</td> <td>47.06%</td> <td colspan="5">52.94%</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Në programin mësimor praktika zë një peshë më të madhe se teoria (52.94% kundrejt 47.06%); b. Orët teorike dominojnë me shumë në semestrin e parë dhe të dytë të vitit të parë ku janë më shumë disiplina “A”, “C” dhe evidentojmë një rritje të orëve në ushtrime, seminare, laboratore dhe projekte kursi në semestrin e dytë të vitit të dytë dhe në vitin e tretë; c. Raporti teori dhe praktikë ka mbetur i pandryshuar që nga vitit 2016 kur është bërë edhe akreditimi i parë i këtij programi; d. Intershipi është llogaritur 8 orë në javë dhe vlerësohet me 6 ECTS; e. Nuk kemi përfshirje të orëve për përgatitjen e temës së diplomës; 	Totali	Teori	Seminare	Ushtrime	Lab	Projekt	Intership		162	80	40	18	2			156	56	52	36	4			156	40	50	54	6			150	16	62	72	8			150	-	60	90	10			90	-	36	54	6								120	Total	864	192	300	324	96	120	%	47.06	10.46	16.33	17.65	1.97	6.53		Teori	Praktike					%	47.06%	52.94%				
Totali	Teori	Seminare	Ushtrime	Lab	Projekt	Intership																																																																															
	162	80	40	18	2																																																																																
	156	56	52	36	4																																																																																
	156	40	50	54	6																																																																																
	150	16	62	72	8																																																																																
	150	-	60	90	10																																																																																
	90	-	36	54	6																																																																																
						120																																																																															
Total	864	192	300	324	96	120																																																																															
%	47.06	10.46	16.33	17.65	1.97	6.53																																																																															
	Teori	Praktike																																																																																			
%	47.06%	52.94%																																																																																			

	<p>[16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucioni ka paraqitur edhe detyrimet dhe format e vlerësimit të shprehura në rregulloren e programit të studimit dhe në “Vlerësimin e Studentit”; • Mënyra e vlerësimit të studentit është pasqyruar edhe në syllabuset e programit të studimit; • Në këtë program studimi vetëm 22 lëndë zhvillohen me provime. Format e provimeve përfshijnë: <ol style="list-style-type: none"> a. Provimin e pjesshëm i cili zhvillohet në mes të semestrit; b. Provimin final; c. Ri-provimi; d. Provim për përmirësim. <p>Kontrolli i dijeve në provim është ndarë në tre kategori kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Pyetje në lidhje me kontrollin e njohurive: 20-30% të provimit; b. Pyetje për të testuar aftësitë analitike: 40-50% të provimit; c. Pyetje që kërkojnë analizë, punë dhe mendim individual; 20-30% të provimit; <p>GVJ nga shqyrtimi i evidencave dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët, vizita në sekretarinë mësimore dhe verifikimi në mënyrë rastësore të proces -verbaleve të mbajtur për provim nga stafi akademik gjeti një zbatim korrekt të mënyrës së paraqitjes së vlerësimit tek studenti, dhe përdorimin e formave të vlerësimit të tij.</p> <p>Format e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje: 10% • Përbushje e detyrimeve (lab, detyre/projekt kursi): 40%; • Teste/provim i pjesshëm: 20%; • Provimi përfundimtar: 30%; <p>[7. Libri i Rregulloreve Institucionale, takim me stafin akademik, takim me studentët; vizitë në sekretarinë mësimore; 16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 - 2022]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve jepen në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” [10. Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike].</p> <p>Institucioni shpërndan një informacion të gjerë edhe ne website. Kriteret e pranimit janë publikuar dhe japin një informacion në lidhje me mënyrën e aplikimit për studentë vendas dhe të huaj;</p>

ekuivalentimit të studimeve.	Tabela 5: Numri i studentëve të regjistruar sipas viteve			
	Viti akademike	Studentë për herë të parë	Studentë të transferuar	Totali
	2019-2020	74	14	88
	2020-2021	67	5	72
	2021-2022	76	6	82
	Total	217	25	242
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulën/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën [16. <i>Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 - 2022</i>].</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin, duke dhënë edhe ngarkesën në auditor [20. <i>Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 - 2022</i>];</p> <p>Përveç elementëve të kerkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” evidentojmë edhe disa elementë shtesë si:</p> <ol style="list-style-type: none"> paraqitjen e skemës së vlerësimit në gradë dhe ekuivalenti përkatës në shkallën me 4 pikë; Politikat kryesore në lidhje me vlerësimin kur detyrat/projektet janë dorëzuar nga studentët në kohën e duhur dhe penalizimet në të kundërt; Rregullore për frekuentimin; Rregullat për ribërje të testit; Plagjaturën dhe kopjimin dhe penalizimet në lidhje me to; <p>[20. <i>Programet e lëndëve 2021 – 2022; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020</i>]</p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të	Referuar RVB dhe dokumentacionit në dispozicion, programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”, ka pësuar disa ndryshime të vogla që nga momenti i liçensimit të tij. Për vitin akademik 2021 – 2022 janë bërë ndryshime në 5 lëndë por pa ndryshuar peshën e tyre (6ECTS). Konkretisht:			

vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

Tabela 6: Ndryshimet në programin mësimor

Nr	Lende/Moduli	Sem	ECTS
1	Lënda ishte Academic Reading and Writing I	I	6
	Lënda u bë Academic Reading and Writing	I	6
2	Lënda ishte Academic Reading and Writing II	II	6
	Lënda u bë Physic I	II	6
3	Lënda ishte Ethic	III	6
	Lënda u bë E-commerce dhe Innovation	III	6
4	Lënda ishte Fundamentals of Physics	III	6
	Lënda u bë Physic II	III	6
5	Lënda ishte Engineering Fundamentals	III	6
	Lënda u bë Electric Circuits	III	6

Nga takimi me stafin akademik u theksuan edhe ndryshime në masën 20% të cilat konsistojnë më shumë në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së lëndës duke shtuar koncepte të reja, ndryshim në literaturë si pasojë edhe të zhvillimeve të shpejta në fushën e inxhinierisë kompjuterike [takim me stafin akademik].

Për ndryshimet ata nxiten nga progresi i teknologjisë, marrja e mendimit nga kompanitë ku kryhet praktika profesionale dhe nga kërkesat e tregut të punës [takim me stafin akademik]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa është përcaktuar në bazë të sistemit të krediteve ECTS, duke parashikuar 30 kredite në semestër. Nga totali prej 4500 orësh mësimore për të tre vitet e studimit, 1836 orë prej tyre (40.08 %) janë parashikuar në auditor. Ngarkesa javore në auditor është 20 orë (me përjashtim të semestrit të fundit që i korrespondon dhe diplomimit, ku kjo ngarkesë parashikohet më e ulët dhe kemi ndërfaqje të praktikës profesionale që është 8 orë në javë) [16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Sofruerike].
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e	Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve

<p>veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve. Përmbajtja e programit mësimor mundëson studentët të aftësohen në njohuri bazë themelore në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe programimit. Ngarkesa mësimore ka një shpërndarje të drejtë të orëve laboratorike, seminareve, detyra/projekte kursi. Infrastruktura në institucion dhe organizimi i lëndëve duke i dhënë peshën e duhur edhe aftësimin në praktikë të tyre është një tregues i cilësisë së programit mësimor. Institucioni ka nënshkruar shumë marrëveshje me kompani biznesi në drejtim të zhvillimit të praktikës profesionale. Koordinator i programit është përgjegjës edhe për organizimin, monitorimin e zhvillimit të praktikës profesionale. Rregullorja e mirë përcaktuar në këtë drejtim i jep informacion studentit për detyrimet e tij në lidhje me zhvillimin e praktikës dhe përgatitjes së raportit në lidhje me ecurinë e saj. Takimi me studentët tregoi një vlerësim nga ana e tyre për praktikën profesionale.</p> <p><i>[16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; takim me studentët; 49. Informim mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të praktikave mësimore në kompani të ndryshme]</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi mësimor i ciklit të parë “Inxhinieri Softuerike” ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve. Ky program përmban 28 lëndë (secila me 6 ECTS), praktikën profesionale dhe temën e diplomës. Organizimi i lëndëve bëhet në 5 disiplina në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (përmendur edhe në kriteret më lart). Programi mësimor është hartuar me objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentin në fund të diplomimit të tij të cilat, GVJ i gjen të shprehur në rregulloren e programit të studimit. Çdo syllabus është hartuar për të dhënë një konceptim të organizimit të lëndës duke pasqyruar edhe objektivat dhe rezultatet e pritshme për studentin. Programi mësimor monitorohet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike dhe njësitë si NJSBC, Sekretaria Mësimore, Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve të cilët garantojnë mbarëvajtjen e tij dhe cilësinë. Raportet periodike të hartuar në nivel institucional pasqyrojnë punën e kryer dhe rezultatet e arritura.</p> <p>Për vitin 2020 – 2021 përmendim plotësimin e objektivave kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi me sukses i mësimit online. Procesi mësimor është organizuar me sukses dhe me një stabilitet. Platforma Google ka qenë partneri kryesor dhe nga ana e stafit akademik janë bërë përpjekje serizoe për mbështetjen e studentëve në nxënien e njohurive; 2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me partnerë, universitete dhe sipërmarrje. Në lidhje me këtë GVJ shqyrtoi dokumentacionin e raporteve periodike të publikuar në website të institucionit për vitet akademike 2017- 2021 të raportuara edhe në MAS. Në çdo

	<p>raport periodik GVJ konstaton marrëveshje të reja të lidhura në kuadër të bashkëpunimit tregues cilësor ky që institucioni zhvillon në drejtim të forcimit të lidhjeve me kompanitë e biznesit për zhvillimin e praktikave profesionale, mundësive për trajnim dhe punësim;</p> <p>3. <u>Sigurimi i literaturës bashkëkohore</u>. Staf i akademik bën përmirësime në lidhje me përmbajtjen e programit të lëndëve, në drejtim të literaturës. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me McGraw – Hill Education dhe zhvillimi i procesit mësimor në gjuhën angleze kanë krijuar mundësi të përthithjes në mënyrë të shpejtë të literaturës së fundit në fushën e inxhinierisë kompjuterike, pa qenë e nevojshme të harxhohet kohë në lidhje me përkthimin e saj në gjuhën shqipe;</p> <p>4. Ofrimi i praktikave mësimore për studentët në bashkëpunim me sipërmarrjen dhe industrinë;</p> <p>5. Aplikimi për mobilitete në kuadër të programit CEEPUS, ERASMUS+;</p> <p>Bazuar për sa më sipër dhe referuar objektivave formues të shprehur në rregulloren e programit të studimit citojmë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit;</i> <i>Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale;</i> <i>Formim qytetar të përgjithshëm;</i> <i>Aftësi bazike për punë kërkimore;</i> <i>Aftësim për promovim personal;</i> <i>Diplomë pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon si është kuptuar puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse.</i> <p>GVJ konkludon se programi në tërësinë e tij përmbush në çdo vit akademik objektivat e vendosura dhe synimet e pritshme tek studentët. Cilësia e temave të diplomave, punësimi i tyre në fund të studimeve janë tregues të përmbushjes së objektivave të vendosura për këtë program studimi.</p> <p>[27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS: 10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike; 16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022;]</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të</p>	<p>GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</p> <p>Programi i studimit bachelor në “Inxhinieri Softuerike” ka aplikuar edhe “Kodet e Lëndëve” bazuar në praktika dhe metodologji të Universiteteve Amerikano – Veriore. Sistemi i vlerësimit bëhet me pike (0-100) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 0 deri në 4 dhe shprehet edhe në germa nga “F” në “A+”. Vlerësimi i</p>

<p>ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>programit në kredite evropiane ECTS dhe në kredite amerikane mundëson lehtësi në njohjen, ekuivalentimin dhe transferimin e studentëve në vende të tjera. Programi ka një raport të drejtë midis teorisë dhe praktikës (47.06% teori dhe 52.94% praktikë).</p> <p>Përmbajtja e lëndëve, mënyra e organizimit të tyre, shpërndarja e tyre në semestra akademike, format e organizimit të mësimin dhe të vlerësimit (provime+ detyra kursi/projekte individuale ose në grup+ pjesëmarrja aktiv në procesin mësimor) janë shumë të përafërta me programe të tjera të ngjashme ndërkombëtare. Aktivizimi i pedagogëve të huaj si lektorë ka sjellë një frymë të re në procesin mësimor dhe në mënyrën e organizimit të tij. Në takime u theksua rritja e ndërkombëtarizimit përmes përthithjes së studentëve të huaj në këtë program studimi. Bazuar në evidencat e paraqitura dhe takimet e zhvilluara, GVJ konkludon se programi në tërësinë e tij është në përputhje me programe të përafërta ndërkombëtare.</p> <p>[27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS; 10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike; 16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022;]</p>					
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS dhe kredite amerikane lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjatë periudhës 2019-2022 janë transferuar 25 studentë kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë [85. RVB e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike;] • Personeli akademik si dhe studentë të cilët kanë përfutur mobilitete në institucione analoge jashtë vendit në programe të ngjashme kanë konstatuar një përputhje të mirë të këtij programi studimi me programe analoge. Mobilitete të studentëve për vitin 2021 – 2022 janë 2 studentë në Universitetin Graz Austri ku njëra prej studenteve në lidhje online pasqyroi edhe punën e saj në këtë universitet [takim me studentët, 85. RVB e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike] • Për periudhën 2016 – 2021, numri i studentëve të punësuar në përputhje me fushën e punësimit është e lartë [85. RVB e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike, tabela 23]. <p>Tabela 7: Numri i studenteve të punësuar</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Nr total i studentëve</th> <th>Punësimi në përputhje me diplomën</th> <th>Punësimi jo në përputhje me diplomën</th> <th>Të papërcaktuar</th> </tr> </thead> </table>	Programi i studimit	Nr total i studentëve	Punësimi në përputhje me diplomën	Punësimi jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
Programi i studimit	Nr total i studentëve	Punësimi në përputhje me diplomën	Punësimi jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar		

	Bachelor në "Inxhinieri Softuerike"	197	113	11	73
	%		57.4%	5.6%	37%
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>GVJ konstaton se për vitin 2021 – 2022 janë bërë ndryshime në emërtesë dhe në subjekt për 5 lëndë pjesë përbërëse e programit të studimit [85. RVB Bachelor në Inxhinieri Softuerike, tabelat përmbledhëse].</p> <p>GVJ shqyrtoi 28 syllabuse të paraqitura nga institucioni për këtë program dhe në vëmendje pati literaturën e detyruar dhe ndihmëse. Literatura që i ofrohet studentit është bashkëkohore dhe në gjuhën angleze. Në takimin me stafin akademik u theksua puna që bëhet në drejtim të rishikimit të literaturës si pasojë e zhvillimeve të shpejta teknologjike. Bashkëpunimi me McGraw Hill mundëson që studentët të kenë literaturë inxhinierike bashkëkohore. Aksesimi në bibliotekën virtuale të McGraw-Hill Education dhe platformën O'Reilly krijon lehtësi dhe avantazhe për studentët në lidhje me literaturën e huaj [takim me stafin akademik, takim me studentët].</p> <p>Institucioni investon në lidhje me blerjet online të literaturës inxhinierike. Në tërësi për periudhën 2016-2022 janë investuar 17,916,573.23 lekë për libra online dhe 949,264 lekë për libra hard copy. GVJ thekson se të dhënat e paraqitura janë përmbledhëse të programeve dhe aspak të veçantë për programin e marrë në studim.</p>				
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinier Softuerike", i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të parë. Nga takimet me studentët rezulton se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre. Studentet shprehën kënaqësi në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, organizimin e tij dhe veçanërisht dhanë mendim pozitiv për praktikën profesionale dhe mundësitë që institucioni ofron në lidhje me punësimin e tyre pas diplomimit [takim me studentët].</p>				
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ofron programin e ciklit të parë "Inxhinieri Softuerike" dhe në vijim ofron edhe program Master i Shkencave në "Inxhinieri Softuerike". Në takimin me studentët u konstatua dëshira e tyre për vazhdimin e studimeve të thelluara në këtë drejtim. Bashkëpunimet e vazhdueshme me sipërmarrje private dhe institucione shtetërore kanë ofruar mundësi jo vetëm në zhvillimin e praktikave profesionale por edhe në punësimin e studentëve. Takimi me përfaqësues të zyrës së çështjeve studentore solli shembuj të thirrjeve që ata marrin në lidhje me kërkesat që kompanitë shprehin për punësim të studentëve në fushën e inxhinierisë softuerike [takim me stafin akademik, takim me studentët; takim me përfaqësues të zyrës së çështjeve studentore]</p>				

<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni në përgjithësi si dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierise Softuerike në veçanti, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm nga tregu i punës si dhe nëpërmjet projekteve që lidhen me punësimin apo aktivitete të organizuara nga Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve në lidhje me studentët dhe tregun e punës, kanë synuar nga njëra anë përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut e punës dhe nga ana tjetër ofrimin dhe njohjen e studentëve me këtë treg [takime ne institucion].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>																																																				
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>																																																			
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar edhe në kornizën ligjore në fuqi, stafi akademik i angazhuar në programe të ciklit të parë duhet të zoterojë gradë shkencore pasardhëse. GVJ nga shqyrtimi dokumentacionit të paraqitur nga institucioni konstaton se ky kriter ligjore përmbushet [85. RVB Bachelor në Inxhinieri Softuerike]</p> <p>Tabela 8: Stafi akademik PAE dhe PAK</p> <table border="1" data-bbox="496 1305 1295 1496"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti</th> <th colspan="4">PAE</th> <th colspan="3">PAK</th> </tr> <tr> <th>Prof.Dr</th> <th>Prof.As.</th> <th>Dr.</th> <th>Msc</th> <th>Prof.As</th> <th>Dr.</th> <th>Msc</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>10</td> <td>8</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>7</td> <td>8</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>7</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1" data-bbox="496 1536 1295 1760"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Total PAE</th> <th>Total PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>22</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>19</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>20</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>Mbulimi i programit në përqindje sipas viteve akademike është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin akademik 2021-2022 95.2% PAE dhe 4.8% PAK; 	Viti	PAE				PAK			Prof.Dr	Prof.As.	Dr.	Msc	Prof.As	Dr.	Msc	2019-2020	2	2	10	8	-	1	1	2020-2021	2	2	7	8	-	-	-	2021-2022	2	4	7	7	-	1	-	Viti akademik	Total PAE	Total PAK	2019-2020	22	2	2020-2021	19	-	2021-2022	20	1
Viti	PAE				PAK																																															
	Prof.Dr	Prof.As.	Dr.	Msc	Prof.As	Dr.	Msc																																													
2019-2020	2	2	10	8	-	1	1																																													
2020-2021	2	2	7	8	-	-	-																																													
2021-2022	2	4	7	7	-	1	-																																													
Viti akademik	Total PAE	Total PAK																																																		
2019-2020	22	2																																																		
2020-2021	19	-																																																		
2021-2022	20	1																																																		

- Për vitin akademik 2020-2021 **100% PAE dhe 0% PAK;**
- Për vitin akademik 2019-2020 **91.7% PAE dhe 8.3% PAK;**

Referuar tabelës përmbledhëse, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik me kohë të plotë.

GVJ e vlerëson si pozitiv faktin që institucioni angazhon një staf akademik me kohe të plotë. Raporti në grada shkencore për stafin akademik të angazhuar në vite vijon si më poshtë:

Tabela 9: Raporti në përqindje i shkallës së kualifikimit të stafit PAE dhe PAK

Viti	PAE				PAK		
	Prof.Dr	Prof.As.	Dr.	Msc	Prof.As	Dr.	Msc
2019-2020	8.3%	8.3%	41.7%	33.3%	-	4.2%	4.2%
2020-2021	10.5%	10.5%	36.9	42.1%	-	-	-
2021-2022	9.5%	19%	33.3%	33.4%	-	4.8%	-

Përqindjen më të madhe në programin e studimit e zë stafi akademik me grada shkencore Dr-Prof.Dr.

Ngarkesa mësimore

Ngarkesa llogaritet edhe mbi bazën e kornizës ligjore në fuqi (përcaktuar në Udhëzimin Nr.29, datë 10.9.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”). Ngarkesa mësimore plan përcaktohet në fillim të vitit akademik dhe në fund të tij stafi plotëson formularin e vetvlerësimit në lidhje me ngarkesën e realizuar. Përgjegjësi i Departamenti të Inxhinierisë Softuerike është përgjegjës për raportimin e plan ngarkesës dhe realizimin e saj tek Zyra e Burimeve Njerëzore në fillim dhe në fund të vitit akademik [7. *Libri i Rregulloreve Institucionale, kapitull XI; takim me stafin akademik*]

Në lidhje me ngarkesën mësimore, kriteret janë dhënë edhe në “Librin e Rregulloreve, Kapitulli XI”. Institucioni nuk lejon stafin akademik të ofrojë më shumë se 4 lëndë. GVJ konstaton se nuk kemi mbingarkesë të stafit akademik. Ngarkesa luhet midis 180 – 330 orë, ndërsa për stafin PAK ajo arrin 120 orë. Stafi me gradën MSc ka një ngarkesë që luhet midis 300 – 330 orë [85. *RVB Bachelor në Inxhinieri Softuerike*].

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik

GVJ shqyrtoi fushat që mbulon stafi akademik i angazhuar në program sipas gradave shkencore. Tabela më poshtë jep një listë të lëndëve që ata ofrojnë në mësimdhënie.

Tabela 10: Lista e lëndëve që stafi akademik ofron në programin Bachelor “Inxhinieri Softuerike”

Grada shkencore	Lëndë përkatëse
Prof. Dr.	1. Academic Reading & Writing I &II

për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.		<ol style="list-style-type: none"> 2. Computer Applications 3. Computer Science Fundamentals 4. Engineering chemistry 5. Physic I 6. Signals and systems
	Prof. Asoc.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Calculus I 2. Linear Algebra
	Dr.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Introduction to statistics 2. SW Systems dynamics 3. Introdution to statistics 4. Calculus II 5. Fundamentals of Physic II 6. Embedded Systems 7. Engineering Fundamentals 8. Electric Circuits 9. Calculus I & II 10. Introduction to economics 11. Advanced research methods <p>PAK</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Introduction to web design
	Dr. në process	<ol style="list-style-type: none"> 1. Computer Architecture & Assembly Language 2. Computer Communication & Network II 3. Software project management
	Msc.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Introduction to operating systems 2. Security Engineering 3. Operating Systems 4. Fundamentals of Programming I & II 5. Computer applications 6. Computer Communications & Networks I 7. Computer Science Fundamentals 8. Software Architecture and Systems 9. Computer applications 10. Introduction to software engineering 11. Database systems 12. Software project management 13. Academic Reading and Writing I 14. Research methods

Bazuar në të dhënat e tabelës konstatohet:

1. Staf i akademik me grada MSc mbulon më shumë lëndë të disipline B dhe C të cilat në programin mësimor zënë një pjesë të madhe. Për sa më sipër mbështesim sugjerimin e dhënë edhe në kriterin 4, Standarti II.2, Fusha II.

<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e interesit dhe kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë [21. CV e stafit Akademik te programit Bsc. në Inzhinieri Softuerike] • Takimi me stafin akademik dëshmon për angazhimin dhe motivimin e tyre në drejtim të mësimdhënies [takim me stafin akademik] • Stafi akademik bën përpjekje në lidhje me pjesëmarrjen e tij në konferenca dhe botime në revistën periodike CIT Review të institucionit dhe në revista të tjera shkencore me faktor impakti. Institucioni mbështet stafin akademik në përpjekjen e tij drejt plotësimit me grada shkencore. Institucioni ofron pedagogët të botojnë artikujt e tyre në revistën CIT review pa pagesë. Gjithashtu konferencat dhe aktivitetet shkencore që institucioni organizon për stafin akademik ofrohen pa pagesë [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; takim me stafin akademik]
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar një numër marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani [85. Raporti RVB]. Institucioni synon në rritjen e numrit të bashkëpunimit me kompani biznesi, institucione të tjera IAL dhe të rrisë partneritetin në projekte kërkimore shkencore. Ndërkombetarizimi është një nga objektivat bazë të KU IKT. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë kategorizuar në 4 kategori/:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për mobilitet studentore dhe të stafit akademik; 2. Për praktika mësimore; 3. Projekte, konferenca dhe tryeza të përbashkëta ku mund të përfshihet stafit dhe studentët; 4. Për mundësi bashkëpunimi të ndryshme, njohje kreditesh dhe mundësi për diploma të përbashkëta; <p>Në takimet e zhvilluara në institucion pjesëmarrësit shprehën impaktin pozitiv nga bashkëpunimi sidomos në drejtim të praktikës profesionale, punësimit dhe mobilitetit të studentëve. [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS, takim me stafin akademik; takim me studentët]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve</p>	<p>Personeli ndihmës akademik i Departamentit të Shkencave Softuerike është i angazhuar kryesisht për mbulimin e seanceve praktike laboratorike të lëndëve të përfshira në programin e studimit. Ky department angazhon 1 personel ndihmës akademik [85. RVB Bachelor në Inzhinieri Softuerike, tabelat përmbledhëse]</p>

laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>KU IKT në fokus të aktivitetit të tij ka cilësinë e mësimdhënies. Në këtë drejtim inkurajon dhe mbështet të gjithë format dhe metodat në mësimdhënie të cilat garantojnë aftësimin e studentit.</p> <p>Dokumentat bazë që rregullojnë dhe mbështesin zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në fushën e mësimdhënies janë si vijon më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strategjia e mësimdhënies në ICT <p>Përmes kësaj strategjie janë dhënë edhe udhëzimet bazë në lidhje me format dhe teknikat e mësimdhënies në ICT. Në fokus të saj janë përcaktimi i vlerave bazë, adoptimi me ndryshimet, forcimi i marrëdhënies së ngushtë midis mësimdhënies, studimit, kërkimit dhe zhvillimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore mbi hartimin e programit të lëndës <p>Programi i lëndës hartohet në fillim të vitit akademik dhe është konsideruar si një kontratë midis stafit akademik nga njëra anë dhe strukturave administrative në anën tjetër pa harruar edhe studentët. Në këtë rregullore specifikohen format kryesore të mësimdhënies ku përmendim leksionet, seminarët, ushtrimet, kolokuimin, punën</p>

	<p>laboratorike, detyrat e kursit, punë e pavarur në shtëpi, provimet e pjesshme, provimi final dhe tema e diplomës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Syllabuset <p>Në përmbajtjen e tyre çdo pedagog përshkruan edhe format e mësimdhënies që ai synon të përdorë në lëndën e tij gjatë procesit mësimor;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore për mësimin online <p>Bazuar edhe në një nga pikat e strategjisë së mësimdhënies e cila është adoptimi me ndryshimet, në përballje të situatës së covid – 19, institucioni ka hartuar edhe udhëzues në lidhje me zhvillimin e mësimin online. Udhëzues janë hartuar për stafin akademik dhe studentët ku janë dhënë qartë instruksionet në lidhje me organizimin e mësimin online, format e komunikimit, mënyra e prezantimit të materialit etj. [D2. Rregullore për menaxhimin e mësimin dhe mësimdhënies online]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>KU ICT ka ngritur mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies në mënyrë periodike. GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor nga ana e Institucionit, konstaton strukturat përgjegjëse si vijon më poshtë:</p> <p>1. Departamenti i Shkencave Softuerike</p> <p>Përgjegjësi i Departamenti të Shkencave Softuerike në termat e mësimdhënies ka kompetenca të përcaktuara në rregulloren e departamentit. Përmendim këtu:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sigurimin e zbatimit të programit mësimor në përputhje me rregulloren institucionale, aktet ligjore në fuqi; b. Kujdesi për përmbajtjen e programit dhe syllabuseve të tij; c. Përgatitjen në bashkëpunim edhe me sekretarinë mësimore të orarit mësimor dhe monitorimin e tij; d. Është përgjegjës për ekzaminimin e performancës së stafit akademik; e. Bashkëpunon ngushtë me koordinatorin e programit në lidhje me temat e diplomës, procesin e organizimit të praktikave profesionale; <p>Në fillim të vitit akademik Departamenti i Shkencave Softuerike në bashkëpunim edhe me zyrën e burimeve njerëzore përcaktojnë edhe ngarkesën mësimore plan dhe në fund të vitit japin edhe raportimin në lidhje me realizimin e saj. [9. Rregullore e departamentit të Inzhinierisë Softuerike]</p>

	<p>Departamenti bashkëpunon ngushtë edhe me stafin akademik. Matja e performancës së stafit akademik realizohet përmes vlerësimit të tij në forma kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportimit për realizimn e procesit mësimor. Përbushja e objektivave dhe pengesat e hasura. Ky raportim pasqyrohet edhe në raportin vjetor institucional që dërgohet edhe në MAS; • Vetvlerësimi i aktiviteteve nga ana e stafit akademik. Këta të fundit plotësojnë formularë në lidhje me realizimin e punës së tyre në drejtim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; <p>[14. Manuali i Stafit Akademik (Staff Handbook)]</p> <p>2. NJSBC</p> <p>NJSBC është strukturë institucionale e krijuar që në vitin 2013 dhe që luan një rol bazë në garantimin e cilësisë në mësimdhënie. Ajo e zhvillon funksionin e saj mbi tre komponentet kryesore mbi bazën e të cilëve funksionon edhe sistemi i cilësisë në institucion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programe studimi me cilësi; 2. Pedagogë kompetentë, të përshtatshëm për programet e studimit; 3. Proces studimi i orientuar nga studentët; <p>[11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook ; 29. Model Pyetëtori Bachelor Inxh Softuerike ; 30. Model Pyetëtori për Stafin. ; 31. Model Vetvlerësimi i stafit akademik 2020 – 2021]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies. Niveli i cilësisë së programit të studimit garantohe përmes parimeve themelore dhe proceseve të shprehur edhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesëmarrjen e studentit në vendimarrje; 2. Mbledhja dhe analizimi i informacionit, e rëndësishme për vlerësimin cilësor të procesit mësimor; <p>[11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook]</p> <p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit konsiderohet nga institucioni si një faktor që duhet trajtuar veçantë. Mendimi i studentëve konsiderohet i rëndësishëm dhe procesi i përthithjes së opinionit të tyre trajtohet veçantë nga ana e NJSBC. Formularë të veçantë janë hartuar për studentët dhe plotësimi i tyre bëhet në fund të çdo semestri. Në këto pyetësorë merret opinionin i studentit në lidhje me organizimin e programeve, pedagogët e lëndës, literatura e përdorur. Të dhënat e mbledhura përpunohen nga NJSBC dhe pasqyrohen në raportet vjetore institucionale. Pyetësorët plotësohen në formë elektronike duke garantuar edhe</p>



	<p>ruajtjen e anonimatit [takim me studentët, takim me përfaqësues të NJSBC];</p> <p>Përsa i përket trajtimit të ankimeve të studentëve, kjo e drejtë sanksionohet në Librin e Rregulloreve Institucionale. Kapitulli VII trajton edhe Politikën dhe Procedurat e Ankesave të Studentit. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se ata ishin në dijeni të afateve kohore të ankesave por nuk sollën shembuj në lidhje me to [7. Libri i Rregulloreve Institucionale, faqe 93; takim me studentët].</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni shpërndan informacion në lidhje me rezultatet e pyetsorëve. Bazuar edhe në hierarkinë strukturore, NJSBC e cila është përgjegjëse për implementimin e procesit të anketimit, bën edhe përpunimin statistikor të të dhënave të mbledhura. Të dhënat raportohen tek:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rektori i KU IKT; Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë; Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë Softuerike; Zyra e Burimeve Njerëzore; Individualisht të çdo pedagog për rezultatet në lidhje me lëndën e tij; <p>Të dhënat bëhen publike edhe në website. Një rubrikë e veçantë i është dedikuar NJSBC ku janë publikuar edhe rezultatet e pyetsorëve për çdo vit akademik [https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2022/01/Survey; 30. Model Pyetesori për Stafin]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstatoi se një rol të madh në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies luan NJSBC e cila njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare. Njësitë kryesore mund të promovojnë jo vetëm stafin e tyre por edhe praktikave të mira dhe shembujt që nxisin tek studentet dhe stafi përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. GVJ u informua se bazuar mbi vlerësimet, kontributin si dhe ecurinë e proceseve akademike dhe administrative, institucioni ka vlerësuar për kontribute personalitete të ndryshme të stafit akademik dhe studentë për arritjet e tyre si në procesin mësimor ashtu dhe për arritje në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare të lidhura me kompeticione, projekte etj. [Ev. Takime në institucion; RVB; https://cit.edu.al/blog/]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Një orë mësimore e ka kohëzgjatjen 60 minuta. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë leksionet, seminarët, laboratorët dhe detyrat e kursit. GVJ shqyrtoi me vemendje 28 syllabuse të paraqitura nga Institucioni dhe konstaton:

Në përmbajtjen e syllabusit:

- Në syllabuse janë dhënë format e organizimit të lëndës ku përfshihen pjesëmarrje në diskutime, punë në grup, orët e ushtrimeve dhe seminareve, projekt kursi, detyra shtëpie, prezantime;
- Në përmbajtjen e syllabusit janë dhënë tematika e orëve por trajtimi i çështjeve në orët laboratorike për ato lëndë të cilat e përfshijnë nuk e gjejmë të pasqyruar. *Rekomandojmë që të përfshihen në syllabuse edhe tematika e orëve laboratorike për lëndët të cilat e trajtojnë;*

Në format e vlerësimit të studentit :

- Projekti konsiderohet në 22 lëndë i rëndësishëm për vlerësimin e studentit;
- Në një pjesë evidentojmë kombinim të assignments me testime ose detyra shtëpie;
- Vetem në një syllabus “Fundamentals of Physic and Engineering” konstatojmë përfshirjen e Labororit në vlerësimin e studentit në masën 5%;

Tabela 11: Format e vlerësimit të vendosur në 28 syllabuse

Projekte	Lab	Detyrë shtëpie	Detyrë praktike	Teste
22	1	3	16	1

[20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022;]

Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe

Në takimin me stafin akademik u theksua puna që bëhet në drejtim të mësimdhënies. Diskutimet në grup, prezantimet, puna individuale dhe në grup për projektet, gadishmëria për të dhënë ndihmë në raste vështirësish tek studentët janë disa nga format që ata përdorin në punën e tyre. Gjatë periudhës së pandemisë, format e mësimdhënies kanë ndryshuar formën e tyre. Stafi akademik ishte përgatitur më përpara për mësimin online. Gjithsesi në situatën e krijuar ata kanë punuar më shumë në lidhje me ndihmën tek studentët për detyrat dhe projektet e kursit. Ndërveprimi pedagog – student ka qenë shumë aktiv.

<p>natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka edhe koordinatorin e programit i cili mbështet studentët, organizon praktikat profesionale. Në bashkëpunim edhe me zyrën e çështjeve studentore ata i japin asistencë studentit edhe për problematika që ata hasin gjatë orëve të mësimit dhe jashtë saj <i>[takim me studentët, takim me stafin akademik; Ev. Takime në institucion].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • KU IKT ka hartuar edhe “Strategjinë e mësimdhënies” që udhëzon stafin akademik të përdorin forma të larmishme dhe të adoptojnë forma të reja në përshtatje me ndryshimet <i>[7. Libri i Rregulloreve Institucionale].</i> • Gjatë periudhës së pandemisë, manuali i mësimit online është hartuar dhe zbatuar me korrektësi nga stafi akademik <i>[D2. Rregullore për menaxhimin e mësimit dhe mësimdhënies online]</i> • Në mbështetje të mësimdhënies kanë shërbyer edhe lektorët e huaj, leksionet e hapura, vizita në kompani; • Puna në grup është konsideruar efektive dhe në formën e vlerësimit ku gjithsecili është vlerësuar për punën e tij në grup. Nga studentët u pranua si një formë që nxit bashkëpunimin dhe në të njëjtën kohë u pranua vlerësimi korrekt i gjithsecilit pjesë e grupit të punës në projekt <i>[takim me studentët].</i>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë <i>[21. CV e stafit Akademik të programit Bsc. në Inxhinieri Softuerike; 22. CV e stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë].</i></p> <p>Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga personeli akademik i DIS. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në lëndët që mbulojnë dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie <i>[50. Certifikata trajnimesh dhe ëorkshopesh dhënë stafit të IKT].</i></p> <p>Gjithsecili pavarësisht gradës shkencore ka pasqyruar në syllabus format e mësimdhënies në përshtatje me lëndën, profilin e saj dhe rëndësinë që luan në programin mësimor.</p> <p><i>[16. Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike; 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022]</i></p> <p>Punë e veçantë bëhet me pedagogët e rinj. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike në fillim të vitit akademik (kryesisht në muajin Shtator) organizon një trajnim 1 – ditor me pedagogët e rinj. Ndihej në këtë drejtim ofrohet edhe nga stafi i vjetër. Ndiheja bazohet në hartimin e syllabusit, format e mësimdhënies, hartimin e leksioneve dhe organizimin e orëve të ushtrimeve dhe në zgjidhjen e tyre <i>[takim me stafin akademik]</i></p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies). Të dhënat e pyetsorëve u bëhen të njohur edhe stafit i cili bazuar në mendimin e studentëve reflekton në lidhje me ndryshimin e formës së mësimdhënies.</p> <p>Puna në grup konsiderohet e rëndësishme dhe në vetvete është edhe një kërkesë e tregut të punës. Për këtë arsye edhe 28 syllabuse trajtojnë projektet si një formë frytdhënëse dhe efektive për përgatitjen e studentëve nga ana praktike por edhe për të përgatitur ata me frymën e bashkëpunimit. Reflektimi i stafit akademik karshi mendimit të studentëve është efektiv. Përmirësime bëhen në trajtimin e orëve, në trajtimin e tematikave. Në takimet në institucion u paraqit vetëm një rast ku pedagogu nuk kishte reflektuar karshi mendimit të studentëve dhe në vijim u monitorua nga departamenti dhe kur u konstatua një mos ndryshim i sjelljes së tij, kontrata nuk u rinovua. [<i>takim në institucion</i>]</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Personeli akademik përdor metoda interaktive. Presantimet, diskutimet, case studies janë disa forma që përdoren nga stafi akademik në shërbim të mësimdhënies. Quizet është një formë e cila është konsideruar edhe në format e vlerësimit të studentit gjatë mësimin online. Pjesëmarrja aktive është prezente dhe konsiderohet me 10% në vlerësimin përfundimtar të tij [16. <i>Planet mësimore të programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike</i>; 20. <i>Programet e lëndëve 2019 – 2020</i>; 20. <i>Programet e lëndëve 2020 – 2021</i>; 20. <i>Programet e lëndëve 2021 – 2022</i>]</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Zhvillimi i autonomisë së studentit, rritja e aftësisë analitike të tij, të menduarit dhe analizimi dhe gjetja e zgjidhjeve në situatë kritike janë disa aspekte mbi të cilat institucioni punon në drejtim me studentët. Megjithëse inkurajohet puna në grup (4-5 studentë) në projekte, paralelisht punohet edhe për zhvillimin e individualitetit të studentit. Dhënia e detyrave praktike, zhvillimi i orëve laboratorike, detyra shtëpie, janë disa forma që janë zgjedhur nga stafi akademik në drejtim të punës së tyre me studentët. Situata e pandemisë, ka inkurajuar punën individuale të studentit edhe në projekte kursi. Finalizimi bëhet me zhvillimin e temës së diplomës ku studenti shfaq aftësinë e tij për të analizuar në kuadrin teorik dhe praktik një tematikë të caktuar. Pjesëmarrja e studentëve në shumë evente dhe thirrje ka treguar cilësinë e punës së stafit akademik në drejtim të aftësimin praktik por edhe të zhvillimit të autonomisë në mendim dhe veprim [<i>takime në institucion</i>].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Procesi mësimor zhvillohet në Kampusn e Ri, brenda Tiranës, në kompleksin Xhura, rruga Xhanfize Keko, Nr.12. Nga vizita e realizuar në institucion, GVJ konstatoi se procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Fakulteti i Inxhinierisë e zhvillon aktivitetin e tij në ambiente me sipërfaqe totale prej rreth 2100m², ndërsa në shërbim të programit të studimit (por edhe të programeve të tjera) janë rreth 1174m² [Ev. Vizita e ambienteve; RVB]</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim cilësor të këtij procesi, që përfshin: ngrohje-ftohjen, ndriçimin, tabelat, projektorë dhe çdo gjë tjetër të domosdoshme për këtë qëllim. Një kontribut i rëndësishëm ofrohet nëpërmjet bazës laboratorike, e cila, në drejtim të paisjeve kompjuterike të nevojshme për zhvillimin e seancave laboratorike, është e viteve të fundit dhe e paisur me softet e nevojshme. [Ev. Vizita e ambienteve; RVB].</p> <p>Në shërbim të programit janë 3 klasa me një sipërfaqje totale 163 m² për zhvillimin e orëve teorike, ushtrime dhe seminare. Në funksion të programit mësimor janë edhe 2 laboratorë si edhe një auditor i madh me sipërfaqje 200 m² (që shërben si sallë konferencash) me kapacitet 180 persona. Në ndërtesë është instaluar sistemi HVAC duke krijuar një konfort termik për zhvillimin e procesit mësimor në perputhje me stadartet e kërkuara. Ndriçimi është sipas sandartit. Klasat janë të ndriçuara drejt dhe të pajisura me tabela, projektorë, kompjutera për laboratorët dhe mjete të tjera didaktike ndihmëse në shërbim të procesit mësimor. Një ndihmës asistent është i pranishëm në laboratorë për të dhënë asistencën dhe mirëmbajtjen e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Për nga vetë profili i programit Bachelor në "Inxhinieri Softuerike", në masën më të madhe elementët formues të tij funksionojnë mbi bazën e një infrastrukture kompjuterike solide dhe që ndjek ndryshimet e shpejta në këtë fushë. GVJ konstatoi se infrastruktura IT mbështet plotësisht realizimin e procesit mësimor. Referuar RVB dhe takimeve në institucion GVJ u informua për funksionimin në KU IKT fillimisht platforma e-learning (e cila u krijua në kuadër të shkollës verore). Në vijim, në kushtet e pandemisë, u kalua në përdorimin e Google Classroom nëpërmjet të cilës postoheshin edhe materialet për çdo temë mësimore si dhe</p>

	<p>Google Meet për të mundësuar komunikimin online. Gjithashtu UMS (University Management System), një sistem menaxhimi i realizuar nga stafi akademik dhe studentët kontribon në menaxhimin e të dhënave lidhur me procesin mësimor [Ev. Takime në institucion; RVB; https://ums.cit.edu.al/].</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se gjithë literatura në mbështetje të procesit mësimor ofrohet në gjuhën angleze. Kjo mbështetet nga një marrëveshje me McGrawHill Education dhe O'Reilly duke mundësuar që pjesërisht të disponohen librat në format letër dhe në një masë të madhe në format elektronik në sajë të bibliotekës virtuale. Për vetë zhvillimet e shpejta të shkencave kompjuterike, biblioteka virtuale mundëson aksesin në tekste që u korrespondojnë viteve të fundit. [Ev. Vizita në bibliotekë]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ u informua se biblioteka ka rreth 3000 tituj, nga të cilët rreth 2780 tituj në anglisht. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 90 m² dhe një kapacitet prej 20 vendesh, ku 6 vende janë për përdorim kompjuteri dhe interneti [Ev. Vizita në bibliotekë; RVB].</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë online të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu ofrohen online më se 65 mijë tituj, libra në version audio, video, evente live (kurse online live në internet, biseda me ekspertë, konferenca teknologjike virtuale Superstream etj.), mësim ndërveprues (Sandboxes, skenarë, dhe fletore Jupyter, të mësohet duke vepruar), provime praktike (testet interaktive që ndihmojnë për t'u përgatitur për provim). Veç këtyre, studentët kanë mundësi të aksesojnë edhe burime të hapura (Open Source) që përfshijnë literaturë, tekste, manualë dhe revista shkencore. [Ev. Vizita në bibliotekë; RVB; Të dhëna mbi bibliotekën OREILLY-TEXO për CIT; https://cit.edu.al/library-2/]</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ u njoh me laboratorët në shërbim të procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" dhe konstatoi se ata janë të pajisur me kompjutera të kohës dhe me softuerët e nevojshëm për të realizuar punët e laboratorit, detyrat, projektet, temat e diplomave si dhe eventualisht punimet kërkimore. Laboratorët kanë një kapacitet qëvarion 30 – 50 vende. Sistemet e shfrytëzimit si dhe softuerët e instaluar në ta janë të licensuar ose përdorin versione open source [Ev. Vizita në ambientet e institucionit; RVB].</p>


<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>KU IKT në funksion të procesit mësimor përdor edhe platformat online:</p> <ol style="list-style-type: none"> CIT E –learning (punuar nga stafi dhe studentët); Google Meet/Class e cila u përdor gjerësisht për mësimin on-line gjatë periudhës së pandemisë; UMS (University Management System) që përdoret nga stafi akademik dhe studentët për rezultatet, vlerësimet, komunikimet; Platforma O'Reilly për bibliotekë on-line; <p>[Ev. Vizita në ambientet e institucionit; RVB].</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Për komunikimin në kuadër të realizimit të procesit mësimor për programin e studimit përdoret platforma Google Meet/Classroom. Gjithashtu GVJ u informua se studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimet, detyrave, orarit etj nëpërmjet sistemit UMS (University Management System) i cili ofron një akses të individualizuar në sistem (aksesim i mundësuar nëpërmjet faqes web të institucionit - rubrika <i>My CIT</i>) [Ev. Takime në institucion; RVB; https://ums.cit.edu.al/].</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Procedura e përzgjedhjes së temave të diplomave dhe e mënyrës së drejtimit të tyre janë përcaktuar në rregulloren e programit të studimit, manualin e punimit të tezës së diplomës dhe modelin e përcaktimit të temës së diplomës. GVJ u informua se stafi akademik u jep studentëve informacionin e domosdoshëm që ata duhet të dijnë mbi temën e diplomës si dhe paraprakisht orientohen drejt fushave dhe temave që ata mund të zgjedhin përmes listës që u vihet në dispozicion. Gjatë përgatitjes së punimit të diplomës studenti mbikqyret dhe asistohet nga udhëheqësi shkencor i cili e ndihmon atë në të gjitha fazat.</p> <p>[Ev. Model i përcaktimit të temës së diplomës; Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës; Temat e diplomave, studentët dhe udhëheqësit 2020-2021; RVB]</p> <p>Në takimet e zhvilluar u konstatuan edhe vështirësitë që stafi akademik has në gjetjen e tematikave të përshtatshme për punimet e diplomës. Numri i lartë i studentëve dhe zhvillimi i tematikave të veçanta në përshtatje edhe me situatat dhe studentin ka bërë që në të ardhmen të mendohen edhe ndryshime në organizimin e temës së diplomës. Departamenti ka filluar të mendojë mundësinë që vetëm studentët me një mesatare të lartë të kenë mundësinë të zhvillojnë tema diplome ndërsa pjesa tjetër ti nënshtrohet edhe provimit final. Bazuar për sa më sipër dhe duke parë edhe tematikën e trajtuar në temat e diplomave, <u>GVJ i sugjeron Departamentit të Inxhinierisë Softuerike që për ciklin e parë Bachelor në këtë</u></p>



	<i>program studimi të konsiderojë vendosjen e kriterit të mesatares për studentët që duhet të zhvillojnë temën e diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>KU IKT i kushton një vëmendje të veçantë garantimit të cilësisë në programet mësimore që ofron. Në nivel institucional dhe bazuar edhe në kornizën ligjore në fuqi është krijuar NJSBC dhe Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është krijuar në 2013 me vendim të Senatit Akademik. Në takimin me përfaqësues të kësaj zyre u theksua fakti që tashmë çdo fakultet ka edhe njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>NJSBC është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe procedurave në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi përbëhet nga një anëtarësi prej 5 vetash ku dy janë përfaqësues të stafit akademik (nga të dy fakultetet), një përfaqësues nga Këshilli Studentor një ekspert i cili drejton njesine dhe një personel i administrates. Anëtarët e NJSBC zgjidhen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit dhe kanë një mandat 4 – vjeçar.</p> <p>NJSBC bashkërendon punën e saj me departamentet në drejtim të zbatimit të politikave dhe procedurave në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Veprimtaria e saj rregullohet përmes “Manualit të Sigurimit të Cilësisë” [11. <i>Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.</i>]</p> <p>Në nivel Institucional është krijuar edhe Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore. Ky komitet është një strukturë që në fokus të veprimtarisë së tij ka vlerësimin dhe procesin e përmirësimit në programet e studimit. Komiteti ka një anëtarësi prej 4-6 persona të zgjedhur nga Senati Akademik.</p> <p>Në fokus të veprimtarisë së tij ka vlerësimin e situatës së programave ekzistuese, analizimin e kushteve për hapjen e programeve të reja dhe propozimin e ndryshimeve. [7. <i>Libri i Rregulloreve Institucionale</i>]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te</p>	<p>DIS është përgjegjës për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”. Në bashkepunim me NJSBC, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë mësimore dhe të gjithë njësitë administrative bashkërendon punën për garantimin e</p>

<p>personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>cilësisë në programin mësimor. Bazuar edhe në detyrat dhe përgjegjësitë e shprehura në Rregulloren Institucionale, Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e Njësisë Bazë, përgjegjësi i departamentit ka kompetencat për të:</p>
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Monitoruar dhe ndjekur ecurinë e programit mësimor; 2. Bashkërendojë punën me stafin akademik dhe të sigurojë të gjithë kushtet në infrastrukturë për një proces mësimor në përputhje me standartet. Përgjegjësi i departamentit përmes mbledhjeve periodike përthith mendimin e stafit akademik në lidhje me nevojat e tyre për mjete didaktike, mjete ndihmëse në laboratorë, literaturë etj. Në bashkëpunim me hallkat përgjegjësi garanton përmbushjen e tyre; 3. Në fillim të vitit akademik përmes mbledhjeve me stafin akademik, planifikon ngarkesën në programin mësimor dhe ndjek në vijimësi performancën e stafit dhe veçanërisht të stafit të ri; 4. Në bashkëpunim me Koordinatorin e Programit ndjek edhe procesin e zhvillimit të praktikës profesionale dhe asistencës të ofruar tek studentët; 5. Në bashkëpunim me NJSBC ndërmerr masa në lidhje me përmirësimet që kërkohen bazuar në të dhënat e dala nga sondazhet me studentët; 6. Në fund të vitit akademik harton edhe raportin periodik vjetor ku një analizë bëhet në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike, bashkëpunimet e reja me kompanitë e biznesit, IAL dhe institucione shtetërore, të dhënat në lidhje me ecurinë dhe diplomimin e studentëve, progresi në kërkim shkencor dhe pjesëmarrje në thirrje për projekte, botimet shkencore të stafit akademik (bazuar në raportimet vjetore që vet stafi, përmes formularit të vetdeklarimit, ka dorëzuar në departament) dhe rekomandon hapat për përmirësim; <p><i>[6. Rregullore Institucionale e KU IKT; 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; 8. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë; 9. Rregullore e departamentit të Inxhinierisë Softuerike; 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS; 14. Manuali i Stafit Akademik (Staff Handbook)]</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se DIS i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik si dhe shkollat verore të organizuara nga universitete jashtë vendit <i>[Marrëveshjet në kuader të Erasmus+ 2016-2022; Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022].</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai</p>	<p>Departamenti i Shkencave Softuerike përmbush kriterin e përcaktuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë përmes anëtarësisë</p>



mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

së tij respektivisht 10 PAE, 1 PAK dhe 1 personel ndihmës akademik. Përsa i përket kualifikimit të PAE, 1 është me gradën Prof. Dr, 5 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor”, 1 është në proces të përgatitjes së doktoratës, ndërsa 3 janë me diplomën Master i Shkencave.

Tabela 12: Stafit PAE

Departamenti i Inxhinierisë Softuerike	1 Prof.Dr; 5 Dr. 1 Dr. ne process; 3 MSc;
--	--

[Ev. RVB – Të dhënat për vitin akademik 2021-2022]

Institucioni mbështet stafin akademik në lidhje me kualifikimin e vazhdueshëm. Në këtë drejtim, botimet në revistën periodike të institucionit dhe pjesëmarrja në konferencat që organizohen për stafin akademik janë pa pagesë. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike bazuar edhe vendimin e Bordit të Administrimit Nr. 1 datë 29.05.2020 ka përcaktuar në pikën 1 edhe kriteret për kategoritë e stafit akademik që përfitojnë reduktim të ngarkesës mësimore.

Në këtë vendim citojmë: “Përmes një kërkese të veçantë reduktohet ngarkesa mësimore për stafin akademik që ndjek studimet doktorale apo që merr pjesë në projekte shkencore” ndonëse nuk është specifikuar qartë masa e reduktimit për këtë kategori të stafit. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se ngarkesa mësimore e stafit në proces doktorature është 240 orë ku 210 orë kryhen për programin mësimor “Inxhinieri Softuerike” dhe 30 % zhvillohet në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni (program në ciklin e parë Bachelor) ngarkesë kjo e përshtatshme duke konsideruar që personeli me MSc ka një ngarkesë të miratuar 360 orë dhe kategoria Lektor me gradën Dr ka 300 orë.


[D8. Vendim i Senatit Akademik - miratimi i grupeve shkencore, pika 6 e tij; D4. Plani Kalendarik Vjetor 2021-2022; 85. RVB e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike (skanuar) – tabela përmbledhëse për ngarkesat];

Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.

Institucioni ka dëshmuar punën e tij në drejtim të trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm për stafin akademik. Përmendim:

- “Training on Google Meet” (trajnim për platformën Google Meet);
- Google Suite Training Session (trajnim mbi përdorimin e google në të gjithë proceset mësimore);
- Duke konsideruar ngjashmëritë me sistemin Evropian dhe sistemin e Amerikës së Veriut, për këtë të fundit është

	<p>organizuar edhe workshop “ Mbi Sistemin e Edukimit Amerikano – Verior”;</p> <p>Institucioni i kushton rëndësi edhe trajnimit të njërive të cilat janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Konkretisht këtë vit (2021-2022) janë bërë dy trajnime ku bashkë me stafin akademik kanë marrë pjesë edhe anëtarë të zyrës së NJSBC. Vlen të përmendet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trajnim në drejtim të teknikave të mësimdhënies dhe cilësisë së edukimit (2021); • Trajnim në drejtim të “Kurrikulës dhe Zhvillimit të Lëndës”. <p>[takim me stafin e NJSBC, takim me stafin akademik; https://cit.edu.al/]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Detyrat e stafit akademik janë të mirëpërcaktuara në Rregulloret e Institucionit. Staf i akademik është përgjegjës për kryerjen e një procesi mësimor sipas standarteve duke garantuar ruajtjen e përmbajtjes së programit të miratuar në department dhe të aprovuar nga instancat përkatëse të institucionit dhe MAS.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga takimi me stafin akademik GVJ konstaton një përgjegjshmëri, angazhim dhe motivim të tij në punë. • Kryerja e leksioneve në gjuhë të huaj nuk përbën një pengesë, madje një prej pjesëmarrësve u shpreh që i pëlqen kjo formë e mësimdhënies sepse termat teknike i gjen më të lehta të shprehë në gjuhën angleze [takim me stafin akademik]. • Staf i punon në drejtim të përmirësimit të literaturës dhe nuk harxhohet aspak kohë në drejtim të përkthimit të saj në gjuhën shqipe. • Në programin mësimor angazhohet edhe staf i huaj i cili sjell edhe një përvojë të re jo vetëm për studentët por edhe për anëtarët e tjerë të departamentit. • Prania e lektoreve të huaj në Leksione të Hapura i ka shërbyer stafit akademik dhe studentëve. • Marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të zhvillimit të praktikës profesionale kanë lidhur stafin akademik me kërkesat e biznesit e cila është reflektuar edhe në përmirësimet e përmbajtjes që ata kanë bërë në lëndet përkatëse të tyre. • Përmirësimet të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja i kanë shërbyer dhe mobilitetet e stafit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. <p>[57. Evidenca mbi konferenca; 24. Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+ 2016-2022; 26. Marrëveshjet me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022; 58. Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset;]</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik shembuj u sollën në lidhje me testimin e metodave të reja në mësimdhënie. Evidenca u sollën për</p>



<p>testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>situatën e Covid-19 kur mësimi u zhvillua online. Manual i mësimi online u përdor për format që duheshin përdorur gjatë procesit mësimor. Pyetësorë me studentët zhvilloheshin në mënyrë periodike çdo javë dhe raportimet përkatëse në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor hartoheshin nga ana e stafit akademik.</p> <p>Forma të reja janë përdorur sidomos për projektet që zhvillohen në grup. Nxitja e debatit, diskutimit, zhvillimi dhe analizimi i situatave kritike dhe inkurajimi për gjetjen e zgjidhjes janë disa forma që janë testuar dhe kanë dalë efikente. Tashmë në syllabuse pjesëmarrja ka peshën e saj dhe në vlerësimin përfundimtar zë 10% të tij.</p> <p><i>[takim me stafin akademik, takim me studentët; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022]</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregulloret në të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale lidhur me programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” janë në nivel institucioni, në nivel njësie bazë dhe në nivel programi studimi, respektivisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja Institucionale; - Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë; - Rregullore e Departamentit të Shkencave Softuerike; - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”; - Rregullore për Vlerësimin e Studentit; <p>GVJ u njoh me këto rregullore dhe është i mendimit se në të përcaktohen qartë elementët që lidhen me kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive [6. Rregullore Institucionale e KU IKT; 8. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë; 8. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë; 10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike].</p> <p>Format e vlerësimit që ndërmerren në këtë program studimi për vlerësimin e studentit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i pjesshëm; 2. Provimi final; 3. Riprovimi; 4. Përmirësimi;

	<p>Provimi përmban tre kategori të pyetjeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetje në lidhje me kontrollin e njohurive : 20-30% 2. Pyetje për testimin e aftësive analitike : 40-50% 3. Pyetje që kërkojnë analizë individuale në lidhje me raste studimore, ose ushtrime : 20-30% <p>Njohja e studentëve me rregulloren specifike të programit të studimit Bachelor në “Inxhinier Softuerike”, format e vlerësimit dhe përmbajtja e syllabusit bëhet që në fillimin e studimeve. Programi i studimit ka edhe koordinatoren e tij i cili është përgjegjës për dhënien e asistencës të studentët në lidhje me vështirësitë që mund të hasin gjatë procesit mësimor. Në programin studimor është futur edhe përgatitja e temës së diplomës. Në lidhje me formën e vlerësimit të tij institucioni ka përgatitur një Manual të veçantë [13. <i>Manual i Punimit të Tezes së Diplomes; 83. Model i përcaktimit të temës së diplomës</i>].</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit deri në njësinë bazë si dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit të studimit, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lëndë me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentët, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik konform rregulloreve në fuqi. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës [20. <i>Programet e lendeve 2019 – 2020; 20. Programet e lendeve 2020 – 2021; 20. Programet e lendeve 2021 - 2022</i>].</p> <p>Institucioni përdor edhe mekanizma të tjerë në drejtim të informimit të studentëve për programin mësimor. Përmendim këtu disa prej tyre që dolën në pah në RVB dhe në takimet e zhvilluara në institucion;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Publikimi i programit mësimor, lëndët, stafin akademik në faqen e uebit; • Guida e Studentit; • Java e Orientimit; <p>[https://cit.edu.al]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat për lëndë të ndryshme kanë elementë të përbashkët, por edhe specifika që lidhen me natyrën e lëndës dhe aktivitetet formuese përkatëse. Përgjithësisht, GVJ konstatoi se vlerësimi final përbëhet nga</p>

studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

komponentët si vijon më poshte përcaktuar në Rregulloren për vlerësimin e studentit:

- Pjesëmarrja 10%
- Detyrat e Kursit/ projekte kursi 40%
- Teste të ndërmjetme : 20%
- Provimi final: 30% [7. Libri i Rregulloreve Institucionale]

Format e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar edhe në syllabuse. GVJ shqyrtoi me vëmendje syllabuset e paraqitura nga ana e Departmentit të Inxhinierisë Softuerike dhe në shumicën e tyre këto forma variojnë në varësi edhe të trajtimit të lëndës dhe specifikave të saj.

Projekte	Lab	Detyrë shtëpie	Detyrë praktike	Tests
22	1	3	16	1

- Pesha në vlerësimin e projekteve: 30%
- Detyra praktikë: 10%
- Detyra shtëpie : 5-10%
- Teste: 10-20%
- Laborator : 5%

Përsa i përket diplomimit të gjithë studentët bëjnë mbrojtje teme diplome. Bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar për punimin e temës së diplomës 6 pedagogë (5 MSc dhe 1 Dr. në process) për një total prej 52 studentë [D10. Temat e diplomave, studentët dhe udhëheqësit 2020-2021]. Siç e kemi theksuar në raportin tonë në standartet më sipër, duke konsideruar tematikat e diplomave, stafin e angazhuar në to, mos përfshirja në ngarkesën mësimore e punës së stafit në lidhje me përgatitjen e studentit për temë diplome, fushat e kërkimit që janë pak të limituara në lidhje me trajtimin e temave studimore, janë disa faktorë që GVJ i konsideron si problematika që prekin cilësinë e kësaj disipline. Bazuar për sa më sipër, rekomandohet të vendoset kriteri i mesatares për studentët të cilët fitojnë të drejtën për temë diplome dhe ata që nuk plotësojnë këtë kriter të nënshtrohen edhe provimit përmbyllës. Institucioni duhet të reflektojë edhe këto ndryshime në rregulloret përkatëse.


[20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022; 85. RVB Bachelor në Inxhinieri Softuerike- tabela përmbledhëse].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Bazuar në syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se, për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” kontrolli dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë vitit dhe mbyllet me provimin përfundimtar, pesha e të cilit në vlerësimin e përgjithshëm është 30-40%. Elementët e tjerë që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të lëndës janë provimi i pjesshëm (me një peshë që varion nga 20% në 30%) dhe vlerësimi që lidhet me detyrimet e tjera të lëndës siç janë laboratorët, seminarët dhe detyra e kursit, projekte kursi, detyra shtëpie, detyra praktike (me një peshë që varion nga 5% deri në 30%). [20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022;].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në KU IKT aktualisht nuk është vënë në zbatim ndonjë sistem elektronik i testimit të vlerësimit. Elementë të testimit dhe vlerësimit nëpërmjet sistemeve elektronike ishin të pranishëm në situatën e pandemisë ku, nëpërmjet Google Classroom janë realizuar teste apo Quize të ndryshme.[Ev. Takime në institucion]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi përfundimtar për lëndët apo modulet realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë) gjë të cilën GVJ e gjen në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë ku theksohet citojmë: “... në çdo rast, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale duhet të realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit”. Për zhvillimin e praktikës profesionale në fund të tij studenti harton edhe një raport që vlerësohet 30% kundrejt 70% që zë mendimi dhe raporti i pedagogut bazuar edhe në mendimin e marrë nga punëdhënësi ku studenti ka kryer edhe praktikën. Kjo përcaktohet edhe në rregulloren e programit të studimit, manualin e praktikës [7. Libri i Rregulloreve Institucionale, 81. Manuali i Internshipit Bachelor FI shqip]. Përsa i përket trajtimit të mbrojtjes së temës së diplomës informacioni bazë është dhënë në Rregulloren e Programit të studimit ndonëse në këtë rregullore nuk është përcaktuar qartë anëtarësia e komisionit. [80. Manuali i Punimit të Tezes së Diplomes shqip; 10. Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike, neni 8].
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë	Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se testimi i njohurive, dijeve me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara

<p>anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Gjithashtu, sigurohet infrastruktura e nevojshme e monitoruar me personel [Ev. RVB; Takime në institucion; Rregullore e Sekretarisë 2021-2022].</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar Rregullores së Sekretarisë Mësimore, brenda dy javëve nga zhvillimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore. Procesi i këshillimit në lidhje me procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen është gjerësisht i pranishëm gjatë vlerësimit të komponentit që ka të bëjë me detyrat e kursit dhe projektet ku lektori përkatës shoqëron procesin me komente dhe rekomandime [Ev. Takime në institucion; Rregullore e Sekretarisë 2021-2022].</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Referuar RVB dhe takimeve me personelin akademik të programit, në shërbim të ruajtjes, edukimit, informimit dhe njoftimit të studentëve rreth emelenteve si mashtrimi, kopjimi, apo plagjiatura janë vënë rregullore si Kodi i Integritetit Akademik dhe Kodi i Etikës si dhe një numër elementësh janë pasqyruar në syllabuset e lëndëve dhe Guidën e Studentit. Në mënyrë të veçantë i kushtohet rëndësi procesit të verifikimit të plagjiaturës për temat e diplomave duke përdorur platformën Google Classroom (Check plagiarism). Përdorimi i kësaj platforme lehtësohet nga fakti që temat e diplomave përgatiten në gjuhën angleze. Në të ardhmen mendohet të kalohet në përdorimin e platformës Turnitin [Ev. Takime në institucion; Libri i Rregulloreve Institucionale; RVB]. • Nenet bazë në lidhje me plagjiaturën, kopjimin dhe penalitet shoqeruese me të janë dhënë qartë edhe në syllabuse ku një rubrikë e veçantë i kushtohet politika që institucioni ndjek në luftën kundër tyre [20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 – 2022;].
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga diskutimet me pedagogë dhe studentë të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”, GVJ konstatoi se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, i korrespondojnë një vlerësimi të shtrirë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës duke reflektuar gjithë komponentët e formimit. Gjithashtu, u konstatua se rezultatet jepen në kohë,</p>





	bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse [Ev. Takime në institucion]			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentëve, brenda 2 javëve nga zhvillimi i provimit studentët sipas një orari përcaktuar për tutoriat kanë të drejtën të takohen me pedagogun e lëndës për të diskutuar ose sqaruar çështje në lidhje me provimin e kryer. Pas takimit, pedagogu i lëndës bën edhe reflektimin e notës përfundimtare në proces verbal dhe në sistem. Bazuar në Rregulloren e Sekretarisë, studenti në rast mosmarrëveshje me pedagogun e lëndës në takimin e bërë ka të drejtën e ankimit e cila shprehet qartë në rregulloren e ankimit në Librin e Rregulloreve Institucionale të KU IKT. Ankimi i drejtohet Shefit të Departamenti të Inxhinierisë Softuerike në lidhje me pretendimet e tij dhe dorëzohet tek përgjegjësi i sekretarisë mësimore [12. rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022.]. Një komision ngrihet në lidhje me këtë deri në zgjidhjen e ankesës së ngritur përmes shumicës së votës nga anëtarët e komisionit. Në takimin me studentët nuk gjetën shembuj të ankimit të bërë nga ana e tyre [takim me studentët].			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga një komision i ngritur nga Përgjegjësi i Departamentit. Komisioni shikon gjithë procedurat e ndjekura për kërkesën apo ankimimin si dhe pretendimet e kërkuarit dhe del me propozime bazuar në votimin e bërë nga anëtarët e tij. Vendimi i marre nga komisioni është përfundimtar dhe mund të jetë në favor ose jo të pretendimit të studentit [12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022.]. Procedura e ndjekur dhe vendimi i tij i bëhen me dije studentit dhe rregullat në lidhje me protokollimin dhe arshivimin e saj ndiqen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" mundëson fitimin e njohurive dhe afësive profesionale dhe krijon mundësi punesimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohës të mirë të informacionit; • Specialist i shitjes së softuerëve; • Arkitekt softuerësh;



	<ul style="list-style-type: none"> • Testues i softuerit; • Menaxher i projektit softuerik; • Teknik informacioni; • Mirembajtës i sistemit të të dhënave; • Mirëmbajtës i faqes në internet; • Zhvillues e-commerce; • Zhvillues i sistemeve mbështetese; • Menaxher i bazës së të dhënave; <p>GVJ është i mendimit mënyra e zhvillimit të programit të studimit (me integrimin e detyrave e laboratorëve) krijon mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve në fushën e teknologjike kompjuterike. [10. Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë kompjuterike. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze siguron një përthithje më të mirë dhe të shpejtë të informacionit dhe literaturës e cila në fushën e inxhinierisë kompjuterike është më dominuese në gjuhën angleze, ndërsa hasen vështirësi të gjetjes së saj në gjuhën shqipe. Programi në gjuhën angleze lehtëson edhe mobilitetet e studentëve dhe adoptim të tyre në univeristet pritëse. Shembull pozitiv solli studentja e këtij programi që aktualisht ndodhej në Universitetin Graz të Austrisë në kuader të Erasmus+. Programi aktual përmban lëndën «Psikologji» e vlerësuar me 6 ECTS si lëndë me zgjedhje në kuadër të futjes së lëndëve me karakter human dhe social. <i>GVJ gjen në lidhje me këtë lëndë që ndonëse plotëson kërkesat e kuadrit ligjor nuk përshtatet në tërësi me përmbajtjen e programit dhe sugjeron për mundësinë e zëvendësimit të saj të zëvendësohet me një lëndë më adekuate.</i> [Ev. Plani mësimor i programit, RVB].</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë, nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies) si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Softuerike. Bazuar edhe në përgjegjësitë që ai ka të shprehur në Rregulloren e Departamentit dhe në rregulloren e programit të studimit, përgjegjësi i departamentit organizon takime/mbledhje me stafin akademik ku diskutohen çështje në lidhje me përmirësimet që duhet të bëhen në përmbajtjen e programit. Përmirësime në infrastrukturë, literaturë, organizimi i orarit mësimor dhe zbatimi i tij, frekuentimi i studentëve, asistenca ndaj çështjeve të ngritura nga studentët tek</p>



	<p>koordinatori i programit, organizimi i praktikës profesionale dhe ndjekja dhe monitorimi i saj, plan ngarkesa dhe realizimi faktik i saj nga stafi akademik etj. Në fund të vitit akademik hartohen edhe raportet vjetore të cilat pasqyrohen në raportin final të insitucionit ku një kopje e të cilit dorëzohet në MAS. Të gjithë hallkat informohen në lidhje me vlerësimet e bëra dhe rekomandimet e dhëna në raport. Në faqen e tij web, institucioni ka publikuar edhe raportet vjetore për çdo vit akademik si dhe vlerësimet e bëra nga studentët në lidhje me programet mësimore. Në takimin me stafin akademik shembuj u sollën në lidhje me marrjen e feedback nga studentët si një komponent i rëndësishëm në përmirësimin e punës së tyre [takimet në institucion].</p>																
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik, bazuar edhe në RVB, GVJ konstaton organizimin në javën e fundit të programit të lëndës të një përsëritje të koncepteve bazë dhe orientimin e studentëve në lidhje me përgatitjen për provimin final. Institucioni ka vënë në funksion edhe tutoriatin për të ndihmuar studentët në rast vështirësish. Koordinator i programit jep ndihmesën e tij në këtë drejtim. Stafi PAE përbën një përqindje të madhe në realizimin e programit të studimit, duke i dhënë një favorizim punës me studentët. Të qenurit gjatë gjithë kohës në institucion krijon mundësi për të dhënë ndihmë dhe konsultime në rast problematike të hasur nga studenti. [Ev. RVB; Takime në institucion]</p>																
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se, për cikle të caktuar leksionesh, ka patur edhe personel akademik të ftuar nga jashtë vendit (nga Kanada, Turqi, Greqi) si dhe ligjërata të mbajtura me të ftuar nga industria dhe institucione publike (Lufthansa, Telekom etj). Këto aktivitete kanë patur si qëllim, ndërmjet të tjerash edhe njohjen e studentëve me zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë. Gjithashtu, me pjesëmarrjen e studentëve, janë organizuar dhe tryeza e konferenca studentore, kompeticione të ndryshme, trajnime etj. [Ev. RVB, Takime në institucion].</p>																
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga studimi i planit mësimor GVJ vëren se ka një vëllim të konsiderueshëm seancash laboratorike. Orët laboratorike zënë 17.65% të ngarkesës në auditor të programit mësimor [Ev. Plani mësimor]. Infrastruktura dhe laboratorët krijojnë kushte për realizimin e procesit mësimor sipas standarteve dhe ndihmojnë në aftësimin dhe rritjen e kompetencave praktike të studentit.</p> <p>Tabela 13: Ngarkesa në orë sipas semestrave</p> <table border="1" data-bbox="560 1742 1305 1892"> <thead> <tr> <th></th> <th>Lab</th> <th>Projekt</th> <th>Intership</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Semestri I</td> <td>18</td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestri II</td> <td>36</td> <td>4</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestri I</td> <td>54</td> <td>6</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Lab	Projekt	Intership	Semestri I	18	2		Semestri II	36	4		Semestri I	54	6	
	Lab	Projekt	Intership														
Semestri I	18	2															
Semestri II	36	4															
Semestri I	54	6															



	Semestri II	72	8	
	Semestri I	90	10	
	Semestri II	54	6	
	Intership			120
	Total	324 orë	96 orë	120 orë
	%	17.65	1.97	6.53
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga takimi me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se aplikohen forma të punës në grup për realizimin e detyrave të kursit apo projekteve (p.sh. 4 studentë/grup) duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe elementë të tillë si diskutimet për problemin dhe menaxhimi i ndarjes së punës, interpretimi dhe zgjidhja e problemit, integrimi pjesëve individuale në një të tërë, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj. Grupet e projekteve përzgjidhen me short, duke kombinuar studentë me nivel të ndryshëm me qëllim përvehtësimin sa më të mirë të elementëve që i korrespondojnë problemit të trajtuar [Ev. Takime në institucion].			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	GVJ u informua se cikle të caktuar leksionesh me personel akademik të ftuar nga jashtë vendit (nga Kanada, Turqi, Greqi) si dhe ligjërata të mbajtura me të ftuar nga industria dhe institucione publike si dhe tryeza e konferenca studentore, kompeticione të ndryshme, trajnime etj, i kanë shërbyer krijimit të një klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetjes së studentëve [Ev. Takime në institucion; RVB].			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Ndër objektivat strategjikë të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Softuerike" mund të përmendim krijimin e mundësisë për studentët për të zhvilluar kërkimin e tyre shkencor me qëllim të promovimit të një kulture nxitëse bazuar në parimet e të menduarit kritik. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet krijimit të një baze financiare të qëndrueshme që mundëson infrastrukturë të përgjithshme për sistem edukimi, paisje dhe akomodim për mësim, materiale mësimore si dhe mjedis social. [Ev. Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se KU IKT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit [Ev. Marrëveshje bashkëpunimi]. Marrëveshjet me institucione homologe jashtë vendit i kanë shërbyer mobilitetit të studentëve. Gjithashtu, në një masë të madhe, i kanë shërbyer edhe mobilitetit të pedagogëve, të cilët nëpërmjet eksperiencës së përfituar dhe transmetimin e saj nëpërmjet formave të ndryshme të mësimdhënies, lehtësojnë mobilitetin e studentëve.			

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	GVJ konstatoi se procedura për mbrojtjen e diplomës është objekt i një rregulloreje të veçantë “Për Punimin e Diplomës” dhe Manuali i Punimit të Temës së Diplomës. Kjo rregullore si dhe elementët që lidhen me diplomimin, përgatitjen e punimit dhe mbrojtjen e saj u bëhet e njohur studentëve në fillim të semestrit të fundit të studimeve Bachelor. Një vëmendje institucioni i kushton plagjaturës. Studenti mund të informohen në lidhje me këtë në Guidën e Studentit dhe në website institucioni jep informacion për një publik të gjerë. [Ev. Takime në institucion, Manuali i Punimit të Tezes së Diplomës; Libri i Rregulloreve Institucionale; Ev. https://cit.edu.al/student]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Diplomimi për programin e studimit realizohet me temë diplome. Nga takimet në institucion, GVJ u informua se punimi i diplomës konsiston në përgatitjen e një teme të veçantë studimi ose kërkimi të mirëfilltë për nivel të ciklit të parë. Orientimi për zgjedhjen e temës dhe elementëve të saj jepet në fillim të semestrit të parë të vitit të tretë. Studentëve ju është vënë në dispozicion edhe Manuali i Punimit të Temës së Diplomës nga stafi akademik [Takime në institucion; Rregullore e programit Bachelor në Inxhinieri Softuerike].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Diplomimi për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” realizohet me temë diplome.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Diplomimi për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” realizohet me temë diplome. Rregullorja mbi “Punimin e Diplomës” përcakton se çdo anëtar i personelit akademik, brenda javës së tretë të semestrit të parë, ofron propozime konkrete për temat e tezës, të cilat ai/ajo është i gatshëm t’i mbikëqyrë, duke bërë kështu të mundur krijimin e një grupi me tema dhe në vijim studenti i interesuar plotëson formularin e aplikimit duke u konsultuar paraprakisht me një

	drejtues të mundshëm duke i hapur rrugë miratimit të temave para mbylljes së semestrit të parë [Ev. RVB; Libri i Rregulloreve Institucionale].
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analize, teste në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	RVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike në institucion për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, mund të ofrohen mundësi për të kryer matje apo teste edhe në biznese apo institucione që mbulojnë problematikën që lidhet me temën e diplomës ose ku studentët kryejnë edhe praktikat profesionale [takim me studentët, takim me stafin akademik].
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik angazhohet nëpërmjet ofrimit të konsultimeve për përgatitjen e temës së diplomës. Staf i akademik bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me studentin për elementë të tillë si përcaktimi i strukturës së punimit dhe objektivave, përgatitja e planit të punës me afatet përkatëse, përzgjedhja e literaturës, përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme laboratorike apo matjeve që duhen kryer, etj. [Takime në institucion].
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Në përfundim të mbrojtjes së diplomës studentin vlerësohet me notë, duke u bazuar në një sistem pikëzimi të anëtarëve të komisionit të mbrojtjes. Rezultati përfundimtar regjistrohet dhe bëhet publik në fund të çdo seance në prani të kandidatëve [Ev. RVB; Libri i Rregulloreve Institucionale].
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studentët e këtij programi studimi paisen me diplomën përkatëse që i korrespondojnë formës së regjistrimit të diplomës e realizuar Urdhër Nr.422, datë 09.12. 2020 të QSHA/MASR [17.Shkresa e QSHA, Urdhër nr. 422, datë 09.12.2020 miratimi i formës së diplomës + suplementi].
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentin i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar RVB, versioni zyrtar i programit të plotë të studimit u vihet në dispozicion studentëve të diplomuar në përfundim të studimeve të tyre [RVB; Takime në Sekretarinë Mësimore].
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Referuar DVV, rezultati i provimit ose mbrojtjes së diplomës ruhet në Sekretarinë Mësimore [Rregullore e programit të studimit]. Gjithashtu, në Sekretariatë mësimore mbahet regjistri bazë i studentëve me të dhënat e tyre personale si dhe vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit [Pjesë nga regjistri themeltar i studentëve]. Krahas versionit të shkruar (letër), për menaxhimin e përditshëm mbahet edhe versioni elektronik i informacionit. [Ev. RVB, Takim në Sekretarinë Mësimore].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nëk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nëk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni ka krijuar Zyrën e Burimeve Njerëzore si strukturë në varësi të Rektorit për të mbledhur, menaxhuar të dhënat e stafit akademik të angazhuar në programet mësimore. Zyra e Burimeve Njerëzore kryen veprimtarinë bazuar në Rregulloren e saj [7. <i>Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu VIII</i>]. Kjo zyrë është përgjegjëse për menaxhimin e dosjeve të stafit akademik, ndihmës dhe administrativ të punëuar në KU IKT. Zyra e Burimeve Njerëzore përpos menaxhimit të të dhënave të stafit administrativ mban kontakte të vazhdueshme me palët e treta si Inspektoriati i Punës, Instituti i Shëndetit Publik, MAS, zyrat e punës në Tiranë etj [takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore]</p> <p>Njësia bazë mban të dhëna në lidhje me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në programin e studimit. Kjo njësi bën parashikimin e ngarkesës mësimore të secilit personel akademik, monitoron dhe raporton ngarkesën reale të realizuar në fund të vitit akademik. Njësia bazë është përgjegjëse edhe për administrimin e programeve lëndore (syllabuset) të secilit pedagog, leksionet, dispensat apo tekstet e miratuara, testet dhe fondet e pyetjeve për çdo lëndë/modul dhe dokumente të tjera të formimit akademik/ profesional (publikime, referime, pjesëmarrje në konferenca etj.) të cilat më pas përpunohen në fund të çdo viti akademik dhe reflektohen në raportin vjetor [takim me shefin e Departamenti të inxhinierisë softuerike, takim me stafin akademik].</p> <p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave në lidhje me procesin mësimor: procesverbale, dosjen e studentit në regjistrimin e tij deri në përfundim të studimeve,</p>

	<p>mbajtja dhe menaxhimi i sistemit të notave fizikisht në regjistra të veçantë dhe në formë elektronike [vizitë në sekretarinë mësimore]. GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga institucioni dhe takimeve të zhvilluara në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në Sekretarinë mësimore konstatoi një korrektësi të zbatimit të procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik të angazhuar në këtë program studimi, si edhe në përputhje me VKM nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, Rregullores së Institucionit dhe Rregullores së Programit të Studimit [7. Libri i Rregulloreve Institucionale; 10. Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në KU IKT bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve ligjore dhe nënjore të shprehur në Statut Rregulloren Institucionale të KU IKT [1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar; 6. Rregullore Institucionale e KU IKT]. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë rekrutimit të stafit akadmeik. Në lidhje me procesin e punësimit është hartuar një mini-rregullore në Librin e Rregulloreve Institucionale për “Politikat dhe procedurat e Rekrutimit të Stafit Akdemik”. Angazhimi i stafit të kualifikuar është një objektiv i institucionit. Plotësimi i këtij objekti reflektohet edhe në raportin vjetor në nivel institucional. Për vitin 2021 -2022 në raportin vjetor institucional është theksuar në rubrikë të veçantë puna e mirë për angazhimin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë ku është synuar përthithja e një stafi me grada dhe tituj shkencorë, me ekspertizë të dalluar në fushën e inxhinierisë kompjuterike [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS].</p> <p>Në takimin e zhvilluar në zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton si vëmendje të punësimit kriterin e përgjeshjes së një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë. Kërkesa për punësim buron nga njësia bazë dhe publikohet njoftimi edhe në website të institucionit. Vlerësimi i kandidatave bëhet përmes sistemit të pikëzimit. Në përzgjedhje një vëmendje i kushtohet arsimimit/kualifikimit, kërkimit shkencor dhe eksperiencës profesionale. Institucioni ka punësuar edhe staf të huaj për të cilin Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për administrimin e të dhënave si: Njohje e gradës shkencore e cila është procedurë aprovimi nga MAS, nxjerrjen e lejes së qëndrimit dhe të punës për stafin e huaj [vizitë në zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]. Në</p>

	<p>takimin me stafin akademik, GVJ konstaton rekrutimin e dy pedagogëve me graden MSc të diplomuar në këtë institucion, një indikator i vazhdimësisë dhe përthithjes së studentëve ekselentë në stafin akademik [takim me stafin akademik]. Procedura të njëjta ndiqen edhe në lidhje me stafin PAK. Për pedagogët me kohë të pjesshme, kjo zyrë ndjek të njëjtën procedurë dhe kandidati fitues në dosjen e tij/saj ka edhe lejen nga institucioni ku aktualisht është i angazhuar [vizitë në zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>KU IKT ndjek procedura të qarta rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të stafit akademik të ftuar si edhe stafit ndihmës-akademik. Këto procedura GVJ i gjen të shprehur në rregulloren Politikat dhe procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik” [7. Libri i Rregulloreve Institucionale]. Kriteret publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike www.app.gov.al, në zyrat e punës dhe në faqen web të IKT-së dhe sigurohet që procedura të jetë transparente. Vlerësimi bëhet përmes sistemit të pikëzimit. Preferohen si kritere të veçanta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përvojë në mësimdhënie; • Grada shkencore. Preferohet kandidatë me gradën Dr. por insitucioni ka investuar edhe në gradën MSc duke i dhënë prioritet studentëve ekselencë që kanë studiuar në KU IKT; • Cilësia e universitetit ku kandidati ka mbaruar studimet; • Aftësitë në mësimdhënie dhe eksperiencia personale; <p>[takim me shefin e departamenti të inxhinierisë softuerike, takim me burimet njerëzore, takim me stafin akademik]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të cilat konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Preselektim i kandidaturave, i cili bëhet në konsultim me Departamentin, duke ju referuar kritereve të publikuara; - Kandidatët e preselektuar kalojnë një intervistë (përpara një komisioni prej 6 anëtarësh) si dhe u kërkohet të mbajnë një leksion të hapur; - Për renditjen e kandidatëve përdoret një sistem pikëzimi që merr në konsideratë edhe elementë specifikë si aftësitë komunikuese, zotërimi i gjuhës angleze, aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me profilin e ngarkesës mësimore, përvoja e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm; - Kandidatët jo-fitues njoftohen individualisht bashkë me një arësyetim për moskualifikimin e tyre për pozicionin e shpallur;

	<p>- Kandidatët fitues paraqiten në Zyrën e Burimeve Njerëzore për të plotësuar dokumentacionin që do të jetë pjesë e dosjes së tyre.</p> <p>IKT synon me prioritet të rekrutojë lektorë të huaj, por proceduara edhe në këtë rast mbetet e njejtë.</p> <p>[Ev. Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore; https://cit.edu.al/faculty-of-engineering-vacancies/].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Procesi mësimor zhvillohet në Kampusin e Ri, brenda Tiranës, në kompleksin “Xhura”, rruga Xhanfize Keko, Nr.12. Nga vizita e realizuar në institucion, GVJ konstatoi se procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Fakulteti i Inxhinierisë e zhvillon aktivitetin e tij në ambiente me sipërfaqe totale prej rreth 2100m², ndërsa në shërbim të programit të studimit (por edhe të programeve të tjera) janë rreth 1174m².</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim cilësor të këtij procesi, që përfshin: ngrohje-ftohjen, ndriçimin, tabelat, projektorë dhe çdo gjë tjetër të domosdoshme për këtë qëllim. Një kontribut i rëndësishëm ofrohet nëpërmjet bazës laboratorike, e cila, në drejtim të paisjeve kompjuterike të nevojshme për zhvillimin e seancave laboratorike, është e viteve të fundit dhe e paisur me softet e nevojshme [Vizita e ambienteve; RVB].</p> <p>Instalimi, mirembajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i njësisë së IT. Në shërbim të programit janë 3 klasa me një sipërfaqje totale 163 m² për zhvillimin e orëve teorike, ushtrime dhe seminare. Në funksion të programit mësimor janë edhe 2 laboratorë me sipërfaqje 180 m² si edhe nje auditor i madh me sipërfaqje 200 m² (që shërben si sallë konferencash) me kapacitet 180 persona. Në ndërtesë është instaluar sistemi HVAC duke krijuar një konfort termik për zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me standartet e kërkuara. Ndriçimi është sipas standartit. Klasat janë të ndriçuara drejt dhe të pajisura me tabela, projektore, kompjutera për laboratorët dhe mjete tjera didaktike</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>ndihmëse në shërbim të procesit mësimor. Një ndihmës asistent është i pranishëm në laboratorë për të dhënë asistencën dhe mirëmbajtjen e tyre. Laboratorët mund të aksesohen në çdo moment gjatë gjithë javës (e Hënë – e Shtunë) nga ora 9.00 deri në orën 21.00 [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit në masën 95.2% mbulohet nga staf PAE dhe 4.8% staf akademik PAK, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në kornizën ligjore në fuqi. Evidencat e paraqitura nga institucioni dhe takimet e zhvilluara, dëshmojnë për punën e vazhdueshme në drejtim të konferencave dhe aktiviteteve në drejtim të kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik.</p> <p>Institucioni punon në rritjen e mobilitetit të stafit akademik në kuadër të projekteve CEEPUS, Erasmus+. Theksojmë që dy vitet e pandemisë kanë kushtëzuar lëvizjen e personelit akademik dhe studentëve. Për vitin 2021 – 2022, kanë pasur mundësi të lëvizin 2 personel akademik dhe 1 student në kuadër të programit CEEPUS. Institucioni inkurajon stafin e ri në punën e tyre për rritjen e gradave shkencore. Edhe në kriteret më lart kemi sjellë shembuj të lehtësimit të ngarkesës mësimore të stafit akademik që është në proces doktorature, krijimin e mundësive për publikime dhe pjesëmarrje në konferencat që institucioni organizon të cilat për stafin PAE janë pa pagesë. Zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim edhe me Departamentin e Inxhinierisë Softuerike bashkëpunon për monitorimin e punës së stafit akademik. Nga takimi i zhvilluar me këtë njësi, GVJ u njoh me punën që bëhet në lidhje me kërkesat e stafit akademik për arritje akademike. Bazuar në kërkesat e stafit dhe në rezultatet e studentëve nga anketimet periodike që kryhen, institucioni ndërmerr edhe masa për përmirësim e cila reflektohet edhe në raportin vjetor që institucioni përgatit dhe dorëzon në MAS [takim me përfaqësues të Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se DIS i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka mbështetur kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik si dhe eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik, shkollat verore të organizuara nga universitete jashtë vendit si dhe trajnimet apo ëorkshop të realizuara nga institucioni. [Marreveshjet në kuadër të Erasmus+ 2016-2022; Marreveshjet me universitetet 2016 – 2022; RVB].</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Takimet e zhvilluara, dokumentacioni i paraqitur janë tregues të një shfrytëzimi me efikasitet të kapacitetit njerëzor, të stafit akademik dhe të stafit ndihmës mësimor. Për vitin akademik 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 ngarkesa mësimore për programin e studimit është mbuluar nga personeli akademik si vijon:</p> <p>Tabela 14: Ngarkesa mësimore e stafit PAE dhe PAK</p>			
	PAE			
	Kategoria	Profesor	Lektor	Asistent lektor
	Viti akademik	Prof / Prof.As	Dr / Dr proces	Msc
	2019-2020	2 / 2	10 / 2	6
	2020-2021	2 / 2	7 / 2	6
	2021-2022	2 / 4	7 / 2	5
	PAK			
	Kategoria	Profesor	Lektor	Asistent lektor
	Viti akademik	Prof / Prof.As	Dr	Msc
2019-2020	-	1	1	
2020-2021	-	-	-	
2021-2022	-	1	-	
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Kolegji Universitar “IKT” dëshmon se bazuar në numrin e studentëve për këtë program studimi zotëron kapacitet njerëzor dhe infrastrukturor të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.</p> <p>GVJ bazuar në RVB (Tabelat përmbledhese) dhe vizitën në institucion konstaton si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sipërfaqja e marrë me qera në bazë të çertifikatës së pronësisë është 2385m² me sipërfaqje parkimi 300m²; Institucioni ka 5 klasa mësimore me kapacitete 20-30 studentë me sipërfaqje 260m²; Auditore për 200 studentë e cila shëben edhe si sallë konference; Mjedise për stafin akademik (4 zyra me sipërfaqje 125 m²);

	<p>e. Mjedise për stafin akademik me kapacitet për çdo zyrë 2 deri 4 veta;</p> <p>f. Sallë mbledhjesh për stafin akademik me sipërfaqje 50m²;</p> <p>g. Mjedise për administratën, sekretarinë mësimore me një total sipërfaqje 204m²;</p> <p>h. Bibliotekë me sipërfaqje 90m²;</p> <p>Raporti është 5m²/student. Bazuar ne piken iv (d) ,(dh), (e) te vendimit nr.418 date 10.05.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre” GVJ konstaton se institucioni plotëson standartet për vendosje të pikës së ndihmës së shpejtë, sistemin e tokëzimit, sistemin HVAC, burimin alternative të energjise elektrike (gjenerator dhe UPS);</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstatoi që klasat, laboratorët ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” janë të pajisura në përputhje me standardet që e kërkon një zhvillim i drejtë dhe bashkëkohor i procesit të mësimdhënies. Procesi mësimor zhvillohet në salla leksioni dhe seminari duke përballuar në mënyrë të mjaftueshme kapacitetin studentëve të këtij program studimi. Në funksion të programit të studimit janë vënë 4 laboratorë secili i pajisur me 40-45 terminale, një server, dhe një videoprojektor për zhvillimin e mësimin. Laboratorët kanë akses në internet dhe janë të pajisur me të gjithë software-t e duhur për të mundësuar asimilimin e kuadrit teorik në praktikë. Laboratorët mund të aksesohen në çdo moment gjatë gjithë javës (e hënë – shtunë) nga ora 9:00 deri në 21:00. <i>[vizite ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” përdoren 2 laboratorë të vendosur në katin e parë <i>[Ev. Infrastruktura e godines]</i>. Këto laboratorë janë të pajisur me të gjithë softuer-ët e nevojshëm. Laboratorët shfrytëzohen edhe për programe të tjerë studimi, por është mirëllogaritur fasha e orareve të programeve të studimit duke mundësuar që studentët në këtë program të zhvillojnë veçmas studimin pa u bashkuar në orët laboratorike me studentë të programeve të tjera të studimit. Laboratorët në oraret që janë të lira janë disponibël për studentët të cilët shprehin interesin të zhvillojnë orë shtesë laboratorike <i>[Ev.Takim me studentët, Ev. Takim me stafin akademik, vizite ne institucion]</i>.</p> <p>Për mbarëvajtjen e orëve laboratorike është vënë në dispozicion një laborant nga stafi akademik, ndërsa personeli nga Sektori IT është në dispozicion për mirëmbajtjen e tyre <i>[RVB, vizite në institucion]</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike zotëron 2 laboratorë të informatikës të pajisur me softet e duhura për zhvillimin e lëndëve. Laboratorët janë të pajisur me të gjithë mjete didaktike për zhvillimin e procesit mësimor <i>[Vizitë në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” zhvillohet praktikë profesionale e vlerësuar me 6 ECTS në semestrin e II të vitit të III. Kryerja e praktikës profesionale mundëson zhvillimin e aftësive praktike të studentit, rritjen e aftësisë për tu përballuar me situata konkrete të cilat kërkojnë analizë dhe zgjidhje. Studentët përfitojnë të shfrytëzojnë edhe infrastrukturën në kompanitë pritëse për të zhvilluar edhe temën e diplomës. Mobiliteti i studentëve konsiderohet si një mundësi për të përfituar njohuri më të thelluara në teori dhe praktikë dhe përballjen me trajtimin e temave në universitetet pritëse. Në takimin me studentët, studentja online nga Universiteti Gratz Austri solli shembull pozitiv mbi mundësinë e shfrytëzimit të laboratorëve në këtë universitet <i>[takim me studentët]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sektori i Bibliokës Shkencore është njësi ndihmëse e Universitetit, strukturë ndihmës – akademike me karakter administrativ dhe në nivel institucioni ndodhet në varësi të Rektorit. Sipërfaqja e bibliotekës është 90m², me 20 vende dhe 6 PC. Konsiderojmë që ky numer është pak i vogël për të përballuar numrin e studentëve bazuar në të dhënat ku numri total i studentëve në Fakultetin e Inxhinierisë është 429 (viti I, Viti II, viti III) kundrejt 204 studentë që janë në programin Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” <i>[27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS ku janë marrë të dhënat e numrit të studentëve për vitin 2020-2021; vizitë në bibliotekë].</i> <u>GVJ rekomandon</u> zgjerimin e hapësirës së bibliotekës duke rritur numrin e PC që duhet për studentët në mjediset e saj. Biblioteka kryen funksionin e saj bazuar në rregulloren e aprovuar nga Senati</p>



	Akademik [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS].
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka zotëron 3000 tituj nga të cilët 2780 janë në gjuhën angleze. Biblioteka zotëron një database ku përditëson titujt. Institucioni që në vitin 2016 ka nënshkruar marrëveshje me McGrawHill Education dhe ka edhe marrëveshje me O'Reilly duke dhënë mundësinë e të paturit edhe të bibliotekës virtuale. Biblioteka zotëron një fond të pasur në fushën e inxhinierisë kompjuterike. Në raftë GVJ evidentoi një diapazon të gjerë titujsh të librave në fushën inxhinierike, të botimeve të viteve të fundit dhe me një numër kopjesh të mjaftueshme për studentët. [vizitë në bibliotekë].
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Punonjës të bibliotekës në vizitën e kryer në mbjentet e saj theksuan ofrimin e shërbimit pa pagesë për studentët, stafin akademik, dhe për të gjithë të interesuarit nga zonat përreth që duan të shfrytëzojnë ambientet e saj. Përveç shfrytëzimit të librave, biblioteka virtuale ofron akses në rreth 300 tituj të botimeve të viteve të fundit [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS; vizitë në bibliotekë]. Institucioni ka organizuar edhe seminare me studentët në lidhje me përdorimin e bibliotekës virtuale. Këto janë organizuar nga përfaqësues të McGraw Hill [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS].
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e paisur me 6 PC të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar aksesimin në bibliotekat virtuale të cilat institucioni ka abonime [Vizita në bibliotekë]. Studentët dhe stafi kanë akses në internet në Bibliotekën Kërkimore (database i bibliotekës) përmes faqes së internetit të Bibliotekës së KU IKT-së. Në website, sesioni dedikuar bibliotekës (https://cit.edu.al/library-2/) jep të dhëna dhe ndihmon studentët me libraritë që ofrojnë falas tekste mësimore.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni i kushton vëmendje pasurimit të fondit të bibliotekës. Një mënyrë e pasurimit të fondit të librave është përmes donacionit. Siç shprehet institucioni në raportin e tij vjetor 2020-2021 citojmë «..një nga qëllimet kryesore të bibliotekës është të ketë literaturën e duhur në kohën e duhur për studentët dhe stafin». Për këtë në fund të vitit akademik biblioteka dërgon një formular dixhital «Formular për akses librash» për të gjithë personelin akademik, dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve duke i lejuar stafit akademik një afat 2 mujor për të dhënë informacion dhe kërkesë në lidhje me titujt që mendojnë të

	përdorin në procesin mësimor dhe që duhet të jenë në gjendje në bibliotekë për vitin e ardhshëm. <i>[Vizita në bibliotekë]</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, nga e E Hënë –E Premte, ora 09:00 – 13:00 dhe 14:00 – 18:00 dhe të Shtunën 08:00-15:00. GVJ konsideron këtë fashë orare si të mjaftueshme për studentet e ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” duke konsideruar që procesi mesimor zhvillohet paradite. <i>[Vizita në bibliotekë]</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet në plotësi	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	KU IKT ka ngritur Sekretarinë Mësimore e cila funksionon mbi bazën e një rregullore të aprovuar <i>[Libri i Rregulloreve Institucionale: Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022]</i> . Kjo njësi është përgjegjëse për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit në lidhje me studentët që në momentin e regjistrimit të tyre deri në përfundim të studimeve. Dokumentacioni mbahet në përputhje me rregulloren dhe kërkesat ligjore të përcaktuara nga MAS. GVJ në vizitën e bërë në këtë njësi konstaton mbajtjen e dokumentacionit sipas standarteve të kërkuara. Regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike, regjistri i kursit dhe i diplomave mbahet në mënyrë korrekte. Kjo zyrë menaxhon dosjet e çdo studenti dhe kryen në mënyrë korrekte procedurat e transferimit të studentëve në programet mësimore. Të dhënat mbahen në formë elektronike dhe në hard copy. Institucioni ka zhvilluar edhe sistemin UMS (University Management System) i cili është një platformë elektronike ku studentët dhe stafi akademik kanë mundësi aksesit për hedhje informacioni si nota, vlerësime nga ana e stafit akademik dhe njëkohësisht studentët kanë mundësi të marrin informacion të nevojshëm për datat e provimeve, rezultatet e tyre etj. Çdokush ka një username dhe një fjalëkalim në këtë sistem i cili menaxhohet nga zyra e IT në KU IKT <i>[RVB; Vizita në institucion; https://ums.cit.edu.al/]</i> .

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i informacionit i IKT (UMS) synon të kontribojnë në menaxhimin e institucionit. Ky sistem është në përmirësim të vazhdueshëm dhe GVJ është i mendimit se akoma nuk e ka arritur fazën e një sistemi informacioni tërësor për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit <i>[vizitë në sekretarinë mësimore]</i>. Siç shprehet edhe vete institucioni në RVB <i>“planifikohet që në muajt në vazhdim të punohet për shtimin dhe përdorimin e një moduli për menaxhimin e veprimeve financiare të studentëve”</i>, është një tregues që ky sistem është në përmirësim.</p>			
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi UMS ofron një shërbim për studentët dhe stafin akademik. Përmes tij gjenerohen të dhëna në lidhje me numrin e studentëve, frekuentimin, rezultatet e provimeve etj. Informacioni është i dedikuar dhe personal dhe aksesit është i kufizuar për secilin përdorues sipas kategorive përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierise përdor një sistem të menaxhimit të informacionit UMS ku hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhënat në lidhje me vlerësimin e studentëve. Sistemi UMS ofron mundësi të kufizuara komunikimi interkativ ndërmjet personelit dhe studentëve. Institucioni përdor edhe platformën Google Classroom e cila ka qenë shumë efektive për mësimdhënien gjatë situatës së covid-19 dhe Google Meet për komunikimin online student –pedagog. <i>[takim me studentët; takim me stafin akademik]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi UMS garanton një përgjigje në kohë reale të aktivitetit akademik. Sistemi mundëson përpunime statistikore në lidhje me studentin, progresin e tij, detyrimet që ai mbart. Sistemi UMS mundëson edhe një përpunim statistikor të të dhenave. <i>[Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit]</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacioni bazë dhe ndihmës për universitetin, programet mësimore që ofrohen, broshurat, raportet vjetore që dërgohen në MAS, oraret mësimore, rezultatet e pyetsoreve të studentëve, kuadri ligjor dhe rregulloret bazë, projektet kërkimore shkencore, bursat, njoftimet dhe aktivitetet sociale janë të reflektuar në faqen web [https://ums.cit.edu.al/] e cila faqe pasqyron informacionin vetëm në gjuhën angleze.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>KU ICT është një institucion jo publik dhe vepron si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k). Baza e financimit buron nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> Tarifat e studimit që gjenerohen nga regjistrimi i studentëve; Financimi nga partnerët; Donacionet nga organizata të ndryshme; <p>Bazur edhe në Statut, KU IKT ka një Bord Administrimi i cili vepron mbi bazën e një rregullore të aprovuar [7. Libri i Rregulloreve Institucionale.; 6. Rregullore Institucionale e KU IKT].</p> <p>Institucioni i nënshtrohet kornizës ligjore në fuqi dhe rregullave dhe standarteve të MAS dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Çdo vit harton një plan buxhet financiar [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS]. Raporti financiar hartohet nga çdo fakultet në mënyrë të pavarur. Të dhënat financiare menaxhohen në zyrën e financës dhe i bashkangjiten raportit vjetor të institucionit që dorëzohet edhe në MAS.</p>											
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë</p>	<p>Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjial administrativ i KU IKT-së i cili garanton mbarëvajtje financiare dhe administrative të tij. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregullore të IKT-së. [1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar; 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar; 7. Libri i Rregulloreve Institucionale, kapitulli II]. Në çdo fakultet vepron edhe Administratori detyrat e të cilit janë përshkruar qartë në Statut dhe në Librin e Rregulloreve Institucionale. Duke ju referuar të dhënave financiare të institucionit të shprehura në përqindje në tabelën e mëposhtme, GVJ konstatoi se institucioni ka qëndrueshmëri financiare, duke qenë se shpenzimet, për tre vitet e fundit, variojnë nga 87 deri në 93% të të ardhurave.</p> <p>Tabela 15: Plani i financimit të Institucionit</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Të ardhurat</th> <th>2021-2022</th> <th>2020-2021</th> <th>2019-2020</th> </tr> <tr> <th>%</th> <th>%</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Tarifat për dhe gjatë shkollimit</td> <td>98.3</td> <td>95.8</td> <td>93.7</td> </tr> </tbody> </table>	Të ardhurat	2021-2022	2020-2021	2019-2020	%	%	%	Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.3	95.8	93.7
Të ardhurat	2021-2022		2020-2021	2019-2020								
	%	%	%									
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.3	95.8	93.7									

sipas natyrës specifike të tij.	Shërbimet trajnuese	1.6	4.1	6.2
	Donacionet	0.1	0.1	0.1
	Shuma	100	100	100
	Shpenzimet	%	%	%
	Pagat dhe kontributet e sigurimeve	65.3	66.5	61.5
	Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes	22.0	22.8	24.9
	Shpenzime të tjera	0.8	0.8	0.7
	Investime	2.1	2.2	0.2
	Kërkimi shkencor	0.5	0.5	0.0
	Konferenca	0.1	0.1	0.1
	Shuma	91	93	87

Tabela 16: Plani financiar i Departamentit të Inxhinierisë Softuerike kundrejt Fakultetit të Inxhinierisë

Të ardhurat	2021-2022	2020-2021	2019-2020
	%	%	%
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	92	94	97
Shërbimet trajnuese	-	-	-
Donacionet	-	-	97
Shuma	89.9	88.7	97
Shpenzimet	%	%	%
Pagat dhe kontributet e sigurimeve	69	84	26
Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes	69	84	90
Shpenzime të tjera	69	84	90

Investime	69	84	90
Kërkimi shkencor	69	84	0.0
Konferenca	69	84	90
Shuma	69	84	49.7

GVJ konstaton si vijon me poshte:

- a. Për vitin 2021-2022 të ardhurat nga tarifa e regjistrimit të studentëve ka pësuar një rënie kundrejt vitit 2020-2021. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka peshën më të madhe të të ardhurave nga studentët;
- b. Ndërsa kërkimi shkencor nuk ka qenë financuar në vitin 2019-2020, konstatohet që tashmë bën pjesë në zërat e financuara. Megjithatë, duke qenë se masa e financimit **kërkim shkencor plus konferenca**, i marrë sëbashku, është relativisht i ulët, **GVJ rekomandon rritjen e peshës së këtyre zërave në vitet në vijim për Departamentin e Inxhinierise Softuerike;**
- c. Në të njëjtin konkluzion vijoje edhe për Fakultetin e Inxhinierisë, i cili ka peshën më të madhe si në gjenerimin e të ardhurave ashtu edhe shpenzimet në nivel institucioni

[Ev. Fakulteti i Inxhinierise - Plani i Financimit të Programit të studimit sipas Departamentit].

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.

KU IKT i nënshtrohet një sistem auditimi të brendshëm dhe të jashtëm. Auditimi i brendshëm kryhet nga Sektori i Auditit që ndodhet në varësi të Bordit të Administrimit. Duke konsideruar si strukturë publike ajo i nënshtrohet edhe auditimit nga MASR dhe Institucioneve të tjera shtetërore.
[46. Raport i Auditit të Jashtëm për institucionin - i pavarur.]

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe

Në mbyllje të çdo cikli studimi KU IKT dokumenton edhe raportet financiare të tre viteve të fundit dhe bën planifikimet për ndërhyrje të posaçme bazuar edhe në strategjinë e tij për zhvillim.

diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	KU IKT dhe vetë programi i studimit paraqet qëndrueshmeri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij program studimi Të dhëna të qarta gjetëm në lidhje me planin e financimit të Departamentit të Inxhinierise Softuerike i cili ka peshën më të madhe të të ardhurave nga tarifat e studentëve në Fakultetin e Inxhinierisë. [Ev. RVB; Fakulteti i Inxhinierise - Plani i Financimit të Programit të studimit sipas Departamentit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Inxhinieri Softuerike” është ndërtuar referuar kornizës së nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, e organizuar në 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale në tre vite akademike. KU IKT ka institucionalizuar të gjithë procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve në kete program studimi. GVJ i gjen të shprehur qartë në dokumenta baze në nivel institucional deri në nivel programi si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statut i KU IKT-së; 2. Rregullore Institucionale; 3. Libri i Rregulloreve Institucionale; 4. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë; 5. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike; 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”; <p>Këto procedura përshkruajnë procesin e regjistrimit të studentëve, të zhvillimit të procesit mësimor, të transferimit, procedurën e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>KU IKT bazohet në parimin e ofrimit të programeve mësimore me cilësi ku gjithsecili ka të drejta të barabarta. Procedurat e ndjekura nga Institucioni garantojnë barazinë tek çdo student në këtë program studimi. Statuti dhe rregulloret institucionale garantojnë mundësi të barabarta për kushtet materiale dhe financim të mësimdhënies si edhe kërkimit shkencor. Procedurat e ndjekura janë në akordancë edhe me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore në fuqi të kërkuara edhe nga MASR. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Inxhinierise Softuerike dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e Arsimit të Lartë, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetregulluese të institucionit [<i>RVB; Rregullore të institucionit; Takime në institucion</i>].</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar qartë procedurat në lidhje me pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve. Këto procedura janë të aprovuara nga Senati Akademik dhe zbatohen në mënyrë rigoroze nga njësitë bazë dhe administrative. Kriteret në lidhje me pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë reflektuar edhe për publikun përmes faqes web në një rubrikë të veçantë</p>



<p>mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>“Pranimet” [https://cit.edu.al/admissions-3/]. Kriteret e përgjithshme janë për të gjithë programet e studimit ndërsa kriteret e veçanta diferencojnë për programet inxhinierike kundrejt programeve në fushen e ekonomisë [https://cit.edu.al/admissions-3/]. Për informimin e publikut shërben edhe guida e studentit, eksplorimi në website me informacion në lidhje me Fakultetin e Inxhinierisë [https://cit.edu.al/admissions-3/]. informacion në lidhje me programin e studimit Bachelor në ciklin e parë të studimeve “Inxhinieri Softuerike” në një sesion të dedikuar jep të dhëna në lidhje me: kohëzgjatjen e programit të studimit, strukturën e tij, pagesën, synimet në aftësimin e studentit, kërkesat për pranim dhe regjistrim dhe përshkrim i shkurtër i lëndëve të programit [https://cit.edu.al/bachelor-in-softëare-engineering-2/]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve janë zbatuar në mënyrë korrekte nga institucioni për këtë program studimi. Vendosja e kuotave të pranimit të studentëve përcaktohet nga Institucioni dhe propozohet në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë e cila bazuar edhe në kapacitetet e institucionit bën edhe miratimin e tyre [34. Raporti i Grupit të Punës për Verifikimin e Standardeve dhe Normativave të Infrastrukturës nga MASR 28.07.2020].</p> <p>Kandidatet për studentë aplikojnë në portalin universitar U-Albania në periudhën e përcaktuar nga MASR. Pranimet e studentëve bëhen mbi bazën e plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të bëra të njohur publikut dhe në website. Si kriter i përgjithshëm është zotërimi i diplomës së shkollës së mesme me mesatare mbi 6.5 e cila zë një peshë 70% të vlerësimit ndërsa 30 % zënë vlerësimet në lëndët: Matematikë, Fizikë dhe Informatikë.</p> <p>GVJ në takimet e zhvilluara u fokusua edhe në kriterin e gjuhës së huaj duke konsideruar që programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze. Kandidatët për studentë duhet të kenë njohje të mirë të gjuhës angleze. Pranohet i përmbushur kriteri përmes notës 6 në provimin e Maturës Shtetërore për gjuhë të huaj ose në provimin me zgjedhje, Niveli B1 të një prej testeve ndërkombetare dhe përjashtim bëjnë studentët të cilët kanë ndjekur studimet në shkollën e mesme në gjuhën angleze. GVJ konstaton që kriteri i përcaktuar në këtë drejtim zbatohet me korrektësi nga institucioni. Në lidhje me pranimin e studentëve KU IKT ofron edhe sistemin e bursave. Në takimin e zhvilluar një pjesë e studentëve përfitonin bursë që në momentin e regjistrimit me kusht mbajtjen e mesatares gjatë vitit të studimit. GVJ e gjen evidente edhe në raportet vjetore të përgatituar nga Institucioni dhe dorëzuar në MAS. Konkretisht për vitin 2020-</p>



2021 studentët e programit Bachelor “Inxhinieri Softuerike” janë dalluar për numrin më të madh të studentëve të shkëlqyer [27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT 2020 - 2021 per MAS].

Tabela 17: Numri i studentëve që kanë përfituar bursë nga institucioni

	Viti I	Viti II	Viti III
2020-2021	1 studentë	4 studentë	4 studentë

GVJ nga të dhënat e paraqitura nga Institucioni konstaton që kriteri i pranimeve është zbatuar me korrektësi. Niveli i mesatares në hyrje tejkalon kriterin minimal.

Tabela 18: Nota mesatare në hyrje

	Viti akademik	Nota mesatare në hyrje
Programi Bachelor në Inxhinieri Softuerike	2019-2020	8.38
	2020-2021	8.73
	2021-2022	8.54

KU ICT në fokus të punës së tij ka edhe rritjen e ndërkombëtarizimit përmes pranimi edhe të studentëve të huaj. Në këtë program studimi synimi i njësisë bazë është pranimi i studenteve nga rajoni [takim me dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë]. Kriteret e pranimi për studentët e huaj janë të njëjta me studentët shqiptarë, por kërkesë shtesë është pajisja me leje qëndrimi nga institucionet përkatëse. KU IKT përcakton qartë edhe kriteret në lidhje me transferimet e studentëve të cilët GVJ gjatë takimeve dhe vizitën në sekretarinë mësimore konstaton se janë zbatuar në përputhje me rregulloret. Numri i studentëve të transferuar në këtë program studimi është i konsiderueshëm.

Tabela 19: Numri i studentëve të transferuar

	Viti akademik	Transferimet
Programi Bachelor në Inxhinieri Softuerike	2019-2020	14
	2020-2021	5
	2021-2022	6

Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për

Kriteret e përgjithshme dhe specifike janë të hartuara në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në zbatim të VKM –së nr.295 datë 10.05.2019, Udhëzimit të MASR Nr. 10 datë 15.05.2019 dhe në përputhje me objektivat e vet institucionit [takim me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë].

arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.									
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni garanton informimin e kandidatëve studentë, publikun në lidhje me programet mësimore, përmbajtjen e tyre, tarifat dhe kriteret e pranimit dhe përfundimit të bursave përmes faqes së internetit. Në drejtim të informimit shërben edhe “Open Week” ku mundësohet takimi i stafit akademik me kandidatë për studentë dhe bëhet shkëmbim informacioni në lidhje me programin mësimor, organizimin e tij, synimet në drejtim të aftësisimit në përfundim të studimeve etj. KU IKT ka qenë pjesë e panairove të studimit të organizuar nga MAS, si edhe në takimet informuese me shkolla të mesme [takimet, https://cit.edu.al/]								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 3 vjet. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite. Në këtë program studimi ofrohet praktikë profesionale e vlerësuar me 6 ECTS [Ev. 20. Programet e lëndëve 2019 – 2020; 20. Programet e lëndëve 2020 – 2021; 20. Programet e lëndëve 2021 - 2022]. Të gjithë të drejtat dhe detyrimet që studenti duhet të plotësojë gjatë periudhës së studimit janë të përcaktuar qartë në Statut dhe në rregulloret specifike të pranimit, transferimit në Librin e Rregulloreve Institucionale dhe në rregulloren e programit të studimit [7. Libri i Rregulloreve Institucionale; 10. Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike]. Që në fillim të vitit akademik studentët njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Për çdo lëndë stafi akademik vë në dispozicion të studentit syllabuset ku jepet qartë përmbajtja e lëndës dhe detyrimet përkatëse që studenti duhet të plotësojë. Sekretaria mësimore vihet në dispozicion të studentëve duke ofruar shërbim në lidhje me regjistrimin, paraqitjen e notave dhe ndihmën për dokumentacionin që studenti duhet të paraqesë që në momentin e pranimit të tij në këtë program studimi. Ajo mirëadministron


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>edhe proces verbalet e paraqitura nga stafi akademik për çdo provim të kryer. Sistemi UMS mundëson edhe një akses të studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve, procedurat e regjistrimit të tyre në provime. Progresi i studentëve mbështetet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike dhe nga Këshilltari i Programit i ngritur në këtë departament. GVJ konstatoi zhvillimin e një praktike të drejtë të tij në këtë, i cili u pranua si efektiv edhe nga vetë studentët gjatë takimit të zhvilluar. [7. <i>Libri i Rregulloreve Institucionale</i>; 10. <i>Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike</i>; 12. <i>Rregullore e Sekretarise cikli i pare 2021-2022</i>].</p> <p>Të dhënat jepen qartë dhe në Guidën e Studentit ku studenti informohet për procesin e pranimit në tërësi dhe detyrimet e tij. [RVB; <i>Guida e Studentit</i> (https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf)]</p>																				
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>KU IKT u ofron studentëve mundësi njohje të krediteve dhe transferimin e studenteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi brenda vetë universitetit apo insitucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Këto transferime lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe kryhen vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, në librin e rregulloreve institucionale [7. <i>Libri i Rregulloreve Institucionale</i>; 10. <i>Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike, neni 9</i>;]. Studentët kanë të drejtën të transferojnë vetëm lëndë të vlerësuara me notë përfundimtare kaluese. Studenti regjistrohet në vitin e dytë nëse i janë njohur jo më pak se 30 kredite dhe në vitin e tretë jo më pak se 90 kredite. Studenti që transferon studimet nga një shkollë tjetër duhet të frekuentoje aq disiplina të programit sa të fitojë të paktën 50% të krediteve teorike të programit të studimit si dhe të ndjekë praktikën dhe diplomën. Për njohjen dhe vlerësimin shërben një Komision i Njohjes dhe Ekuivalentimit (të Kurrikules) i Departamentit.</p> <p>Tabela 20: Numri i studentëve të transferuar sipas viteve akademike</p> <table border="1" data-bbox="555 1563 1299 1832"> <thead> <tr> <th>Viti Akademik</th> <th>Studentë të transferuar Viti I</th> <th>Studentë të transferuar Viti II</th> <th>Studentë të transferuar Viti III</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>0</td> <td>12</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>0</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td></td> <td>16</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table>	Viti Akademik	Studentë të transferuar Viti I	Studentë të transferuar Viti II	Studentë të transferuar Viti III	2019-2020	0	12	2	2020-2021	0	4	1	2021-2022	0	0	6	Total		16	9
Viti Akademik	Studentë të transferuar Viti I	Studentë të transferuar Viti II	Studentë të transferuar Viti III																		
2019-2020	0	12	2																		
2020-2021	0	4	1																		
2021-2022	0	0	6																		
Total		16	9																		



	<p>Bazuar edhe të dhënat e gjetur në raportin vjetor institucional (2020-2021) rezulton se një pjesë e transferimeve janë nga KU IKT në universitete të tjera dhe një pjesë janë transferime të brendshme. Për vitin 2020-2021 janë transferuar 8 studentë në IAL të tjera kryesisht 1 në CEIT, 1 BAIT, dhe jashtë vendit ndërsa pjesa tjetër i përket kategorisë transferim të brendshëm. Në lidhje me transferimet Institucioni zbaton të gjithë procedurat përkatëse të theksuara edhe në rregulloren institucionale dhe Librin e Rregulloreve Institucionale. [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; rregulloret]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>KU IKT ka përcaktuar qartë format e vlerësimit të dijeve dhe aftësisë së studentit në dokumenta bazë institucionale. Libri i Rregulloreve Institucionale në Kapitullin III përcakton edhe format e vlerësimit të studentit. Në fillim të çdo semestri akademik studenti informohet në lidhje me kriteret e vlerësimit të tij të cilat janë të shprehur edhe në syllabuse. Nga takimi me studentët u konstatua informimi i tyre në lidhje me provimet e pjesshme, detyrën/projektin e kursit dhe provimin final. Vlerësimi i dijeve është i përcaktuar qartë dhe në çdo syllabus të programit të studimit. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentëve përcaktohen në programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve. Vlerësimi në një lëndë kryhet si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesëmarrje: 10%; 2. Pëmbushja e detyrimeve si laboratorë, detyrë kursi, projekte kursi: 40%; 3. Teste vjetore : 20%; 4. Provimi përfundimtar: 30%; <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 0 (zero) në 4 (katër) si dhe shprehet me germa nga F në A+. Konsiderohen kaluese notat nga 1 në 4 dhe gerrat nga D ne A+ [Rregullore e programit Bachelor ne Inxhinieri Softuerike, neni 5, pika 1]</p> <p>Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Studenti ka të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar të provimit brenda 10 ditëve nga marrja në dijeni e vlerësimit [7. Libri i Rregulloreve Institucionale, kapitulli VIII. pika 8]. Në takimin me studentët GVJ konstaton njohjen nga ana e tyre e procesit të ankimit, por shembuj nuk u sollën në këtë drejtim [takim me studentët;]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”. Në planin mësimor temës së diplomës i janë rezervuar 6 ECTS. Për</p>

<p>diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në Manualin e Punimit të Temës së Diplomës dhe në rregulloren “Për Punimin e Diplomës”. Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit u bëhen të njohura studentëve që në Javën e Orientimit. Rregullorja mbi “Punimin e Diplomës” përcakton se çdo anëtar i personelit akademik, brenda javës së tretë të semestrit të parë, të vitit të III, ofron propozime konkrete për temat e tezës, të cilat ai/ajo është i gatshëm t’i mbikëqyrë, duke bërë kështu të mundur krijimin e një grupi me tema dhe në vijim studenti i interesuar plotëson formularin e aplikimit duke u konsultuar paraprakisht me një drejtues të mundshëm duke i hapur rrugë miratimit të temave para mbylljes së semestrit të parë [Takime në institucion, Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes; Libri i Rregulloreve Institucionale]. Një fokus i veçantë i jepet mënyrës së hartimit të temës së diplomës kontrolli nga plagjatarizimi, citimi dhe referencat dhe përmbajtja shkencore dhe e argumentuar [takim me stafi akademik]. Të gjithë studentët i nënshtrohen punimit dhe mbrojtjes së diplomës.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ndjek një politikë sensibilizimi dhe informimi në lidhje me programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”. Zyra e Marketingut dhe Shërbimeve ndaj Studentëve në bashkëpunim me stafin akademik zhvillojnë takime informuese me maturanët e shkollave të mesme. Materiale promovuese përdoren gjerësisht për informim të publikut. Takime zhvillohen edhe në kuadër të javës “Open Week” për informim në lidhje me programin mësimor dhe përmbajtjen e tij. Informacion i gjerë gjendet edhe në website duke i shërbyer informimit të publikut të gjerë. [D5. Brochure Informuese Prospekti i Programeve Bachelor ne CIT]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e saj. Ata janë në dijeni për detyrimet në lidhje me lëndët formuese sipas nivelit Bachelor të diplomës që ata zotërojnë. Kjo është përcaktuar qartë edhe në kriteret e pranimit në rregulloren e programit të studimit. Në fillim të vitit akademik dhe në fillim</p>

	të çdo lënde bëhet prezantimi nga ana e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi i syllabusit të lëndës dhe detyrimeve që duhet të plotësojnë studentët. GVJ konstatoi se studentët ishin të mirëinformuar në lidhje me përmbajtjen dhe strukturën e lëndës nga pedagogët e tyre [takimi me studentët].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	KU IKT shpërndan informacion në website https://cit.edu.al/ ku studentët informohen me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Në website gjenden të publikuar edhe oraret e zhvillimit të programit mësimor së bashku me informacionin për përmbajtjen e programit mësimor. Në shërbim të informimit të studentëve është edhe platforma UMS (University Management System) e cila ofron një shërbim të personalizuar dhe aksesimi i të cilës bëhet përmes faqes web në rubriken <i>My CIT</i> .
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë punësimit të studentëve në përfundim të studimeve të tyre. Për këtë ka ngritur edhe mekanizma për ndjekjen e karrierës së tyre pas diplomimit [59. <i>Gjurmimi i studentëve të diplomuar nga IKT dhe NJSBC në 5 vitet e fundit</i>]. Programi ka synime të qarta në drejtim të rritjes së aftësisimit të studentëve. Në këtë program jepen qartë edhe mundësitë për punësim të tyre në përfundim të studimeve. Të dhënat për periudhën 2016-2021 në këtë program studimi janë pozitive dhe një tregues i përmbushjes së objektivave të tij në masën 62%. Konkretisht për këtë periudhë janë diplomuar 197 studentë ku 113 prej tyre janë punësuar në përputhje me diplomën, 11 në fusha të tjera dhe 73 janë të papërcaktuar. Në punësimin e studentëve ndikon: <ol style="list-style-type: none"> 1. Puna e kryer nga Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve e cila mban kontakte të rregullta me studentët dhe informohet për çdo çështje apo problematikë që ata kanë; 2. Këshilltari i programit i cili mundëson organizimin e praktikave profesionale të studentëve në kompani të specializuara dhe ku mundësitë e mëtejshme të punësimit janë më të mëdha; 3. Staf i akademik të cilët rekomandojnë studentë të shkëlqyer në kompani përmes kontakteve që kanë apo thirrjeve [takimet në institucion]. 4. Broshura, fletpalosje dhe sensibilizimi nga zyra e marketingut janë formë që përdoren në lidhje me prezantimin e punës së studentëve. Inkurajimi i pjesëmarrjes së tyre në thirrje për aktivitete shkencore është një formë prezantimi që përdoret nga institucioni për të treguar aftësimin e mirë të studentëve në këtë program studimi dhe për të sensibilizuar kompanitë në lidhje me

punësimin e tyre [D5. Broshurë Informuese Prospekti i Programeve Bachelor ne CIT; takim me stafin akademik]

5. Marrëveshjet me biznesin dhe institucionet shtetërore në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale dhe mundësitë për punësim të studentëve. Në çdo raport vjetor institucional një sesion të veçantë zë edhe numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruar dhe impakti që ato do të kenë në programet e studimit përmes fushës së vendosur të bashkëpunimit [RVB; Marrëveshjeve me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 - 2022; Takime në institucion].

Tabela 21: Numri i studentëve të diplomuar për periudhën 2016-2022

Numri i studentëve të diplomuar të gjurmuar	Numri i të punësuarve në fushën e tyre	Numri i studentëve të punësuar jo në fushën e tyre	Të papërcaktuar	Në përqindje mesatarja
197	113	11	73	57.3%

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Informacioni shpërndahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, tarifat e regjistrimit, notat etj.

Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, formularë të ndryshëm, modele të testimeve/provimeve që përdoren në institucion, aplikime për bursë, periodikun CIT E-Newsletter, manualin e mobilitetit të studentëve etj. Mund të aksesohen nëpërmjet faqes web të institucionit (<https://cit.edu.al/student#resources>)

Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.

GVJ konstatoi se Departamenti i Inxhinierisë Softuerike zhvillon forma të larmishme në lidhje me sensibilizimin, informimin dhe mbështetjen ndaj studentëve. Format e informimit në mënyrë të përmbledhur janë:

- Broshura, fletpalosje;
- Informim nga stafi akademik në lidhje me lëndët e programit të studimit, përmbajtjen e tyre përmes syllabuseve në çdo lëndë, informacionin në çdo orë mësimi, informimin në lidhje me literaturën detyruese dhe ndihmëse;

	<ul style="list-style-type: none"> • Studenti informohet edhe nga struktura e veçanta si Departamenti i Inxhierisë Softuerike që jep udhëzime, vendime që prekin drejtpërdrejte procesin mësimor; • Sekretaria mësimore luan një rol aktiv në informimin e studentëve; • Sisemi UMS që mundëson një akses të studentit në regjistrimin në provime, në përcaktimin e progresit të tij në vit akademik etj; • Website i universitetit i cili informon studentët në lidhje me kuadrin ligjor në zbatim në KU IKT bursat dhe programet shkencore, aktivitetet që kryhen në territorin e IKT-së, tarifat për regjistrimin dhe pagesat në çdo vit akademik, mobilitetet për studentët dhe procedurat për aplikim etj; <p>[Takime në institucion; RVB; https://ums.cit.edu.al/; (https://cit.edu.al/student#resources)].</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	<p>KU IKT ka ngritur struktura të cilat menaxhojnë sistemin e informacionit për numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimi, për progresin e tyre dhe detyrimet që ata mbartin.</p> <p>Një nga strukturat më të rëndësishme është Sekretaria Mësimore. Sekretaria mësimore funksionon mbi bazën e rregullores së saj të cilën GVJ e gjeti në Librin e Rregulloreve Institucionale. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtjen e regjistrimit bazë të studentit me të dhënat personale, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën dhe suplementin e saj. Regjistri i studentit plotësohet me shkrim dhe mbahet edhe në formë elektronike; 2. Përpilon listën e studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të larguar gjatë vitit akademik; 3. Menaxhon proces-verbalet për çdo provim së bashku me vlerësimet e bëra nga stafi akademik; 4. Sekretaria në bashkëpunim me hallkat drejtuese të Departamenti të Inxhinierisë Softuerike informojnë studentët për çdo çështje apo njoftim që prek drejtpërdrejt procesin mësimor dhe studentët;

	<p>5. Sekretaria plotëson edhe regjistrin e diplomës duke siguruar që dorëzimi i saj është bërë sipas kritereve të përcaktuar kornizën ligjore në fuqi dhe kërkesave të përcaktuar nga MAS;</p> <p>6. Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve e cila monitoron studentët e diplomuar dhe ndjek punësimin e tyre;</p> <p><i>[RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore, takim me përfaqësues të zyrës së çështjeve studentore].</i></p>								
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave për numrin e studentëve të regjistruar, studentët e transferuar, studentët që diplomohen. Të dhënat ruhen në regjistra përkatës dhe në formë elektronike. Përgjegjëse për menaxhimin e tyre në formë elektronike është Sektori IT-së. Të dhënat ruhen edhe në Departamentin e Inxhinierise Softuerike. Këto të dhëna shprehen në raportet vjetore që KU ICT përgatitit në përfundim të çdo viti akademik dhe i dorëzon në MAS.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për tre vite akademike rezulton:</p> <p>Viti akademik 2019-2020: 74 studentë;</p> <p>Viti akademik 2020-2021: 67 studentë;</p> <p>Viti akademik 2021-2022: 76 studentë;</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar përfshirë transferimet, për tre vitet e fundit vijon si ne tabelen me poshtë:</p> <p>Tabela 22: Numri i studenteve te regjistruar përfshirë transferimet, për tre vitet e fundit</p> <table border="1" data-bbox="456 1167 1286 1279"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Studentë</td> <td>88</td> <td>72</td> <td>82</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>[RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore].</i></p>	Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Studentë	88	72	82
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022						
Studentë	88	72	82						
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi mirë-administrim të të dhënave të studentëve, dosjeve personale të tyre. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave për numrin e studentëve të regjistruar, studentët e transferuar. Të dhënat ruhen në regjistra përkatës dhe në formë elektronike. Të dhënat ruhen edhe në Departamentin Inxhinierisë Softuerike. Në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, njësia bazë pasqyron edhe përpunimin statistikor të progresit të studentëve për çdo vit akademik në raportet vjetore të cilat i bashkangjiten raportit vjetor institucional. <i>[Takimi në Sekretarinë mësimore; 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS]</i></p>								
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në sistemin e brendshëm të informacionit, në hard copy dhe në formë elektronike. Procesi i mbajtjes dhe administrimit të tyre përcaktohet në Statut të KU IKT-së, neni 100 <i>[1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar, neni 100]</i>. Në</p>								

<p>përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit shërben edhe sistemi UMS. Ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave bazohet në nenin 101 “Baza e të dhënave të studentëve në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë””. Institucioni punon mbi bazën e parimit të mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale [1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar, neni 101]. Institucioni administron informacionin dhe dokumentacionin edhe përmes platformës Google Drive dhe Google Classroom. Google Drive shërben për procesin e ruajtjes dhe shpërndarjes së informacionit midis stafit akademik dhe administrativ ndërsa Google Classroom shërben për menaxhimin dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me procesin mësimor dhe me orën e mësimin [takime në institucion].</p>																						
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Të dhënat statistikore përpunohen në trajtën e raporteve periodike vjetore të Departamentit të Inxhinierisë Softuerike, Fakultetit të Inxhinierisë dhe pasqyrimin e tyre në raportin vjetor të institucionit. GVJ nuk gjeti të dhëna të dokumentuara të raporteve të përgatitura nga njësia bazë dhe njësia kryesore por për shumë të dhëna në lidhje me programin mësimor iu referua raporteve vjetore institucionale. Institucioni mban të dhëna statistikore për studentët, progresin deri në përfundim të studimeve. Të dhëna statikore shprehin cilësinë në hyrje dhe dalje të tyre dhe ecurinë duke reflektuar edhe në problematikat dhe rrugët për përmirësim [85. RVB Bachelor në Inxhinieri Softuerike; 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS].</p> <p>Tabela 23: Nota mesatare në hyrje</p> <table border="1" data-bbox="459 1111 1303 1223"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nota mesatare në hyrje</td> <td>8.38</td> <td>8.73</td> <td>8.54</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin 2020-2021 kalueshmëria në këtë program është ruajtur në kufijtë 80-90%.</p> <p>Tabela 24: Kalueshmëria e studentëve në Bachelor “Inxhinieri Softuerike”</p> <table border="1" data-bbox="459 1379 1303 1491"> <thead> <tr> <th>Programi Bachelor në Inxhinieri Softuerike</th> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> <th>Viti III</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Kalueshmëria (%)</td> <td>86.3</td> <td>91.5</td> <td>82.1</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin 2020-2021 tabela më poshtë jep të dhëna në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në një vit akademik;</p> <p>Tabela 25: Numri i studentëve të regjistruar dhe të diplomuar</p> <table border="1" data-bbox="459 1693 1303 1874"> <thead> <tr> <th></th> <th>Nr i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th>Nr i studentëve të diplomuar (shtator-korrik 2020-2021)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Bsc Inxhinieri Softuerike</td> <td>72</td> <td>57</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Nota mesatare në hyrje	8.38	8.73	8.54	Programi Bachelor në Inxhinieri Softuerike	Viti I	Viti II	Viti III	Kalueshmëria (%)	86.3	91.5	82.1		Nr i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr i studentëve të diplomuar (shtator-korrik 2020-2021)	Bsc Inxhinieri Softuerike	72	57
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022																				
Nota mesatare në hyrje	8.38	8.73	8.54																				
Programi Bachelor në Inxhinieri Softuerike	Viti I	Viti II	Viti III																				
Kalueshmëria (%)	86.3	91.5	82.1																				
	Nr i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr i studentëve të diplomuar (shtator-korrik 2020-2021)																					
Bsc Inxhinieri Softuerike	72	57																					

	Në lidhje me punësimin e studentëve GVJ gjeti të dhëna për punësimin e tyre në përputhje ose jo me fushën e diplomimit [referoju kriteri 3, standarti V.3]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Statuti i KU IKT-së si dokument bazë institucional përcakton në nenin 99 të tij funksionimin e Qeverisë Studentore si një organizim i pavarur i studentëve. Bazuar në forcimin e përfaqësimit studentor në raportin vjetor institucional 2020-2021, GVJ konstaton:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të studentëve anëtarë në Senatin Akademik (aktualisht janë 3 studentë si anëtarë); • Përfaqësimin studentor në përbërjen e komisioneve Institucionale: Komisioni i Bursave, Komisioni i Shëndetit dhe Sigurisë, NJSBC, Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacioni, Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore, Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore (ku 2 studentë janë anëtarë nga 6 në total) dhe Këshilli i Etikës [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS];
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje (detyrime këto që rrjedhin në Statut të KU IKT-së).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët janë anëtarë në Senatin Akademik dhe Komisionet e Përhershme ku japin mendimin e tyre në lidhje me çështjet që realisht çenojnë të drejtat e tyre si edhe mendime në lidhje me përmirësimet që institucioni duhet të bëjë në programet mësimore, infrastrukturën, tarifat, bursat, aktivitetet sportive etj; • Studentët janë aktive pjesëmarrës në dhënien e mendimit të tyre në pyetsorët dhe japin vlerësimin e tyre për stafin akademik dhe programin e lëndëve;

	Duhet të theksojmë që GVJ nga të dhënat statistikore nga pyetsorët e studentëve, nga takimet e zhvilluara me ta dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni nuk gjeti të dhëna konkrete në lidhje me propozimet për përmirësime të bëra nga studentët apo çështje të ngritura nga ata përmes Këshillit Studentor apo përfaqësuesve të tyre në Senat dhe Komisione [takim me studentët].
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Hartimi i programit të studimit Bachelor i në “Inxhinieri Softuerike” është bërë në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” duke marrë në konsideratë që ngarkesa javore në auditor të mos kalojë 25 orë [Planet mësimore të programit 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019 - 2020]. GVJ konstatoi se elementë të njohjes së studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme janë marrë në konsideratë në rregulloret përkatëse [Rregullore e Sekretarise cikli i pare 2021-2022]. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit (të Kurrikulës) i Fakultetit [RVB; Rregullore e Sekretarise cikli i pare 2021-2022].
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Studentët janë pjesë e procesit të rishikimit të programit mësimor. Përmes plotësimit të anketimit ata shfaqin mendimin e tyre në lidhje me dobësitë në procesin mësimor dhe shërbejnë si mjet për ndërmarrjen e hapave në lidhje me përmirësimet që kërkohen. [RVB; Model Pyetesori Bachelor Inxhinieri Softuerike]
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Të gjithë aktet ligjore në fuqi, strukturat e ngritura ku studentët kanë të drejtën e përfaqësimit, garantojnë marrjen e mendimit dhe shprehjen e lirë të tij në procesin e vlerësimit të programit të studimit. GVJ bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit konkludon se studentët kanë të drejtën e vlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirë informuar në këtë drejtim. Në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore përcaktohet se brenda dy javëve nga zhvillimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Nëse studenti nuk e pranon vlerësimin e kryer, mund të paraqesë me shkrim ankimin e tij pranë Përgjegjësit të

	<p>Departamentit ku të parashtrorë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Përgjegjësi i Departamentit ndjek procedurën e përcaktuar në rregullore për trajtimin e ankimeve duke garantuar transparencë dhe barazi [Rregullore e Sekretarise cikli i pare 2021-2022].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht	
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>KU IKT zhvillon aktivitetin e tij bazuar në parimin e informimit dhe shërbimit të studentëve. Për këtë, dokumentat ligjore garantojnë detyrat dhe përgjegjësitë që secila strukturë e ngritur në KU IKT të jetë në shërbim dhe në funksion të studentëve. Në mbështetje të tyre është caktuar edhe Koordinatori i Programit detyrat dhe funksionet e të cilit shprehen edhe në Librin e Rregulloreve Institucionale [7. Libri i Rregulloreve Institucionale]. Ky në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike asiston dhe jep ndihmesë tek studentët për çështje që kanë të bëjnë me programin mësimor, lehtëson procedurat për praktikën profesionale dhe japin këshillime studentëve në lidhje me mobilitetet, transferimet etj.</p> <p>Në shërbim të informimit janë edhe struktura me të cilat GVJ pati edhe takime dhe vizita në institucion dhe konstaton se janë aktive në funksionimin e tyre. Përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyra e regjistrimeve (Admission office); 2. Zyra për Shërbimin ndaj Studentëve 3. Sekretaria Mësimore; <p>Në vijim të punës për një informim të gjerë të studentëve luan edhe stafi akademik i cili informon studentët për tendencat e reja në fushën e teknologjisë, konferencat dhe mundësitë për bashkëpunime me studentët, thirrje nga kompani private për punësim etj. Stafi akademik i cili në fillim të çdo lënde paraqet përmbajtjen e tij, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe leksionet. Informacioni buron edhe nga biblioteka e cila siguron material të nevojshëm përmes platformave të saj elektronike, ku studentët kanë mundësi të aksesojnë në literature suplementare të nevojshme.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” është emëruar edhe Këshilltari Akademik, i cili në fokus të punës së tij ka edhe informimin, këshillimin dhe ndjekjen e progresit të studentëve [60. VSA Nr. 11, date. 15.10.2021 per emerimin e koordinatorit te programit te studimit; 7. Libri i Rregulloreve Institucionale].</p> <p>Stafi akademik ka gjithashtu në ngarkim edhe një grup studentësh me të cilët zhvillon takim 1 orë në javë dhe diskuton me ta çështje dhe problematika që mund të kenë hasur dhe jep udhëzimet përkatëse për sqarimin ose zgjidhjen e tyre [takim me stafin akademik].</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>KU IKT ka ngritur edhe Zyrën për Shërbimet ndaj Studentëve. Kjo zyrë është aktive në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dhënien e informacionit në lidhje me programet mësimore dhe licënsimet përkatëse të tyre; - Mundësitë për karrierë dhe punësim. Në këtë drejtin ajo ndjek studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre; - Kjo zyrë ofron këshillime në lidhje me përgatitjen për një intervistë, mënyrën e hartimit të një CV; - Bashkëpunon me njësitë bazë në lidhje me praktikat profesionale; - Mban lidhje me alumni dhe përthith mendimin e tyre; <p>[15. Manuali i Keshillimit te Karrieres; 82. Strategjia e Angazhimit të Alumni]</p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me përfaqësues nga ky sektor u theksua puna në lidhje me grumbullimin e të dhënave në lidhje me studentët pas diplomimit të tyre. Kjo zyrë në bashkëpunim edhe me njësinë bazë punon në lidhje me gjurmimin e studentëve dhe punësimin e tyre. GVJ konsideron punën e realizuar në vite nga kjo qendër në lidhje me mbledhjen e të dhënave statistikore të studentëve të diplomuar dhe të punësuar të cilat reflektohen raportet vjetore institucionale qe KU ICT paraqet edhe në MAS, ndonëse. GVJ <u>sugjeron</u> edhe paraqitjen e produkteve që kjo zyrë harton për të cilat GVJ nuk u njoh [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka të garantuar sigurimin e brendshëm të cilësisë e shprehur në Sesionin VII, neni 28 dhe 29 të Statutit të KU IKT-së. KU IKT harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit. Në këtë kuadër KU IKT i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit institucional të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Veprimtaria e Strukturës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon bazuar edhe në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015, Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.531 datë 11.09.2018, Planit Strategjik të KU IKT-së si edhe Manualit të sigurimit të Cilësisë.</p> <p>[1. Statuti i KU IKT 2016; 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që në vitin 2013 përmes vendimit nr.16 datë 22.05.2013 të Senatit Akademik. Kjo zyrë ka një anëtarësi prej 5 anëtarë nga të cilët 2 janë përfaqësues të personelit akademik të njëjësive kryesore, 1 personel i administratës, 1 përfaqësues i studentëve dhe 1 ekspert i jashtëm që drejton edhe njësinë. NJSBC ka një strukturë kolegjiale. [7. Libri i Rregulloreve Institucionale, 1. Statuti i KU IKT 2016]</p> <p>Institucioni ka hartuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë, që shërbejnë për funksionimin e NJSBC-së.</p> <p>[7. Libri i Rregulloreve Institucionale, 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook]</p> <p>Referuar RVB, ndër politikat dhe rregulloret që standardizojnë funksionimin dhe detyrat apo angazhimin e NJSBC mund të përmenden, Organizimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e</p>

	cilësisë së programeve dhe Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit [85. R/V/B Bachelor ne Inxhinieri Softuerike].			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	KU IKT ka krijuar një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili funksionon në të gjithë nivelet institucionale. Sigurimi i cilësisë garantohet përmes funksionimit të drejtë të NJSBC dhe të gjithë strukturave ndihmëse në funksion të saj. Në lidhje me sigurimin e jashtëm të cilësisë Institucioni i është nënshtruar shumë proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit të ndërmarrë nga ASCAL në nivel institucional dhe në nivel programi. Historiku i vlerësimeve nga proceset e vlerësimit të jashtëm janë reflektuar edhe në website https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/ . KU IKT-së i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 116, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri më 14.12.2022, ndërsa në kuadër programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” është akredituar përmes Urdhërit të MAS nr. 140 datë 25.03.2016 me një kohezgjatje 6 (gjashtë) vjeçare. [1.5 Akreditimi i parë i programit Bsc. në Inxhinieri Softuerike , Urdhër i MAS nr. 140, 25.03.2016; 1.4 Certifikata e Akreditimit lëshuar nga Bordi i Akreditimit 2017]			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Në Statut, Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e NJSBC janë të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë në drejtim të garantimit e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në punën e tij institucioni dhe NJSBC veprojnë sipas ligjit nr. 80/2015 dhe 5 synimeve bazë dhe objektivave përkatëse për secilën prej tyre të shprehur në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit [2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për	Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni, GVJ konkludon që KU IKT përdor


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>mekanizma dhe njësi për monitorimin, shqyrtimin mbikqyerjen dhe rishikimin e programit të studimit që mbulon nga niveli kolegjal deri në nivelin e njësisë bazë. Konkretisht në këtë drejtim janë aktive dhe në funksion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni i Përhershëm i Kurrikulave dhe Programeve Mësimore; 2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; 3. Departamenti i Inxhinerisë Softuerike; <p>Komisioni i Përhershëm i Kurrikulave dhe Programeve Mësimore është organi më i lartë në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve. Me një anëtarësi prej 5 staf akademik (aktualisht 5 Dr) dhe 1 student, ky komision merr në shqyrtim nevojat e institucionit për hapje të programeve të reja dhe bën vlerësim të cilësisë së programeve aktuale në institucion. Bazuar në të dhënat që vijnë nga NJSBC ky komision propozon veprime ose ndryshime me kërkesë të Senatit Akademik. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për përthithjen e mendimit të studentëve, personelit akademik përmes anketimit periodik përmes pyetsorëve dhe shpërndarjen e rezultateteve në të gjitha hallkat pjesë përbërëse të procesit mësimor. Veprimtaria e saj mbështetet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe në Procedurat për Mbështetjen dhe Përmirësimin e Cilësisë së Programeve [<i>Libri I Rregulloreve Institucionale</i>]</p> <p>Të dy këto struktura bashkëpunojnë ngushtë me stafin akademik dhe njësinë bazë dhe të gjithë grupet e interesit në drejtim të rishikimit të programit të mësimor. Aktualisht ky program nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën 20%. Ndryshimet për vitin 2021 – 2022 janë bërë vetëm 2 në emërtesë dhe 3 ndryshime lënde duke ruajtur masën 6 ECTS secila [20. Programet e lendeve 2019 – 2020; 20. Programet e lendeve 2020 – 2021; 20. Programet e lendeve 2021 - 2022]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>KU IKT përdor mekanizma dhe procese për shqyrtimin dhe monitorimin e programit të studimit. Kjo realizohet përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore; b) Politikat dhe procedurat e vetvlerësimit; c) Procedurat për Mbështetjen dhe Përmirësimin e Cilësisë së Programeve; <p>Bazuar për sa më sipër në fund të çdo semestri akademik institucioni i kushton vëmendje vlerësimit të programit të studimit përmes pyetsorëve që studentët plotësojnë. Të dhënat</p>

	<p>statistikore janë një bazë që shërben në vlerësimin e cilësisë së lëndëve dhe evidentojnë edhe përmirësimet që duhet të ndërmerren. Institucioni ndërmerr edhe vlerësime të programeve nga ekspertë të jashtëm. Për tre programet Bachelor të ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është bërë edhe një vlerësim i përgjithshëm ku janë konstatuar përputhshmeria e programit me misionin, objektivat dhe qëllimet e institucionit të shprehur në Statut dhe në Strategjinë e Zhvillimit. Në lidhje me gjetjet nga analiza e programit mësimor dhe mendimit të studenteve në këtë raport janë identifikuar edhe elementët për përmirësim si vijon më poshtë:</p> <p>a. Kurrikula mësimore mund të ndryshojë duke pasur një përqindje më të lartë në lëndën e Fizikës, mundësisht Fizikë II;</p> <p>GVJ gjen zbatimin e këtij rekomandimi në vitin akademik 2021-2022 ku janë bërë ndryshimet përkatëse. Në vend të lëndës “Shkrimi dhe Leximi Akademik” në semestrin e II-të u vendos Fizikë I dhe Lënda “Baza Themelore në Fizikë” u bë “Fizikë II” [19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT; 85. RVB Bachelor në Inxhinieri Softuerike, tabelat përmbledhëse].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>NJSBC përdor metodologji studimi të miratuar nga Senati Akdemik. Pyetsori shpërndahet në fund të çdo semestri akademik. Pyetsori plotësohet nga studentët dhe përmban tre sesione të rëndësishme.</p> <p>Sesioni 1: Vlerësimi i lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> Në këtë sesion studentët bëjnë vlerësimin në lidhje me syllabusin e lëndës, materialet e përdorur, njohuritë e përfituara, ngarkesa mësimore e lëndës kundrejt lëndëve të tjera. Ky sesion përmban 5 pyetje të mbyllura; <p>Sesioni 2: Vlerësimi në lidhje me stafin akademik.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në këtë sesion 14 pyetje të mbyllura dhe 2 të hapura trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me stafin akademik, aftësinë e tij në mësimdhënie, materialet e përdorur, kompetencat etj. Në fund përmes pyetjeve të hapura studentit i jepet mundësia të shprehë mendimin e tij dhe të sugjerojë mbi nevojat për përmirësim. <p>Sesioni 3: Vlerësim për institucionin.</p> <ul style="list-style-type: none"> Ky session përmban 4 pyetje të mbyllura dhe 1 të hapur. Kryesisht vlerësohet infrastruktura, komunikimi me njësitë e IKT, pritshmëritë dhe përmbushja e tyre si




	<p>edhe mendimi i lirë i studentit për përmirësimet [29. Model Pyetesori Bachelor Inxh Softuerike]</p> <p>Të dhënat në lidhje me pyetsorët përpunohen nga NJSBC dhe shprehen edhe në raportin vjetor institucional [29. Model Pyetesori Bachelor Inxh Softuerike]. Për vitin 2018-2019 janë zhvilluar dy pyetsorë me studentët dhe 1 me student alumni [raport institucional 2018-2019 marrë nga website: https://cit.edu.al/annual-report-2/]</p> <p>Për vitin 2019-2020 janë zhvilluar pyetsorë për studentët dhe vlerësimin e tyre në lidhje me programin, institucionin dhe stafin akademik [raport institucional 2019-2020 marre nga website: https://cit.edu.al/annual-report-2/]. Në vitin 2020-2021 në total janë bërë 2 pyetsorë dhe 1 anketim. Anketimi është bërë në lidhje me ecurinë e mësimin online dhe zhvillimin e provimeve. [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS].</p>			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	NJSBC për çdo vit akademik harton një raport vjetor i cili paraqitet tek organet drejtuese të KU-IKT-së, shpërndahet në fakultet dhe në departament. Këto të fundit bazuar edhe në vlerësimet e bëra marrin edhe masat e duhura për përmirësimet [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS, takim me përfaqësues të NJSBC-se, takim me përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierise Softuerike].			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Në takimin e zhvilluar me stafin akademik shembuj u sollën edhe mbi ndryshimet në përmbajtjen e syllabusit apo si rezultat i rekomandimeve të nxjerra nga ekspertë të jashtëm në vlerësimin e tre programeve të departamentit të Inxhinierisë Softuerike. Këto ndryshime nuk kanë tejkaluar masen 20% [27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; 19. Vleresim i Programeve te Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT; 85. RVB Bachelor ne Inxhinieri Softuerike _tabela e ndryshimeve ne programin mesimor].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e	Elementë të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit mundësohen nga pyetsori i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, proces i cili drejtohet dhe

<p>brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>monitorohet nga NJSBC. Një burim tjetër që mundëson krijimin e tabloje më të plotë për ecurinë e programit të studimit dhe respektimin e standarteve të cilësisë, është vlerësimi i programit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ndonëse në procesin e parë të akreditimit ky program u vlerësua pozitivisht për 6 vjet dhe nuk u shoqërua me rekomandime.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>KU IKT bazuar në Rregulloren e NJSBC, Manualit të Cilësisë, ka përcaktuar qartë metodat e drejtpëdrejta dhe të tërthorta që ky sektor kryen për vlerësimin e cilësisë së programit mësimor. Këto metoda janë të miratuara nga Senati Akademik dhe janë subjekt ndryshimi. GVJ në takimin me përfaqësues të NJSBC u njoh me punën e tyre në këtë drejtim. Stafi i NJSBC është trajnuar nga Institucioni për të përmirësuar punën tij në drejtim të matjes së cilësisë se programeve mësimore. Ata kanë marrë pjesë në trajnime në tekniken follow-up e cila përdoret në momentin kur pyetori i studentit nuk ka dalë pozitiv dhe institucioni pa nxituar duhet të ndjekë dhe monitorojë në mënyrë që të nxjerrë edhe vendime të duhura. Ata kanë marrë pjesë edhe në trajnim për programet dhe të kuptuarit e tyre, teknikat moderne të mësimdhënies etj. Në takim, përfaqësuesi i NJSBC theksoi edhe punën e vazhdueshme që bëhet në përmirësimin e formatit të vlerësimit dhe synimi në vlerësim të stafit akademik në një formë më të konturuar. Punë e vazhdueshme bëhet edhe në rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në anketim [Takim me NJSBC].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpëdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit</p>	<p>Bazuar në RVB, takimet në institucion dhe dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstaton se metodat e drejtpëdrejta si takimet e autoriteve drejtuese me studentët, mbajtja e kontakteve të vazhdueshme të njësisë bazë dhe koordinitorit të programit me studentët, mbajtja e kontakteve dhe takimeve me alumni, takimet me kompanitë e biznesit përmes përthithjes së mendimit të tyre për studentë që kryejnë praktikat profesionale, analiza e të dhënave statistikore për mendimin e studentëve, ecurinë dhe progresin e tyre dhe mbledhjet e vazhdueshme në lidhje me programin mësimor në departmentin e Inxhinierisë Softuerike janë indikatorë të matshëm të kësaj formë vlerësimi [takime në institucion; 85. RVB Bachelor ne Inxhinieri Softuerike].</p>

për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.									
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike kontrollon dhe monitoron procesin mësimor. Çdo lëndë i nënshtrohet një vlerësimi ku përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i vlerësimit me pikë/gërmë (në proceverbalet e plotësuar për çdo lëndë nga stafi akademik); • Kontrolli i testimeve të pjeshme dhe përfundimtare; • Kontrolli i procesit të mësimdhënies; • Kontrolli në lidhje me shfrytëzimin e infrastrukturës (kryesisht klasat, laboratorët dhe mjetet didaktike) • Kontrolli i detyrave/projekteve të kursit; • Kontrolli i praktikës profesionale; • Kontrolli i punimit të temës së diplomës; <p>GVJ pati rastin të konfirmojë një pjesë të këtyre elementëve gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, studentët. Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe NJSBC dhe evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion [takime ne institucion].</p>								
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i vlerësimit</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i vlerësimit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Niveli i vlerësimit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	KU IKT garanton krijimin e një strukture të vlerësimit të brendshëm të cilësisë e cila është gjithpërfshirëse. GVJ konstaton që veprimtaria e saj zhvillohet në nivel program studimi, departamenti, fakulteti dhe në nivel institucioni dhe vendimarrës [Statuti i KU ICT-së; Rregullore e NJSBC, Manuali i Sigurimit të Cilësisë].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të	GVJ konstaton që sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në KU IKT ka një strukture të mirëpërcaktuar ligjore. Në dokumentat bazë të institucionit, në Rregulloren e NJSBC, Manualit të Sigurimit të Cilësisë janë dhënë qartë detyrat dhe përgjegjësitë. Në shërbim të tyre janë edhe:

cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<ul style="list-style-type: none"> • Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit; • Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit; <p>[7 Libri i Rregulloreve Institucionale; 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook;</p>			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Vlerësimi dhe siguri i cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuerike” është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. GVJ konstatoi një pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve, DIS, dekanatit të FI në këtë proces. GVJ konstaton se ky vlerësim është real dhe ndikon në garantimin e cilësisë së programit mësimor dhe në funksion të përmbushjes së misionit dhe qëllimit të institucionit dhe strategjisë së tij të zhvillimit. [85. RVB Bachelor ne Inxhinieri Softuerike].			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në veprimtarinë e saj NJSBC mbështetet edhe nga struktura të tjera të ngritura me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në punën e saj ajo zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit dhe shmang çdo lloj pabarazie dhe diskriminimi. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin e sondazheve të kryera nga ky sektor [takime në institucion].			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Prania e praktikës profesionale në programin mësimor mundëson DIS të përthithë edhe mendimin e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procesin mësimor duke sjellë një ndërveprim më aktiv me kompanitë e biznesit dhe përthithje të mendimit të tyre në lidhje me përmbajtjen e programit dhe ajo çfarë nevojitet të përmirësohet. Institucioni ka angazhuar edhe ekspertë të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit dhe ka reflektuar për programin mësimor 2021 – 2022 në përmbajtjen e tij [19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton transparencë të procesit të vlerësimit të cilësisë në programin e studimit. Shpërndarja e pyetsorëve, përpunimi i tyre dhe rezultatet e sondazheve komunikohen në të gjithë hallkat pjesë përbërëse e këtij procesi. Informacioni është i aksesueshëm për të gjithë në https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/. Të dhënat në lidhje me rezultatet e pyetsorëve shpërndahen në njësinë bazë e cila organizon edhe mbledhjet në lidhje me to dhe përcakton rrugët për përmiresim. Reflektimin e të dhënave në lidhje me anketimet dhe pyestorët GVJ i ka gjetur edhe në raporte vjetore institucionale të KU IKT të cilat janë të aksesueshme në faqen web të institucionit https://cit.edu.al/annual-report-2/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni publikon rezultate e vlerësimit të programit të studimit në faqen web të tij duke bërë publike rezultatet e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional dhe të procesit të vlerësimit periodik të programit të studimit (https://cit.edu.al/official-documents-2/). GVJ konstaton se të dhënat dhe rezultatet e vlerësimit të anketimeve bëhen publike për të gjithë palët e interesuara (https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/). KU IKT harton çdo vit raportin vjetor i cili ju komunikohet të gjithë hallkave përfshirë në këtë process. Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit dhe mosdiskriminimit dhe nenin 100 në Statut të KU IKT.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ gjeti shembuj dhe dëshmi të masave përmirësuese që Departamenti i Inxhinierise Softuerike ka marrë bazuar edhe në raportet statistikore të NJSBC. Vlerësimi i programit të studimit (2019-2020) nga ekspertë të jashtëm është shoqëruar edhe me rekomandimet përkatëse. Pikat e dobta të identifikuar aty kanë shërbyer si masa që duhen përmirësuar. GVJ konstaton reflektimin dhe punën në përmbushjen e tyre në raportin vjetor institucional të KU IKT për vitin 2020-2021. [19. Vlerësim i Programeve të Studimit Bachelor dhe Master SE, IT, Bachelor dhe Master CE&IT; 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e KU IKT në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky instituciom i jep këtij procesi [takime në institucion].</p>

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC organizon aktivitete sensibilizuese me studentë për pjesëmarrjen aktive të tyre në plotësimin e pyetsorit. Në takimin me përfaqësues të kësaj zyre u thekua synimi i punës së tyre në drejtim të rritjes së përqindjes së pjesëmarrjes së studentëve në plotësimin e pyetsorëve [takim me NJSBC]. Takime NJSBC zhvillon edhe me stafin e ri në drejtim të orientimit të tyre për njohjen me procedurat e vlerësimit, mënyra e organizimit të programeve mësimore, organizimin e lëndës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	-----------------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Softuerike”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Një program studimi i cili, në sajë të kurrikulës së ofruar, zhvillon njohuri, aftësi e kompetenca profesionale të vlerësuara nga tregu i punës;
2. Studentë me mesatare të lartë në këtë program studimi;
3. Zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze i cili favorizon mobilitetet si për studentët ashtu dhe për personelin akademik, mundëson aksesin në një literaturë të gjerë teknike si dhe lehtëson njohjen e këtij programi edhe jashtë vendit;
4. Marrëdhënie të institucionalizuara me universitete të huaja homologe në shërbim të kualifimit dhe shkëmbimit të eksperiencave;
5. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit si dhe me aktorë të biznesit;
6. Mbulim i ngarkesës mësimore kryesisht nga personel akademik efektiv i motivuar dhe me kualifikimin e kërkuar për të garantuar një mësimdhënie cilësore;
7. Ndjekja e një politikë integruese për staf akademik të huaj me përvojë në institucione të njohura jashtë vendit;
8. Proces mësimor e kërkimor që realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme laboratorike për një zhvillim cilësor të këtij procesi;

b. Pika të dobta:

1. Kërkimi shkencor dhe masa e financimit të tij, përfshirë aktivitetet shkencore (konferenca, etj), konsiderohet jo ende në nivelin e kërkuar;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

2. Mungesë e një analize të impaktit të bashkëpunimeve dhe hapat për përmirësim;
3. Hapësirë e vogël e bibliotekës për të përmbushur kërkesat e studentëve të këtij programi;

Rekomandime

1. Zgjerimi i hapësirës së bibliotekës duke rritur numrin e PC që duhen për studentët në mjediset e saj;
2. Hartimin e raporteve analitike periodike në lidhje me bashkëpunimet e realizuara përgjatë vitit akademik dhe konkluzionet e vlefshme në lidhje me progresin e tyre;
3. Rritja më tej e financimit për kërkimin shkencor dhe e peshës së tij në të ardhurat e institucionit;
4. Diversifikimi i lëndëve me zgjedhje bazuar në kërkesat e studentëve si dhe tendencat e zhvillimeve teknologjike;

Conclusions of the evaluation of the first cycle program Bachelor in "Software Engineering"

a. Strengths and affirmations:

1. A study program that, through the proposed curriculum, develops knowledge, skills and professional competencies demanded by the labor market;
2. Enrolled students with a high average in this study program;
3. The development of teaching in the English language favors mobility for both students and academic staff, enables access to a wide technical literature and facilitates the recognition of this program abroad;
4. Institutionalized relations with counterpart foreign universities in the service of qualification and exchange of experiences;
5. Cooperation agreement with counterpart institutions within the country as well as with business actors;
6. Covering the teaching load mainly by effective academic staff motivated and with the required qualification to guarantee quality teaching;
7. Pursuing an integration policy for foreign academic staff with experience in recognized institutions abroad;
8. Teaching and research process that is carried out in large and quality spaces, equipped with the necessary laboratory infrastructure for a quality development of this process;

b. Weaknesses:

1. Scientific research and the measure of its financing, including scientific activities (conferences, etc.), is considered not yet at the required level;
2. Lack of an analysis of the impact of collaborations and steps for improvement;
3. Small library space to fulfill the requirements of the students of this program;

Recommendations

1. Expansion of the library space by increasing the number of PCs needed for students in its premises;
2. Drafting of periodic analytical reports regarding the collaborations carried out throughout the academic year and valid conclusions regarding their progress;
3. Further increase in funding for scientific research and its share in the institution's income;

4. Diversification of elective courses based on student proposals as well as technological development trends;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

